



Ballafaqimi me të kaluarën, mbijetimi i së tashmes:

Situata dhe nevojat e viktimave civile të luftës në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut

Gradanske
Inicijative

inTeGra

МИРОВА АКЦИЈА
AKSIONI PAQËSOR
PEACE ACTION


NEW SOCIAL INITIATIVE

ICTJ

Justice
Truth
Dignity

PAX

Peace.
Are
you in?

Kolofoni

Publikim i organizatave Civic Initiatives, Integra, New Social Initiative, Peace Action, ICTJ dhe PAX
Qershor 2022
ISBN: 9789492487728
NUR: 689

Autorët

Maqedonia e Veriut: Dr Elena B. Stavrevska; bashkautorë: Boro Kitanoski, Emrah Rexhepi, Marina Gjorgjioska Kitanoska
Serbi: Jelena Krstić

Kosovë: Milica Andrić-Rakić, Kushtrim Koliqi

Redaktore: Kathelijne Schenkel

Koordinimi: Kathelijne Schenkel, Bert van der Linde, Marina Gjorgjioska Kitanoska

Redaktor i gjuhës angleze: Frances Ellery, Mbretëri e Bashkuar

Dizajni grafik: Ondergrond.Agency, Holandë

Fotoja e kopertinës: Musli Melenica shikon drejt shtëpisë së Kahirmon Pasomës, vetëm 200 metra larg shtëpisë së tij, në rrugën e emëruar “22 Maji”, si një testament i ngjarjeve që do t'i ndryshonin përgjithmonë jetët e tyre. Foto nga Atdhe Mulla, 2022

Ky publikim është në dispozicion në gjuhën angleze, gjuhën shqipe, gjuhën maqedone dhe gjuhën serbe

Përkthimi në gjuhën shqipe: Professional Language Center 'LINGUA'

Përkthimi në gjuhën maqedone: Kiril Biserkoski dhe Gordan Tanaskov; lekturimi: Julijana Taleska

Përkthimi në gjuhën serbe: Milica Jeremić

Mirënjohje

Autorët dëshirojnë t'i falënderojnë të gjithë individët që kanë ndarë njohuritë dhe mendimet e tyre në intervista ose gjatë sesioneve në fokus grupe. Gjithashtu, e vlerësojmë lart asistencën profesionale dhe komentet e dhëna nga Marija Vuković, Santa Falasca, Kelli Muddell dhe Howard Varney.

Për ne



Iniciativat Qytetare (Građanske Inicijative): Inicativat Qytetare është një organizatë e shoqërisë civile e cila për 25 vite ka punuar në edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, demokracinë, shoqërinë civile dhe si të jenë qytetarë aktivë dhe të barabartë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. Vizioni i organizatës Inicativat Qytetare është të punohet për një shoqëri të drejtë me qytetarë që janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe rolet e tyre, një shoqëri aktive dhe të zëshme në dialog të vazhdueshëm me një shtet të hapur dhe llogaridhënës. <https://www.gradjanske.org>



OJQ Integra: Misioni i Integra-s është të ndihmojë në zhvillimin e Kosovës, veçanërisht në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe integritit, duke u marrë dhe promovuar histori dhe përvoja të komuniteteve të marginalizuara, dhe duke kontribuar kështu në proceset demokratike dhe ndërtimin e besimit dhe bashkëjetesës në paqe. <https://www.ngo-integra.org>



Iniciativa e Re Sociale (IRS Nova društvena inicijativa): IRS është një organizatë e shoqërisë civile që i ndihmon komunitetet joshumicë për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës dhe ngrit besimin në mesin e komuniteteve duke i mbështetur ato që të merren me të kaluarën dhe t'i normalizojnë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. <https://www.newsocialinitiative.org>



Aksioni Paqësor (Mirovna Akcija): Aksioni Paqësor është një organizatë jofitimprurëse e aktivistëve që punojnë në ndërtimin e paqes dhe promovimin e një kulture kundër dhunës përmes inicimit dhe edukimit të dialogut konstruktiv, ballafaqimit me të kaluarën, arsimit të integruar dhe bashkëpunimit rajonal. <https://mirovnaakcija.org>



Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ): ICTJ punon krah për krah me viktimat drejt njohjes dhe kompensimit për shkeljet masive të të drejtave të njeriut, për të kërkuar llogari nga personat përgjegjës, për të shtyrë përpara reforma dhe për të ndërtuar institucione demokratike, si dhe për të parandaluar përsëritjen e dhunës ose shtypjes. <https://www.ictj.org>



PAX: PAX është organizata më e madhe e paqes në Holandë. PAX punon për t'i mbrojtur civilët nga aktet e luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur dhe për të ndërtuar paqe gjithëpërfshirëse. Ne punojmë në zonat e konfliktit në mbarë botën me partnerë lokalë dhe njerëz që, si ne, besojnë se secili e ka të drejtën për një jetë dinjitoze në një shoqëri paqësore. <https://www.paxforpeace.nl>



Financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është bërë me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e organizatave Inicativat Qytetare, ICTJ, Integra, Iniciativa e Re Sociale, PAX dhe Aksioni Paqësor dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Shkurtesat	6
Hyrje	9
1. Serbia	14
1.1 Hyrje	14
1.2 Situata dhe nevojat e viktimave civile të luftës në Serbi	17
1.3 Nismat zyrtare për të trajtuar të kaluarën e dhunshme të Serbisë	38
1.4 Diskursi publik për të kaluarën në Serbi	41
2. Kosova	46
2.1 Hyrje	46
2.2 Situata dhe nevojat e viktimave të luftës në Kosovë	48
2.3 Nismat zyrtare lidhur me drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë	67
2.4 Diskursi publik për të kaluarën në Kosovë	75
3. Republika e Maqedonisë së Veriut	80
3.1 Hyrje	80
3.2 Situata dhe nevojat e viktimave dhe grupeve të tjera të prekura nga konflikti i armatosur i vitit 2001	83
3.3 Nismat zyrtare për ballafaqim me të kaluarën në Maqedoninë e Veriut	100
3.4 Diskursi i përgjithshëm rreth konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut	106
Përfundimet	112

Shkurtesat

BiH	Bosnjë dhe Hercegovina
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
DDR	Çarmatim, demobilizim dhe riintegrim
PZh	Person i zhvendosur
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
FDH	Fondi për të Drejtën Humanitare
HRW	Human Rights Watch
KNPP	Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
TPNJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë
PZhBV	Person i zhvendosur brenda vendit
UPJ	Ushtria Popullore Jugosllave
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KOMRA	Komisioni Rajonal për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut
DhSBGj	Dhuna seksuale dhe me bazë gjinore
DT	Drejtësia Tranzicionale
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNHCR	Komisioneri i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
UNOCHA	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare
Serbi	
UÇPMB	Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit
Kosovë	
KK	Këshilli Koordinues (i Shoqatave të Familjarëve të të Pagjeturve të Kosovës)
EULEX	Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë
KFOR	Forca e Kosovës (misioni i paqes i udhëhequr nga NATO)
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
QKRVT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës
QBPZh	Qendra Burimore e Personave të Zhdukur
KVP	Komisioni i së Vërtetës dhe i Pajtitimit
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Maqedonia e Veriut

ÇDR	Çarmatim, Demobilizim dhe Riintegrim
PDSH	Partia Demokratike Shqiptare
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare
MKO	Marrëveshja Kornizë e Ohrit
PPD	Partia për Prosperitet Demokratik
LSDM	Lidhja Social-demokrate e Maqedonisë (origjinali: Socijal demokratski sojuz na Makedonija)
VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetitn Kombëtar Maqedonas (origjinali: Vnatreshna makedonska revolucionerna organizacija – Demokratska partija na makedonsko nacionalno edinstvo)
ZUVO 2001–2002	Shoqata e pjesëmarrësve në aksionet e armatosura në mbrojtje të sovranitetit të Republikës së Maqedonisë 2001–2002 (origjinali: Zdruzenie na učesnici vo voožuhenite dejstvija pri odbrana na suverenitetot na Republika Makedonija 2001–2002)

Hyrje

Ballkani Perëndimor ende përballet me pasojat e luftërave që ndodhën gjatë periudhës së viteve 1990 dhe 2001. Gjersa vendet e prekura nga lufta janë zhvilluar ekonomikisht dhe në drejtim të ndërtimit të institucioneve dhe stabilitetit të përgjithshëm, trashëgimia e konflikteve nuk është trajtuar në mënyrë efektive dhe ende ndikon dhe formëson marrëdhëniet shoqërore ndërmjet grupeve të ndryshme etnike. Këto tensione themelore sociale janë të rrënjësura në strukturën sociale të Ballkanit Perëndimor dhe janë faktor kyç në politikën rajonale. Si i tillë, megjithëse Ballkani Perëndimor ka ecur përpara dhe ka tejkaluar kohërat e dhunës, shoqëria e këtij rajoni ende nuk është shndërruar në shoqëri paqësore. Krahas qeverisjes së mirë dhe zhvillimit ekonomik, transformimi i këtyre vendeve në shoqëri demokratike dhe paqësore është një element i rëndësishëm në realizimin e aspiratës së tyre për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian (BE). Qëllimi i qartë i politikës së zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor është promovimi i madh i paqes duke rivendosur kështu besimin midis qytetarëve dhe shoqërive, si dhe të lehtësojë pajtimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të sigurojë stabilitet të qëndrueshëm.

Gjatë 20 viteve të fundit, ka pasur disa iniciativa në Ballkanin Perëndimor për ballafaqim me të kaluarën e kohës së luftës. Masat e drejtësisë tranzicionale (DT) janë fokusuar veçanërisht tek tribunalet/gjykatat e krimeve të luftës dhe reformat institucionale, ku që të dyjat janë të rëndësishme për DT-në, por nuk mjaftojnë për ta realizuar transformimin social brenda shoqërive të prekura nga lufta. Iniciativa të tjera të DT-së kanë përfshirë gjetjen e fakteve për personat e zhdukur nga, ndër të tjera, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (KNPZh). Nga 40,000 rastet fillestare të personave të zhdukur, 70 përqind janë zgjidhur, me rreth 10,000 persona ende të zhdukur në rajon. Këto raste të pazgjidhura mbeten një traumë për familjet dhe komunitetet më të gjera.

Shoqëria civile në rajon ka ndërmarrë gjithashtu shumë iniciativa të DT-së, për shembull për dokumentimin, gjetjen e së vërtetës, librat e përkujtimit, përkujtimin dhe lehtësimin e dialogut ndërmjet grupeve të ndryshme etnike. Për shkak se këto iniciativa janë zakonisht në shkallë të vogël dhe me shtrirje të kufizuar, ndikimi i tyre transformues është gjithashtu i kufizuar. Një rrjet rajonal i organizatave të shoqërisë civile, Koalicioni KOMRA, bëri fushatë për themelimin e Komisionit Rajonal të ngarkuar me përcaktimin e fakteve për të gjitha viktimat e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001 (RECOM). Fatkeqësisht, procesi u përball me shumë sfida dhe është ndalur. Megjithatë, në mars 2022, në kuadër të programit të nën-granteve të financuar nga BE-ja "Përkrahja e akterëve bazë të shoqërisë civile në iniciativat e drejtësisë tranzicionale dhe ndërtimi i besimit në Ballkanin Perëndimor – Rrjeti për Pajtim RECOM", janë përzgjedhur pesë iniciativa nga thirrja e parë për propozime.¹

¹Projekti i Shoqatës Fëmijët e Harruar të Luftës (Bosnjë dhe Hercegovinë) dhe Simbolet e së kaluarës së humbur; Projekti GAIA (Kosovë) dhe Propaganda Sfiduese përmes Përkujtimit; Projekti i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike – ACDC (Kosovë) dhe Ballafaqimi me të kaluarën dhe pajtimi në Kosovë përmes ngritjes së vetëdijes për çështjen e personave të zhdukur; Qendra Qytetare e Vojvodinës (Serbi) dhe filmi i shkurtër 'Milena'; Qendra Komike e Maqedonisë (Maqedoni e Veriut) dhe Projekti "Gjithçka që po themi është t'i 'Jepni një Shans Pajtimit'.

Faktori kryesor që i pengon ndryshimet shoqërore në Ballkanin Perëndimor është fakti se strukturat aktuale politike kombëtare janë shpesh të lidhura me ish-fraksionet politike ose ushtarake që ishin përfshirë në mënyrë aktive në konfliktet e dhunshme. Shumica e vendeve në rajon përballen me mohimin e krimeve të luftës, falsifikimin e historisë dhe forcimin e politikës etno-nacionaliste. Gjatë gjithë periudhës së pasluftës, viktimat e luftës kanë luajtur vetëm një rol të parëndësishëm. Në këtë kontekst të polarizuar, shumica e grupeve të viktimave nuk kanë qenë në gjendje t'i dokumentojnë ose ndajnë përvojat e tyre ose ta gjejnë të vërtetën ose të kompensohen. Viktimave nuk i është ofruar mundësia për ta ngritur zërin. Sidomos gratë viktimave nuk kanë pasur shumë hapësirë për të fituar njohje, pranim ose kompensim. Gratë janë parë kryesisht si viktimat të dhunës seksuale të lidhur me luftën, e cila vetëm kohët e fundit po destigmatizohet. Megjithatë, përveç njohjes, gratë duhet të mbështeten për të marrë pjesë plotësisht në dialogjet për të kaluarën – e jo vetëm si viktimat. Në përgjithësi, iniciativat e DT-së vetëm sipërfaqësisht e kanë trajtuar çështjen e normave gjinore, gjë që ka rezultuar në anashkalimin e përvojave, pozitës dhe nevojave të grave.

Viktimat e luftës përballen me probleme të shumta: mungesa e drejtësisë dhe pozita shumë e dobët në gjyqet penale; mbështetja e dobët nga ana e shtetit, duke përfshirë reparacionet financiare dhe materiale; mbështetja e dobët nga ana e donatorëve; dhe një mungesë e përgjithshme simpatie në një shoqëri që zgjedhë t'i shpërfillë viktimat dhe problemet e tyre. Në përgjithësi, shoqatat e viktimave janë institucionalisht të dobëta dhe të paafta për të inicuar apo udhëhequr fushata serioze avokimi apo edhe aksione të tjera. Grupeve të viktimave zakonisht u mungojnë njohuritë bazë për DT-në dhe shumicës së organizatave të regjistruara zyrtarisht u mungojnë kapacitetet bazë institucionale dhe qasja strategjike. Shumë grupe viktimash janë të polarizuara dhe të ndikuara politikisht; diskursi i tyre shpesh bazohet në emocione dhe urrejtje ndaj “tjetrit”. Në një kontekst të tillë, është e vështirë për viktimat të gjejnë mbështetje ose drejtësi, apo t'i ndajnë historitë e tyre. Në të njëjtën kohë, nuk është arritur progress as në nivelin shoqëror për sa i përket ballafaqimit me të kaluarën.

Ky studim shqyrton gjendjen sociale dhe pozitën e viktimave të luftës në Serbi dhe Kosovë,² dhe të grupeve të prekura nga konflikti i armatosur në Maqedoninë e Veriut, si dhe nevojat dhe sfidat e tyre specifike. Këto tri vende paraqesin rrethana të ndryshme dhe interesante të kontekstit specifik. Serbia ishte akter kryesor, i përfshirë në katër luftëra ish-jugosllave ndërmjet viteve 1990 dhe 1999, të cilat prekën të gjitha pjesët e shoqërisë serbe. Disa qindra mijëra njerëz u përfshinë drejtpërdrejt në operacionet e luftës dhe shumë civilë vuajtën, duke përfshirë dezertorë, aktivistë kundër luftës dhe gazetarë luftime. Nuk ka pothuajse asnjë shoqatë viktimash në vend, dhe diskursi për të kaluarën formësohet nga politikanë etno-nacionalistë që nuk janë përkrahës të parimeve apo proceseve bazë të DT-së, si gjetja e së vërtetës dhe sigurimi i drejtësisë. Shumica dërrmuese e viktimave në Serbi (përfshirë viktimat e krimeve të luftës të kryera nga forcat serbe) kanë mbetur pa mbrojtje ligjore. Konflikti i Kosovës i viteve 1998–1999 preku të gjitha rajonet e Kosovës, duke ndikuar në jetën e të gjithë popullsisë së saj. Konflikti i përkeqësoi më tej marrëdhëniet tashmë të tensionuara midis popullatës shqiptare dhe serbe. Në përgjithësi, diskursi publik kontrollon nga elitat politike në Kosovë dhe Serbi, gjë që vazhdon të ndikojë në marrëdhëniet ndërmjet komunitetit kosovar-

²Kosova ishte një krahinë autonome brenda republikës së Serbisë në Republikën Federale/Socialiste të Jugosllavisë (1945–1991). Ky status autonom iu hoq nga presidenti serb Slobodan Milloshević në vitin 1989. Pas luftës së Kosovës të viteve 1998–99, Kosova u vu nën administrimin e OKB-së. Ajo shpalli në mënyrë të njëanshme pavarësinë nga Serbia në shkurt të vitit 2008 dhe është njohur si shtet sovran nga shumica e shteteve anëtare të BE-së dhe pak më shumë se gjysma e shteteve anëtare të OKB-së, megjithëse këto njohje ndryshojnë me kalimin e kohës. Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet sovran, dhe as Rusia, Kina apo Brazili, ndër të tjera.

shqiptar dhe serb të Kosovës. Gjatë 20 viteve të fundit, disa mekanizma janë krijuar për t'u marrë me trashëgiminë e luftës, por shumica janë dëshmuar të jenë jokonsistentë dhe joadekuat.

Megjithëse Maqedonia e Veriut mbeti relativisht e qëndrueshme gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, konflikti i armatosur shpërtheu në vitin 2001 kur Ushtria Çlirimtare Kombëtare Shqiptare (UÇK) rroko armët për shkak të represionit nga qeveria maqedonase. Konflikti zgjati tetë muaj dhe, megjithëse pati relativisht pak viktima dhe më pak mizori sesa në Serbi dhe Kosovë, kjo rezultoi në 171,000 njerëz të zhvendosur. Marrëveshja Kornizë e Ohrit e gushtit 2001 rregullon DT-në në nivel kombëtar, por nuk janë krijuar procese të llogaridhënies. Edhe pse ish-guerilët shqiptarë u integruan në sistemin politik dhe pakicës së madhe shqiptare iu dhanë më shumë të drejta, shoqëria ende mbetet thellësisht e polarizuar. Nuk ka debat publik për konfliktin e armatosur, narrativat shumë të forta nacionaliste vazhdojnë dhe nuk ka hapësirë për perspektiva të ndryshme. Intoleranca etnike ka rrënjë të thella dhe përcillet brez pas brezi. Mosbesimi dhe urrejtja ndërmjet maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë shpërthen në kohë krizash politike dhe pakicat e tjera etnike neglizhohen ose lihen mënjanë, veçanërisht romët që vazhdojnë të përballen me diskriminim serioz.

Gjersa ka dallime midis trija vendeve kur bëhet fjalë për kohën dhe shkallën e luftërave të tyre dhe se si administratat e tyre të pasluftës janë përgjigjur ndaj këtyre trashëgimive të dhunshme, megjithatë ka disa emërues të përbashkët. Këta përfshijnë: polarizimi etnik përmes tregimeve të njëanshme për luftërat e kaluara; Grupet e viktimave institucionalisht të dobëta përdoren politikisht në vend që të mbështeten për të marrë reparacione ose drejtësi; transferimi ndër breza i tregimeve historike të njëanshme; stereotipet mashkullore dhe femërore të viktimizimit (ose heroizmit); dhe mungesa e hapësirës sociale për të diskutuar të kaluarën e dhunshme.

Ky studim vlerësues hulumton tri dimensione në lidhje me grupet e viktimave në Serbi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut:

1. Situata dhe nevojat e viktimave dhe grupeve të tjera të prekura nga konflikti, për sa i përket: gjendjes së tyre sociale; pozicionit të tyre në lidhje me akterët e tjerë (politikë, OJQ, iniciativa të ngjashme); nivelit të tyre të organizimit; aktiviteteve që ata ndërmarrin për të çuar përpara kauzën e tyre; dhe sfidave me të cilat përballen. Nevojat specifike të grupeve (jo)zyrtare të viktimave identifikohen në aspektin e kapacitetit organizativ, njohurive rreth DT-së dhe aftësive të nevojshme për të mbështetur kauzën e tyre. Vëmendje e veçantë i kushtohet situatës dhe statusit të grave viktime.
2. Iniciativat zyrtare (të udhëhequra nga shteti) për ballafaqim me të kaluarën, duke përfshirë hartimin e politikave dhe ligjeve të rëndësishme për viktimat dhe grupet e tjera të prekura nga lufta ose konflikti i dhunshëm.
3. Diskursi kombëtar i çdo vendi për të kaluarën e dhunshme.

Hulumtimi u fokusua në dimensionin e parë, duke identifikuar situatën dhe nevojat e të prekurve nga konflikti, ndërsa dimensionin e dytë e vendos situatën e viktimave në një kontekst politik dhe ligjor. Dimensionin e tretë ofron kontekst duke përshkruar diskursin e zakonshëm për të kaluarën e kohës së luftës të çdo vendi. Të tre kapitujt e vendeve kanë të njëjtën strukturë.





Dušanka Kojić, gruaja e një burri të zhdukur nga Nova Gradiška. Trupi i tij nuk u gjet kurrë.
Foto nga: Borislav Pešić Blagoja, 2022

1. Serbia

1.1 Hyrje

Serbia është i vetmi shtet pasardhës i ish-Jugosllavisë që është përfshirë në katër konflikte të armatosura. Në luftërat e zhvilluara jashtë territorit të saj – p.sh. në Slloveni (1991), Kroaci (1991–1995) dhe Bosnje dhe Hercegovinë (1992–1995) – Serbia nuk mori pjesë zyrtarisht si palë në konflikt, por ishte e përfshirë thellë ushtarakisht, materialisht, politikisht dhe financiarisht. Në vitet kur Jugosllavia u shpërbë, lidhshipi serb mori kontrollin e Ushtrisë Popullore Jugosllave (UPJ) dhe e përdori atë për t'i arritur qëllimet e veta nacionaliste. Nën petkun e kinse ruajtjes së Jugosllavisë, UPJ fillimisht u angazhua në luftën në Slloveni, nga ku doli e mundur pas dhjetë ditësh. Në fillim të luftës në Kroaci, UPJ u paraqit si një akter neutral që po përpiqej t'i pajtonte palët ndërluftuese, por shumë shpejt mori anën e serbëve dhe u angazhua në mënyrë aktive në lidhjen e territoreve të kontrolluara nga serbët, duke përfshirë sulmet në shumë vende në të gjithë Kroacinë.³ Në Bosnje dhe Hercegovinë (BiH), UPJ-ja ndihmoi në realizimin e idesë së Serbisë së Madhe duke armatosur popullsinë serbe dhe duke ndihmuar që disa komuna të viheshin nën kontrollin serb të Bosnjës.⁴ Gjatë largimit nga Kroacia dhe BeH, UPJ-ja u la mjete të konsiderueshme ushtarake forcave të armatosura atje dhe autoritetet ushtarake dhe civile serbe vazhduan të ofrojnë ndihmë logjistike, staf, ndihmë materiale dhe financiare për forcat e armatosura të sapoformuara në territoret e kontrolluara nga serbët.⁵

Lufta në tokën serbe shpërtheu në vitet 1998-1999 në Kosovë, në provincën e atëhershme të Serbisë.⁶ Serbia u angazhua drejtpërdrejt përmes përfshirjes së ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve të saj, të cilët ishin nën kontrollin e forcave të sigurisë. Në dekadën pas konfliktit, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dënoi udhëheqësinë ushtarake, policore dhe politike të Serbisë duke e cilësuar si një ndërmarrje të përbashkët kriminale që synonte ndryshimin e ekuilibrit etnik në Kosovë dhe marrjen nën kontroll të provincës nga autoritetet serbe përmes krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljes së ligjeve dhe zakoneve të luftës. Ushtria dhe policia ishin përfshirë edhe në konfliktin e brendshëm të armatosur me Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (2000–2001), i cili ndërlidhej me konfliktin në Kosovë, por ishte edhe i vetmi konflikt i armatosur pas ndryshimit të regjimit (pro) luftës në Serbi.

Kompleksiteti, ndërlidhjet, karakteri ndërkufitar dhe etnik i konflikteve të armatosura në të cilat ishte e përfshirë Serbia kanë ndikuar, ndër të tjera, në faktin që viktima të shumta kanë kërkuar strehë të sigurt në tokën e saj. Së pari, refugjatët nga Kroacia dhe BeH mbërritën në Serbi në valë, duke krijuar krizën më të madhe të refugjatëve në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Me përfundimin e konfliktit në Kosovë, një numër i madh i personave të zhvendosur po mësynin në territorin e

³Jovana Kolaric, 2018. Dosja: UPJ në luftërat në Kroaci dhe BeH, Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH).

⁴Po aty.

⁵Për shembull, shumë oficerë në këto ushtri i merrnin rrogat e tyre përmes qendrave të stafit të Ushtrisë Jugosllave.

⁶Në Jugosllavinë socialiste (1945–1991), Kosova njihet si Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, në kuadër të Republikës Jugosllave të Serbisë. Në vitin 1989, regjimi i Slllobodan Millosheviqit hoqi autonominë e krahinës dhe ajo vazhdoi të ishte pjesë e Serbisë. Në referendumin jozyrtar të vitit 1991, shqiptarët votuan për pavarësi, por ky status nuk u njoh nga asnjë akter ndërkombëtar përveç Shqipërisë.

Serbisë së atëhershme qendrore. Refugjatët dhe personat e zhvendosur ishin anëtarë të familjeve të atyre që u zhdukën me forcë dhe ata që mbartnin pasojat psikologjike dhe/ose fizike të luftës. Përveç kësaj, një numër refugjatësh u rekrutuan dhe u dërguan me forcë në fushëbetejë në BiH, me disa prej tyre që morën pjesë në gjenocidin e Srebrenicës. Konflikti i brendshëm i armatosur në Luginën e Preshevës la pas qytetarë që ende vazhdojnë të ngacmohen, dhe të cilët edhe sot e kësaj dite vazhdojnë t'i kërkojnë të zhdukurit dhe nuk u besojnë institucioneve të vendit të tyre.

Efektet e luftës në Serbi janë ndërë edhe në ato territore që nuk ishin drejtpërdrejt të ekspozuara ndaj konflikteve, si dhe në mesin e civilëve që nuk kanë marrë pjesë në konflikt në ndonjë mënyrë. Zonat e Sanxhakut me shumicë boshnjake ishin ato që u goditën më së rëndi. Duke qenë në kufirin me BeH-në ku ishte ndezur lufta, Sanxhaku u bë i rëndësishëm strategjikisht, ku si bashkatdhetarë të palës kundërshtarë serbe (boshnjake), boshnjakët konsideroheshin armiq të shtetit. Për disa vite me radhë, boshnjakët iu nënshtruan kërcënimeve, arrestimeve të paligjshme, gjyqeve të politizuara, torturave policore, rrëmbimeve, dëbimeve dhe vrasjeve. Ngjashëm, gjatë luftës së Kosovës, shqiptarët në Luginën e Preshevës iu nënshtruan shkeljeve të shumta dhe të rënda të të drejtave të njeriut. Politika e luftës nacionaliste e Serbisë preku gjithashtu kroatët në provincën multietnike të Vojvodinës, të cilët u frikësuan dhe u vunë nën presion për t'u larguar nga vendi, duke rezultuar në dëbimin e dhjetëra mijërave prej tyre.⁷

Vuajtën edhe familjet që i kishin bijtë në shërbim të rregullt ushtarak ose të mobilizuar e të dërguar në fushëbetejë. Ngjarjet e luftës ishin veçanërisht mizore ndaj grave, të cilat ishin viktimat të drejtpërdrejta të dhunës gjatë konfliktit, por gjithashtu vuanin pasojat e pasluftës që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Në këtë kuptim, ekspozimi i tyre ndaj dhunës në familje nën ndikimin e traumave të luftës është i frikshëm.

Viktimat e luftërave në Kroaci dhe BeH u ekspozuan ndaj vuajtjeve në vetë Serbi. Në të paktën tetë kampe, forcat serbe të sigurisë ndaluan, abuzuan mendërisht, fizikisht dhe seksualisht dhe vranë kroatë dhe boshnjakë të kapur gjatë aksioneve të armatosura në zonat e shkatërruara nga lufta ose kur iknin nga veprime të tilla në kërkim të një vendi të sigurt në Serbi.⁸

Me përjashtim të kroatëve të dëbuar nga Vojvodina dhe të burgosurve me forcë në kampe anembanë Serbisë, shumica e viktimave të lartpërmendura sot jetojnë në Serbi dhe janë ende në pritje të drejtësisë. Numri i tyre i saktë nuk mund të përcaktohet për arsye të ndryshme, por është e sigurt se janë më shumë se 220 mijë. Disa grupe viktimash janë të organizuara në shoqata, ndërsa të tjerat janë të lidhura me grupe joformale; disa grupe janë më të dukshme se të tjerat. Grupet që bashkojnë serbët nga Kroacia, BeH dhe Kosova janë të organizuara në shoqata formale, janë më të dukshme për publikun e gjerë dhe gëzojnë mbështetje më të madhe politike nga institucionet serbe. Në anën tjetër, grupet që bashkojnë popujt pakicë mbeten të njohura kryesisht në mesin e komuniteteve lokale dhe brenda grupit të tyre etnik. Krejtësisht të padukshme janë grupet e viktimave të cilat, nga frika për ekzistencë, hezitojnë të profilizohen si viktimat, siç është rasti me refugjatët e mobilizuar me dhunë ose me shqiptarët nga Lugina e Preshevës.

⁷Jovana Kolarić, 2019. Dosja "Krimet kundër Kroatëve në Vojvodinë", Beograd: Fondi për të Drejtën Humanitare.

⁸Tatjana Tabački dhe Andrej Jakovljević. "Kampet e burgjeve në Serbi në vitet '90", Portali YU Historia, në dispozicion [këtu](#)

Tridhjetë vjet pas fillimit të konflikteve të armatosura në ish-Jugosllavi, të gjitha viktimat që jetojnë në Serbi mbeten të neglizhuara politikisht, socialisht dhe ekonomikisht. Kërkesat e tyre përfshijnë ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për krimet e kryera, zbulimin se çfarë ndodhi me të zhdukurit, njohjen politike dhe sociale, mbështetjen financiare dhe njohjen publike brenda Serbisë dhe, veçanërisht, nga shoqëritë nga të cilat kanë ikur. Në vend të kësaj, për dekada me radhë, viktimat janë përballur me zgjidhje joadekuate ligjore në lidhje me reparacionet, mosndëshkimin e atyre që planifikuan, organizuan, urdhëruan, kryen dhe fshehën krimet e luftës, mungesën e mundësive për të folur për përvojat e tyre me bashkëqytetarët dhe personat e tjerë të rëndësishëm, glorifikimin publik të kriminelëve të dënuar të luftës që vazhdojnë të jenë politikisht aktivë, heshtjen rreth fakteve të vërtetuara nga gjykata në lidhje me krimet e kryera dhe shtrembërimin e tyre në mënyrë që të përshtaten me narrativën zyrtare shtetërore – se Serbia nuk mori pjesë në luftërat e viteve 1990 dhe se ishte vetëm populli serb që vuajti gjatë atyre luftërave. Në fund të vitit 2021, është veçanërisht shqetësuese mbështetja në rritje e publikut për kriminelët e luftës që konsiderohen heronj.

METODOLOGJIA

Hulumtimi fillestar i dokumentacionit filloi me të dhëna nga burimet në gjuhën serbe dhe angleze mbi kornizat ligjore dhe kornizat e politikave që lidhen me konfliktet e armatosura të viteve 1990, informacione rreth grupeve të viktimave të asaj periudhe, mbulim mediatik dhe hulumtime ekzistuese. Hulumtimi i dokumentacionit konfirmoi mungesën e një hulumtimi gjithëpërfshirës për gjendjen e viktimave të luftës në Serbi. Më tutje, u kryen intervista gjysmë të strukturuar dhe në fokus grupe me 23 persona gjatë prillit dhe majit 2021. Të intervistuarit u zgjodhën nga hulumtuesi dhe Iniciativat Qytetare, pas identifikimit më të gjerë që përfshinte shoqatat e viktimave dhe grupet joformale aktive në Serbi, viktimat individuale, dhe akterët e angazhuar në avokimin e të drejtave të viktimave, mbështetjen e viktimave dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat (kryesisht OIQ-të dhe organizatat ndërkombëtare).

Faktorët kufizues kryesor ishin koha e shkurtër në dispozicion për hulumtim dhe disponueshmëria e grupeve të caktuara të viktimave në Serbi. Për shkak të kësaj, hulumtimi në terren nuk mund t'i përfshinte të gjitha viktimat civile të kategorive të luftës. Të përfshirë janë (përfaqësuesit e) refugjatëve, personave të zhvendosur, familjeve të civilëve të zhdukur ose të vrarë, dhe të mbijetuarve të krimeve të luftës dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut. Shumë prej tyre kanë përjetuar luftën në disa nivele ku përfshihen disa aspekte të vuajtjes. Intervistat me grupet e viktimave u kryen në gjuhën serbe dhe u përqendruan në përvojat personale gjatë dhe pas luftërave, si e përjetojnë të intervistuarit situatën e tyre aktuale dhe cilat janë nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Intervistat me akterë të tjerë u zhvilluan në serbisht dhe anglisht dhe u fokusuan në përvojat e tyre lidhur me bashkëpunimin dhe mbështetjen e viktimave, mësimet e nxjerra, mangësitë ligjore dhe vlerësimet e kapaciteteve dhe nevojave. Shumica e intervistave dhe fokus grupeve u zhvilluan personalisht, por disa duhej të kryeshin përmes burimeve në internet për shkak të kufizimeve që lidhen me pandeminë COVID-19. Të intervistuarve iu dha mundësia të kontribuojnë në mënyrë anonime për t'u mundësuar të shprehen lirisht dhe për t'i mbrojtur ata që i përkasin grupeve të cënueshme nga çdo formë ndëshkimi.

Elementi i tretë i studimit ishte vendosja e gjetjeve mbi pozitën dhe nevojat e grupeve të viktimave brenda një konteksti specifik socio-politik. Kjo ofron njohuri më të mira lidhur me çështjen dhe vë në qendër të vëmendjes faktorët që mund të ndikojnë në iniciativat për të përmirësuar situatën e tyre. Për më tepër, shpresojmë se do të shërbejë si një shenjë paralajmëruese për komunitetin ndërkombëtar dhe akterët e tjerë se është larguar Serbia nga angazhimi i saj i proklamuar për zgjidhjen paqësore të trashëgimisë së luftërave të viteve 1990-ta.

1.2 Situata dhe nevojat e viktimave civile të luftës në Serbi

Në Serbi mungojnë hulumtime gjithëpërfshirëse mbi pozitën dhe nevojat e viktimave civile të luftërave në ish-Jugosllavi ndërmjet viteve 1991 dhe 2001. Hulumtimet në dispozicion hulumtojnë vetëm disa aspekte, siç është p.sh. nevoja që viktimat të njihen zyrtarisht duke u kompensuar në formën e reparacioneve,⁹ ose përvojat e viktimave që dëshmojnë në gjykatë.¹⁰ Disa hulumtime e prekin këtë çështje në mënyrë indirekte, si në rastin e hulumtimit mbi gjyqet e krimeve të luftës¹¹ apo ndjekja penale e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore në luftë.¹² Hulumtimet mbi viktimat në Serbi janë kryer nga një pjesë e vogël e organizatave të shoqërisë civile dhe akademikeve.

Numri i saktë i viktimave të luftërave që rezultuan nga shpërbërja e Jugosllavisë¹³ që jetojnë në Serbi, apo qoftë edhe një numër i përafërt, është e pamundur të përcaktohet për shkak të kalimit të kohës dhe mosgatishmërisë së shtetit për t'i identifikuar viktimat dhe për të mbajtur të dhëna të sistemuara. Për të njëjtat arsye, është e vështirë të vlerësohet numri i shoqatave (jo)formale të viktimave, kombinuar me faktin se disa funksionojnë vetëm *de jure* (në letër), dhe disa të tjera nuk janë të regjistruara por funksionojnë *de facto*. Për më tepër, diferencimi midis disa kategorive të viktimave, duke përfshirë dy grupe të dallueshme të viktimave të drejtpërdrejta të luftës dhe viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera në kontekstin e konflikteve të armatosura, paraqet një sfidë tjetër për këtë proces. Megjithatë një dallim i qartë nuk është gjithmonë i mundur, për qëllim të këtij raporti viktimat ndahen në dy kategori: viktimat të drejtpërdrejta të luftës dhe viktimat të abuzimeve të të drejtave të njeriut që lidhen me luftën.

VIKTIMAT E DREJTPËRDREJTA TË LUFTËS

1. **Refugjatët nga Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina**– Në vitin 1996, menjëherë pas luftërave, në Serbi janë regjistruar gjithsej 537.937 refugjatë + 79.791 persona të prekur nga lufta nga Kroacia dhe BeH. Sipas të dhënave zyrtare, 90 për qind e këtyre refugjatëve ishin serbë. Të dhënat nuk tregojnë se çfarë grupesh etnike i përkasin 10 për qindsh të tjetër, por disa ishin me gjasë romë, disa nga martesat të përziera, dhe të tjerët nuk identifikohen si serbë (p.sh. ka ende disa persona që e quajnë veten 'jugosllavë'). Me kalimin e viteve, shumica e refugjatëve janë integruar në Serbi, ndërsa një numër më i vogël janë kthyer në Kroaci ose BeH. Që nga korriku i vitit 2020, në Serbi kishte 25,794 refugjatë nga Kroacia dhe BeH.¹⁴

9 Meris Mushanoviq, 2021. E drejta për dëmshpërblim në paditë për kompensim: praktika e gjykatave serbe 2017-2020 Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH); Meris Mushanoviq, 2019. Dokument me politika: Përmirësimi i statusit dhe të drejtave të viktimave dhe dëshmitarëve në procedurat e krimeve të luftës në Serbi, FDH; Jasmina Kijevčanin, 2019. "Dëmshpërblimi për viktimat e bombardimeve të NATO-s në Radio Televizionin e Serbisë: Shembulli i Monumenteve", *Journal of Victimology and Victim Justice* 2(2) 129–140.

10 King K., Meernik J., Rubert S., De Smit T., Vranov Schoorl H., 2016. Jehona e dëshmitarëve: *Një studim pilot mbi ndikimin afatgjatë të dhënies së dëshmisë përpara TPNI*. Universiteti i Teksasit të Veriut dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

11 Marina Kljaić, 2021. Raport mbi gjyqet e krimeve të luftës në Serbi gjatë vitit 2020, FDH.

12 Ivana Žanić, 2019. Dokument politikash: Ndjekja penale e krimeve të dhunës seksuale gjatë konflikteve të armatosura pranë Gjykatave të Republikës së Serbisë, FDH.

13 Për qëllimin e këtij raporti, u përdor përkufizimi i deklaruar në Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën për Mjekim dhe Dëmshpërblim për Viktimat e Shkeljes së Rëndë të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Humanitare: "Personat që individualisht ose kolektivisht kanë pësuar dëmtime, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose dëmtim të konsiderueshëm të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve që përbëjnë shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, ose shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Aty ku është e përshtatshme, dhe në përputhje me ligjin vendas, termi 'viktimë' përfshin gjithashtu familjen e ngushtë ose personat e varur të viktimës direkte dhe personat që kanë pësuar dëmtime gjatë ndërhyrjes për t'i ndihmuar viktimat ose për të parandaluar viktimizimin."

14 [Vështrim statistikor i Refugjatëve dhe IRL sipas Komunave 2018 eng.xlsx \(kirs.gov.rs\)](#)

2. **Personat e zhvendosur (PZh) nga Kosova** – Pas luftës së viteve 1998–1999 në Kosovë, në Serbinë qendrore janë zhvendosur 187.129 persona, kryesisht serbë, por edhe komunitete të tjera joshqiptare.¹⁵ Në pesë vitet në vijim, erdhën rreth 20,000 PZh tjerë, duke arritur një total prej 209,021 deri në fund të vitit 2005. Sipas të dhënave zyrtare nga korriku i vitit 2020, sot në Serbi janë 196,995¹⁶ persona të zhvendosur nga Kosova (të cilët u larguan nga viti 1998 deri në vitin 2004).
3. **Familjet e personave të zhdukur** – Në vitin 2020, Serbia ishte ende në kërkim të 2,453 personave të zhdukur.¹⁷ Ky numër përfshin: 1) shtetas të Serbisë të zhdukur në luftërat në Kroaci dhe BeH; 2) shtetas të këtyre vendeve të përkatësisë etnike serbe ose/dhe që kishin ikur në Serbi si refugjatë; 3) Serbë dhe joshqiptarë të zhdukur në luftën e Kosovës.¹⁸ Personat e zhdukur gjatë luftërave jugosllave përfshijnë ata që janë arrestuar, ndaluar, rrëmbyer ose në ndonjë mënyrë tjetër janë privuar nga liria nga autoritetet shtetërore ose formacionet e armatosura, ose nga persona ose grupe personash që veprojnë me autorizim, mbështetje ose miratim të qeverisë ose i formacioneve të armatosura dhe vendndodhja e të cilëve mbetet e panjohur. Me familje që përbëhen nga shumë anëtarë, numri i anëtarëve të familjes që kërkojnë të dashurit e tyre është shumë më i lartë.
4. **Familjet e shtetasve serbë të rrëmbyer nga një autobus në Sjeverin** (komuna e Priboj, Serbi) dhe nga treni në Shtërpçi (komuna e Rudos, BeH) nga forcat serbe të Bosnjës dhe pastaj edhe të vrarë – 35 viktima (34 boshnjakë dhe një me përkatësi etnike kroate). Me familje që përbëhen nga shumë anëtarë, numri i anëtarëve të familjes që kërkojnë të dashurit e tyre është shumë më i lartë.
5. **Familjet e personave të vrarë** – shifra e civilëve të vrarë (të etnive të ndryshme, duke përfshirë shqiptarë, ashkali, egjiptian të Ballkanit, boshnjak, kroat, malazet, rom, serb, etj.) është e pamundur të përcaktohet për disa arsye: mungesa e provave zyrtare ose të plota, mbivendosja e statusit të viktimave, familjet nuk marrin pjesë në asnjë shoqatë apo grup, etj.
6. **Të mbijetuarit e krimeve të luftës** - persona që u nënshtrohen shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në lidhje me luftën, zakonisht me pasoja fizike dhe/ose psikologjike. Numri i viktimave që i përkasin këtij grupi mbetet i panjohur sepse të dhënat zyrtare (shtetërore) përfshijnë vetëm viktima të caktuara nga luftërat e viteve 1990 në Jugosllavi (shih kutinë me informata) ndërsa në të njëjtën kohë përfshihen viktima nga luftëra të tjera. Sipas të dhënave zyrtare jo të plota, në vitin 2019 në Serbi kishte 905 invalidë civilë të luftës, përfshirë invalidët civilë të Luftës së Dytë Botërore.¹⁹

¹⁵Sipas të dhënave zyrtare, 76 për qind e PZH ishin serbë, 11 për qind romë dhe 13 për qind malazetë, boshnjakë dhe egjiptianë. Burimi: Registracija lica raseljenih sa Kosova i Metohije (Regjistrimi i personave të zhvendosur nga Kosova dhe Metohija), Komisioni për Refugjatë i Republikës së Serbisë dhe UNHCR; në dispozicion në serbisht [këtu](#).

¹⁶ [Vështrim statistikor i Refugjatëve dhe IRL sipas Komunave 2018 eng.xlsx \(kirs.gov.rs\)](#)

¹⁷ *Izveštaj o radu Komisije za nestala lica u periodu od 1. januara do 31. dhjetor 2020. godine* (Raporti Vjetor i Komisionit për Persona të Zhdukur për vitin 2020), Komisioni për Persona të Zhdukur, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

¹⁸Po aty.

¹⁹Arsyetimi për Ligjin për të Drejtat e Veteranëve të Luftës, Invalidëve të Luftës, Invalidëve Civilë të Luftës dhe anëtarëve të Familjeve të tyre, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

7. **Refugjatët e mobilizuar me forcë dhe familjet e tyre** – rreth 10.000 refugjatë (kryesisht të përkatësisë etnike serbe) u dërguan me forcë në fushëbetejë.²⁰ Të paktën 54 u vranë ose u zhdukën.
8. **Familjet e civilëve të vrarë ose të ngacmuar gjatë konfliktit të armatosur të brendshëm** ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) dhe forcave serbe të sigurisë në Luginën e Preshevës nga janari i vitit 2000 deri në gusht të vitit 2001. – Familjet e të paktën 16 civilëve të vrarë ose të zhdukur dhe të paktën 150 personave (shqiptarë dhe serbë) të përndjekur nga forcat serbe të sigurisë²¹ nuk njihen si viktima civile të luftës.
9. **Viktimat e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s** – 260 viktima civile (të etnive të ndryshme) të vrarë në Serbi, e cila atëherë ishte ende pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbia, Mali i Zi dhe Kosova).²² Numri aktual mund të jetë më i lartë duke pasur parasysh se shtetas serbë u vranë edhe gjatë ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë dhe Mal të Zi.

VIKTIMAT E SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT QË NDËRLIDHEN ME LUFTËN

10. **Viktimat e represionit shtetëror të luftës kundër myslimanëve të Sanxhakut** (boshnjakëve) ndërmjet viteve 1992 dhe 2000 – dhjetëra mijëra viktima të torturës policore/arrestimit të paligjshëm (17,000), gjyqeve të motivuara politikisht, vrasjeve, rrëmbimeve, ngacmimeve, frikësimeve, dëbimeve të detyruara.²³
11. **Viktimat e represionit shtetëror të luftës kundër shqiptarëve në Serbinë jugore** gjatë ndërhyrjes ushtarake të NATO-s – 11 të vrarë dhe një numër i panjohur i personave që kanë qenë subjekt i ngacmimeve dhe torturave nga forcat serbe.²⁴
12. **Komunitetet joserbë (shqiptarë, kroatë, myslimanë, jugosllavë25) që jetojnë në Serbi** dhe që kanë qenë subjekt i ngacmimeve, frikësimit, diskriminimit dhe/ose dhunës fizike – një numër i panjohur.²⁶

Në kategorinë e viktimave indirekte të luftës përfshihen edhe viktimat e dhunës në familje të shkaktuar nga trauma e pasluftës (sindroma e PTSD), si dhe anëtarët e familjeve të civilëve të cilët u rekrutuan me forcë dhe u dërguan në betejë. Një kategori tjetër e veçantë e viktimave janë viktimat gra të luftës, veçanërisht refugjatet femra dhe viktimat e DhSBGj-së gjatë luftës (dhe dhunës në familje), numri i të cilave mbetet i panjohur.

20Kolaric Jovana, 2019. Dosja: Mobilizimi me forcë i refugjatëve, FDH.

21Goran Miletiq, 2003. Shqiptarët në Serbi – Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, FDH.

22754 Viktimat e bombardimeve të NATO-s, Deklaratë për shtyp, 23 mars 2018, FDH, në dispozicion [këtu](#).

23Semiha Kaçar, 2002. Dëshmi nga Sanxhaku, Komiteti i Sanxhakut për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Serbi.

24Miletiq, 2003.

25Disa njerëz vetë-identifikohen si jugosllavë.

26Hrtkovci – Pritisak na Hrvate u Srbiji (Hrtkovci – Presioni ndaj Kroatëve në Serbi), Raport, 1993, FDH, në dispozicion në serbisht [këtu](#); Priboj - Diskriminacija, otmica i zastrašivanje Muslimana u Srbiji (Priboj – Diskriminimi, rrëmbimet dhe frikësimi i muslimanëve në Serbi), Raport, 1993, FDH, në dispozicion në serbisht [këtu](#); Policijsko nasilje na beogradskim ulicama (Dhuna policore në rrugët e Beogradit), Raport, 1993, FDH, në dispozicion në serbisht [këtu](#); Srpsko-atbanski zatvorenici – Devizno vaganje pravde (Të burgosurit serbo-shqiptarë – peshimi i drejtësisë përmes valutës së huaj), Njoftim për shtyp, 2000, FDH, në dispozicion në serbisht [këtu](#); Abuzimet e të drejtave të njeriut të jo-serbëve në Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë, 1993, Human Rights Watch; Izveštaj o pojačanoj represiji u Srbiji (Raport mbi represionin e shtuar në Serbi), 2000, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

Si përfundim, disa dhjetëra mijëra qytetarë serbë të etnisë kroate ishin **viktima të frikësimit, ngacmimit dhe dëbimit nga Provinca Autonome e Vojvodinës** ndërmjet viteve 1991 dhe 1995.²⁷ Shumica u vendosën në Kroaci, por ende po kërkojnë drejtësi dhe dëmshpërblim nga institucionet shtetërore të Serbisë.²⁸

Disa faktorë e penguan përfshirjen e pozitës dhe nevojave të të gjitha kategorive të viktimave në një projekt gjithëpërfshirës hulumtues.

Faktorët kufizues kryesorë ishin koha e shkurtër në dispozicion për hulumtime dhe disponueshmëria e grupeve të caktuara të viktimave në Serbi. Prandaj fokusi ishte në grupet e viktimave nga kategoritë **1, 2, 3, 4 dhe 10**. Viktimat nga **kategoritë 5 dhe 6** u përfshinë gjithashtu, duke pasur parasysh se, në shumë raste, ky lloj krimi përputhet me shkelje të tjera të të drejtave të njeriut (zhdukje me forcë, zhvendosje, spastrim etnik, etj.). Me fjalë të tjera, grupet e viktimave që ishin subjekt i hulumtimit dhe që u përfshinë në intervista kanë përjetuar luftën në disa nivele që përfshinin disa aspekte të vuajtjes. Disa viktima nga **kategoritë 8 dhe 11** u përfshinë në kuadër të një komuniteti më të gjerë viktimash.

Për hulumtimin mbi grupet e viktimave nga kategoritë **7 dhe 12** do të nevojitet më shumë kohë dhe burime, ndërsa viktimat nga **kategoria 9** u përjashtuan për shkak të rrethanave të tyre të veçanta. Ata konsideroheshin si 'dëm kolateral' ndërsa shumica e kategorive të tjera të viktimave civile ishin shënjestruar qëllimisht. Megjithatë, duhet të theksohet se familjet e punonjësve të Radio Televizionit të Serbisë që u vranë kur raketat e NATO-s goditën ndërtesën më 23 prill 1999 janë pjesë e nismave të rimëkëmbjes pas konfliktit në Serbi.

Shumica e viktimave identifikohen vetëm si viktima. Më të zëshmit publikisht janë grupet e refugjatëve dhe familjeve të personave të zhdukur nga Kroacia dhe Kosova (kategoritë 1, 2, 3 dhe 4). Refugjatët nga Kroacia e shohin veten si viktima të krimeve të luftës, spastrimit etnik, kërkimit të tejzgjatur për anëtarët e humbur të familjes,²⁹ dhe neglizhencës dhe diskriminimit nga shteti serb.³⁰ Refugjatët nga BeH nuk janë aq të dukshëm publikisht sa refugjatët dhe PZH-të e tjerë, për shkak të numrit të tyre më të vogël në Serbi.³¹ Megjithatë, statusi i tyre i viktimës përfshihet në debatin publik dhe iniciativat e udhëhequra nga grupet e viktimave. PZH-të nga Kosova e perceptojnë veten si viktima të vrasjeve që lidhen me luftën, rrëmbimeve, dëbimeve, torturave, spastrimit etnik, tendencës së pasluftës për t'i fshehur këto krime dhe manipulimit dhe neglizhencës nga bashkësia ndërkombëtare.³² PZH-të nga Kosova, të cilët gjithashtu janë në kërkim të anëtarëve të zhdukur të familjeve të tyre, e kanë më me prioritet çështjen e zhdukjes me forcë sesa statusin e tyre si persona të zhvendosur. Disa nga refugjatët serbë dhe PZH nga Kroacia, BeH dhe Kosova e perceptojnë veten si viktima më të mëdha të luftërave në ish-Jugosllavi.³³

27Jovana Kolarić, 2019. Dosja: Krimet kundër Kroatëve në Vojvodinë, FDH.

28Përfaqësues të Fondit për të Drejtën Humanitare në bashkëbisedim me autorin.

29Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

30Miodrag Linta, 20 maj 2021, mbledhja e 12-të e seancës së parë të rregullt të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë në vitin 2021.

31Përfaqësues të Fondit për të Drejtën Humanitare në bashkëbisedim me autorin.

32Shoqata e Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi, në dispozicion **këtu**; Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

33Miodrag Linta, 8 prill 2021, mbledhja e 6-të e seancës së parë të rregullt të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë në vitin 2021.

Përveç të qenit viktimë të krimeve të luftës, anëtarët e familjeve të personave të zhdukur e konsiderojnë veten viktimë të një procesi të stërzgjatur dhe të politizuar të kërkimit të eshtrave, përcaktimit të rrethanave të zhdukjes së tyre dhe si viktimë të anashkaluara në diskursin publik për t'i dhënë hapësirë autorëve të krimit.³⁴ Familjarët e personave të zhdukur në luftën në Kosovë besojnë se familjarët e tyre mund të jenë viktimë të trafikimit të organeve njerëzore.³⁵

Boshnjakët e Sanxhakut e perceptojnë veten si viktimë të terrorit shtetëror, torturës policore, sjelljes së paligjshme të policisë serbe dhe pjesëtarëve të forcave të armatosura dhe dëbimeve. Familjarët e personave të rrëmbyer në Shtërpçi dhe Sjeverin e konsiderojnë veten viktimë të krimeve të luftës. Të dy grupet përmendin gjithashtu heshtjen rreth asaj që u ka ndodhur, që do të thotë se shumica e qytetarëve jashtë zonës së tyre nuk dinë asgjë për atë që ata kanë vuajtur.³⁶ Kjo ndodhë për shkak të mosgatishmërisë afatgjatë të shtetit për ta marrë përgjegjësinë, si dhe suksesit të kufizuar të udhëheqësve boshnjakë për ta vendosur këtë çështje në agjendën socio-politike kombëtare.³⁷

Edhe pse refugjatët e rekrutuar me forcë në ushtrinë serbe dhe familjet e tyre e ndejnë veten viktimë të padrejtësisë së shkakuar nga shteti, ata përmbahen nga profilizimi publik i tyre si viktimë. Arsyeja kryesore për këtë është stigmatizimi i tyre si tradhtarë dhe frikacakë që u larguan nga shtëpitë e tyre duke pritur që të tjerët t'i mbrojnë.³⁸

Narrativa e viktimizimit është pothuajse e pranishme edhe në mesin e viktimave shqiptare të krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur të brendshëm të vitit 2000–2001 në Luginën e Preshevës ose në mesin e viktimave të represionit shtetëror kundër shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. Tashmë të stigmatizuara në Serbi, këto grupe u etiketuan si terroristë, separatistë dhe armiq të shtetit, duke i bërë ata të frikësohen që të flasin publikisht për këto ngjarje dhe të paraqiten si viktimë.³⁹

³⁴Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

³⁵Buletini *E paharrueshmja*, nr. 16, në dispozicion në serbisht [këtu](#). Krimet e dyshuara të kryera nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës në Kosovë kundër civilëve aktualisht po hetohen dhe gjykohen në Dhomat e Specializuara të Kosovës, një gjykatë ndërkombëtare sipas ligjit të Kosovës, me seli në Hagë.

³⁶Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

³⁷Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

³⁸Përfaqësues të Fondit për të Drejtën Humanitare në bashkëbisedim me autorin.

³⁹Përfaqësues të Fondit për të Drejtën Humanitare në bashkëbisedim me autorin; Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedim me autorin.

VIKTIMAT CIVILE TË LUFTËS SIPAS LIGJIT SERB

Ligji për të drejtat e veteranëve, invalidëve të luftës, invalidëve civilë të luftës dhe anëtarëve të familjeve të tyre⁴⁰ njih katër kategori civilësh si viktimë të luftës:

1. Viktimë civile e luftës
2. Invalidi civil i luftës
3. Anëtar i familjes së viktimës civile të luftës
4. Anëtar i familjes së invalidit civil të luftës

Viktimë civile e luftës është shtetasi i Republikës së Serbisë i cili ka humbur jetën si civil në këto rrethana:

- 1.1 si pasojë e keqpërdorimit ose heqjes së lirisë nga armiku gjatë luftës ose gjatë kryerjes së operacioneve luftarake në territorin e Republikës së Serbisë
- 1.2 nga materiali i mbetur luftarak në territorin e Republikës së Serbisë
- 1.3 si viktimë e një sulmi në misionin diplomatik ose konsullor të Republikës së Serbisë ose gjatë rrugës për në atë mision, në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare brenda kompetencave të Republikës së Serbisë në cilësinë e punonjësit.

Një civil i zhdukur në këto rrethana konsiderohet gjithashtu viktimë civile e luftës.

Invalid civil i luftës është shtetasi i Republikës së Serbisë, i cili, për shkak të plagës ose lëndimit ka pësuar dëmtime në trup të paktën 50 përqind:

- 1) si pasojë e keqpërdorimit ose heqjes së lirisë nga armiku gjatë luftës ose gjatë kryerjes së operacioneve luftarake në territorin e Republikës së Serbisë.
- 2) nga materiali i mbetur luftarak në territorin e Republikës së Serbisë
- 3) si viktimë e një sulmi në misionin diplomatik ose konsullor të Republikës së Serbisë ose gjatë rrugës për në atë mision, në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare brenda kompetencave të Republikës së Serbisë në cilësinë e punonjësit.

Së dyti, Ligji njih si anëtarë të **familjes së viktimës civile të luftës dhe invalidit civil të luftës** vetëm ata që kanë jetuar me viktimën civile të luftës në një familje të përbashkët për të paktën një vit para vdekjes së tij/saj. Për më tepër, ligji konsideron se anëtar i familjes është:

- 1) një bashkëshort ose një person që jetonte në një bashkësi jashtëmartesore me një viktimë civile të luftës dhe kishte një fëmijë me të
- 2) një fëmijë i lindur brenda ose jashtë martese dhe një fëmijë i adoptuar
- 3) një pastor i cili mbështetej nga një viktimë civile e luftës
- 4) prindi ose prindi adoptues, i cili mbështetej nga një viktimë civile e luftës
- 5) njerku dhe njerka, të cilët mbështeteshin nga një viktimë civile e luftës.

⁴⁰Akti për të drejtat e veteranëve, invalidëve të luftës, invalidëve civilë të luftës dhe anëtarëve të familjeve të tyre, (Zakon o pravima boraca, vojnih invalida, civilnih invalida rata i članova njihovih porodica), Gazeta Zyrtare e RS nr. 18/2020.

Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH), rreth 15,000 njerëz që jetojnë në Serbi duhet të përfitojnë nga ligji që synon t'i mbështesë viktimat civile të luftës.⁴¹

PËRFAQËSIMI I GRUPEVE TË VIKTIMAVE

Grupet e organizuara zyrtarisht regjistrohen si shoqata ose aleanca të qytetarëve. Ato udhëhiqen nga dikush që është vetë viktimë, dhe shumica (nëse jo të gjithë) anëtarët janë viktima. Ndryshimet në udhëheqje janë të rralla, kryesisht për shkak të vdekjes ose dorëheqjes për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme. Grupet joformale zakonisht koordinohen dhe/ose përfaqësohen nga një person, i cili shpesh është më i pranishëm në publik.

Viktimat nga luftërat në Kosovë dhe Kroaci (1, 2, 3 dhe 4) janë organizuar zyrtarisht. Aktualisht ekzistojnë të paktën pesë shoqata kombëtare të përbëra nga serbët e Kosovës,⁴² disa prej të cilave rrjedhin nga një shoqatë që u formua në fillim të viteve 2000. Ndarjet dhe mosmarrëveshjet e brendshme çuan në ndarjen e shoqatës në disa shoqata më të vogla. Këto shoqata bashkojnë anëtarët e familjeve të personave të zhdukur ose të vrarë në incidente të lidhura me luftën gjatë dhe pas luftës 1998–1999 në Kosovë. Shumica e anëtarëve, në mos të gjithë, janë vetë PZh.

Shoqata më aktive e serbëve nga Kroacia është themeluar në vitin 1998, tre vjet pas përfundimit të luftës 1991–1995 në Kroaci.⁴³ Përveç bashkimit të familjeve të personave të zhdukur ose personave të vrarë gjatë luftës, kjo shoqatë përfshin njerëz që ikën ose u detyruan të largoheshin nga Kroacia. Ekziston edhe një numër i konsiderueshëm i shoqatave të tjera të refugjatëve nga Kroacia, disa prej të cilave po marrin pjesë në punën e dy koalicioneve që merren me refugjatët nga Kroacia dhe BeH.⁴⁴ Shoqata më e vjetër e viktimave të luftës në Kroaci, Shoqata e Prindërve dhe Familjeve të Personave të Arrestuar, të Paraburgosur dhe të Zhdukur të Republikës Federale të Jugosllavisë, po ashtu vazhdon të funksionojë, ndonëse në një shkallë më të vogël.

Shoqatat e familjeve të personave të zhdukur janë anëtarë të një organizate ombrellë të 60 shoqatave serbe në mbarë rajonin.⁴⁵

Disa grupe bëjnë bashkë persona të zhvendosur nga Kosova, duke u ofruar atyre ndihmë humanitare dhe duke ruajtur traditat dhe trashëgiminë e tyre kulturore.⁴⁶ Koalicioni i PZh-ve nga Kosova dhe Metohia ka funksionuar që nga viti 2015, por ka pikëpyetje në lidhje me atë se sa përfaqësues është.⁴⁷ Përfaqësuesit

41 Relja Radosavljević, 2017. Korniza ligjore dhe institucionale në Serbi në lidhje me të drejtat dhe nevojat e viktimave civile të luftës, Beograd: FDH.

42 Shoqata e Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi; Shoqata e Familjeve të Rrëmbyer dhe Vrarë në Kosovë dhe Metohi; Shoqata "Kosmetski stradalnici" (Të vuajturit nga Kosova); Shoqata e Grave nga Kosova dhe Metohia; Shoqata e personave të kidnapuar, të vrarë dhe të zhvendosur nga Kosova dhe Metohia „Paštrik”; Burimi: Baza e të dhënave të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Serbe (ARBS), në dispozicion [këtu](#); [Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin](#).

43 Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur dhe të Vrarë "Suza" (Një lot). Burimi: Baza e të dhënave SBRA.

44 Koalicioni i Shoqatave të Refugjatëve në Serbi, dhe Koordinimi i Shoqatave të Refugjatëve dhe PZHBV-ve në Republikën e Serbisë. Burimi: Baza e të dhënave SBRA.

45 Koordinimi i shoqatave serbe të familjeve të të zhdukurve, të vrarëve dhe personave të vrarë nga ish-Jugosllavia. Duško Čelić, 2020. Në pritje të Ligjit për Personat e Zhdukur, buletini "Loti", Nr.56, fq. 13-15, në dispozicion në [serbishtkëtu](#).

46 Asociacioni i qytetarëve të Qarkut të Mitrovicës së Kosovës; Shoqata e Qytetarëve "Izvor – Istok"; etj. Burimi: Baza e të dhënave të Agjencisë së Regjistrimeve të Bizneseve Serbe. [Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin](#).

47 Jelena Krstiq, 2016. Drejtësia Tranzicionale në Serbi në periudhën 2013-2015, FDH. Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

përkatës të grupeve të viktimave të intervistuar për këtë studim thonë se nuk kanë dëgjuar për Koalicionin apo përfaqësuesin e tij, gjë që nënkupton se Koalicioni nuk përfaqëson shumë viktime.

Kategoritë e tjera të viktimave ose janë të lidhura shumë pak ose nuk kanë lidhje fare. Familjet e njerëzve që u rrëmbyen dhe/ose u vranë në Shtërpçi dhe Sjeverin përfaqësohen publikisht nga një deri në dy persona⁴⁸ dhe mbliidhen për raste të tilla si aktivitetet për kujtimore ose aksionet avokuese. Ish të burgosurit politikë, të cilët ishin viktime të terrorit shtetëror në Sanxhak, krijuan një shoqatë joformale, megjithëse ky grup është gjithnjë e më pak aktiv për shkak të moshës dhe ndonjëherë sëmurjes së anëtarëve të tij.⁴⁹ Viktimat e dëbimit nga komuna e Priboj janë organizuar në shoqatë formale, por kjo shoqatë vuan nga përçarjet e brendshme për çështjen e pronësisë.⁵⁰

Viktimat e renditura nën 6, 7, 10 dhe 11 nuk janë as të lidhura dhe as të organizuara në grupe dhe deri më tani nuk është regjistruar asnjë iniciativë e përbashkët.

Grupet e viktimave janë formuar rreth çështjeve të pazgjidhura që lidhen me:

- **zhvendosjen**
 - mbështetjen e integritit të refugjatëve, duke përfshirë strehimin, punësimin, marrjen e dokumenteve dhe kujdesin social dhe shëndetësor
 - Mbështetja e kthimit vullnetar në Kroaci ose BeH, duke përfshirë rindërtimin e shtëpive, zhvillimin e komuniteteve të kthimit, përmbushjen e të drejtave politike dhe kulturore dhe rivendosjen e të drejtave të refugjatëve për pronën (në vendet nga ikën)
- **drejtësinë**
 - fushata për ndjekjen penale të krimeve⁵¹
- **e vërteta**
 - krijimi, ruajtja dhe publikimi i listës së viktimave
 - zgjidhja e fatit të personave të zhdukur – serbët gjatë luftës në Kroaci, serbët dhe anëtarët e komunitetit joshqiptarë gjatë dhe pas luftës në Kosovë, boshnjakët dhe një kroat i rrëmbyer në Strpci dhe Sjeverin i cili u vra në BeH.
 - përsheptimi i zhvarrimeve dhe identifikimi i mbetjeve mortore
 - ngritja e ndërgjegjësimit të publikut për personat e zhdukur dhe vuajtjet e serbëve, dhe avokimi që autoritetet përkatëse të përfshijnë çështjen e personave të zhdukur në diskutimet politike midis Serbisë dhe vendeve të tjera pjesë e ish-Jugosllavisë.
- **reparacionet**⁵²
 - rindërtimi i pronës së shkatërruar dhe sigurimi i një sërë të drejtash sociale,

48 Nail Kajeviq, i dëmtuar në rastin Shtërpçi, Transkript i audio-incizimit nga seanca gjyqësore e mbajtur më 3 prill 2019, f. 11, në dispozicion në serbisht [këtu](#). Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

49 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

50 Përfaqësuesi i Komitetit të Sanxhakut për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në bashkëbisedim me autorin.

51 Në juridiksionet përkatëse në varësi të grupit të viktimave: serbët nga Kosova janë të fokusuar në Dhomat e Specializuara në Kosovës, serbët nga Kroacia kërkojnë drejtësi nga gjykatat kroate dhe boshnjakët nga Sanxhaku në Serbi u drejtohen gjykatave serbe.

52 Nga juridiksioni/vendi të cilin e konsiderojnë përgjegjës për vuajtjet e tyre, p.sh. Kroacia për serbët që ikën nga Kroacia, BeH për serbët që ikën nga BeH, Kosova për serbët që ikën nga Kosova, Serbia për boshnjakët nga Sanxhaku. Të gjithë kërkojnë statusin e "viktimit civil të luftës" nga Serbia, e cila mund t'u sjellë atyre një mbështetje socio-financiare, si dhe dëmshpërblime simbolike siç janë monumentet. Familjet e personave të zhdukur kërkojnë statusin e "familjes së personave të zhdukur", për t'u sjellë atyre njohje dhe mbështetje socio-ekonomike. Viktimat boshnjake nga Sanxhaku kërkojnë statusin e "invalidit civil të luftës" dhe dëmshpërblimet për lëndimet e shkatëruara përmes torturës, represionit, ngacmimit, etj.

ekonomike dhe ligjore për ata që u është dhënë statusi i viktimave civile të luftës

- mbajtja gjallë e kujtimit të viktimave të zhdukjes me forcë dhe vrasjeve
- ofrimi i mbështetjes psikologjike dhe ligjore për familjet e personave të zhdukur;
- politikëbërja, p.sh. pjesëmarrja në grupin e punës për hartimin e ligjit për personat e zhdukur; dërgimi i komenteve gjatë përgatitjes së Ligjit për të drejtat e veteranëve, invalidëve ushtarakë, invalidëve civilë të luftës dhe familjarëve të tyre

- **të tjera**

- koordinimi i punës së shoqatave me misione të ngjashme
- ruajtja e kulturës dhe traditës së serbëve nga pjesë të ndryshme të ish-Jugosllavisë.

Grupet e viktimave kryejnë veprime të ndryshme për t'i përmbushur misionet e tyre, duke përfshirë:

- Mbledhja e informacionit dhe mbajtja e bazave të të dhënave për viktimat dhe krimet
- Përkujtimi i viktimave dhe përvjetorëve të tyre
- Ofrimi i mbështetjes për familjet e personave të zhdukur, duke përfshirë edhe gjatë zhvarrimeve dhe identifikimit, si dhe në komunikimet e tyre me institucionet shtetërore dhe autoritetet e tjera
- Botimi i botimeve periodike, të tilla si buletinet, fletëinformacionet, raportet dhe njoftimet për shtyp
- Organizimi i ngjarjeve publike (konferenca për shtyp, tryeza, etj.), informimi i publikut për ngjarje ose zhvillime të caktuara, ose avokimi për masa të caktuara
- Tregimi i historive të viktimave
- Inkurajimi i familjeve që të raportojnë tek autoritetet përkatëse familjarin e tyre të zhdukur
- Pjesëmarrja në grupet punuese që merren me çështjen e personave të pagjetur
- Ofrimi i ndihmës humanitare për familjet më të rrezikuara
- Ofrimi i mbështetjes ligjore për viktimat në kërkesat e tyre për kompensim material
- Bashkëpunimi me grupet e tjera të viktimave, autoritetet kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe gjykatat
- Krijimi i politikave: hartimi i ligjit për personat e zhdukur dhe pjesëmarrja në hartimin e ligjeve të tjera përkatëse, siç është ligji që rregullon statusin e viktimave civile të luftës.

Shumica e grupeve të viktimave fokusohen në zgjidhjen e shqetësimeve të tyre personale, si gjetja e anëtarëve të familjes të zhdukur në luftë, ndjekja penale e atyre që janë përgjegjës për vdekjen e një anëtari të familjes, marrja e dëmshpërblimit, përmbushja e të drejtave pronësore, etj. Asnjë nga grupet nuk është i angazhuar në mision më të gjerë për ta promovuar paqen dhe/ose për të avokuar për drejtësinë tranzicionale në një kuptim më të gjerë shoqëror.

Në shumicën e rasteve, viktimat dhe grupet e viktimave nuk e lidhin situatën e tyre me kontekstin/procesin e drejtësisë tranzicionale. Avokimi për drejtësinë tranzicionale ose ballafaqimi me të kaluarën në aspektin e koncepteve/ideve është sporadik dhe në dukje nuk kanë njohuri më të thella të konceptit dhe rëndësisë së tij për ta.⁵³ Ata janë të prekur personalisht, dhe kështu janë fokusuar në zgjidhjen e problemeve të tyre në

⁵³Një shembull i tillë është Koordinimi i Shoqatave Serbe të Familjeve të të Zhdukurve, të Vrarëve dhe të Personave të Vrarë nga ish-Jugosllavia, që përkushtohet për "ballafaqim me të kaluarën, gjetjen e së vërtetës dhe përmbushjen e drejtësisë". Burimi: Faqja e internetit e Koordinimit, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

vend që të eksplorojnë koncepte abstrakte të rimëkëmbjes pas konfliktit.⁵⁴ Edhe pse nuk e përmendin në intervista, ata megjithatë shprehen në deklaratat me shkrim se zgjidhja e problemeve me të cilat përballesh është çelësi për pajtim⁵⁵, stabilitet dhe një të ardhme paqësore në rajon.⁵⁶ Përveç kësaj, ata thirren në të drejtën e tyre për të vërtetën⁵⁷ dhe reparacionet,⁵⁸ dhe paralajmërojnë për përsëritjen e dhunës nëse trashëgimia e së kaluarës mbetet e pazgjidhur.⁵⁹

Asnjë platformë e përbashkët gjithëpërfshirëse e viktimave nuk është iniciuar apo krijuar midis grupeve të viktimave. Që nga viti 2006, nisma KOMRA ka ofruar një platformë për bashkëpunimin e grupeve të viktimave në të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, dhe shumë grupe me bazë në Serbi janë anëtarë të koalicionit rajonal që avokon për krijimin e një organi rajonal për kërkimin e fakteve.⁶⁰ Mirëpo, periudha më dinamike e shkëmbimit të tyre përfundoi me përfundimin e procesit konsultativ për mandatin e KOMRA-s në vitin 2011. Edhe pse ende zyrtarisht janë anëtarë të Koalicionit, që atëherë, jo të gjitha grupet po marrin pjesë aktive në këtë iniciativë. Disa viktimë kanë humbur shpresën se do të ketë ndonjëherë vullnet të mjaftueshëm politik për krijimin e një komisioni të tillë.⁶¹

Shoqatat e familjeve të personave të zhdukur bashkëpunojnë në nivel kombëtar përmes Koordinimit të Shoqatave Serbe të Familjeve të të Zhdukurve dhe të Vrarëve nga Territori i Ish-Jugosllavisë, dhe në nivel rajonal përmes Koordinimit Rajonal të Familjeve të Personave të Zhdukur nga ish-Jugosllavia. Këto platforma shtyjnë autoritetet ndërkombëtare dhe vendore të përshpejtojnë dhe të angazhohen për zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur.⁶²

Bashkëpunimi zakonisht bëhet midis grupeve me mision të njëjtë ose të ngjashëm, ose atyre të fokusuar në të njëjtën ngjarje të luftës. Partneritetet në vija etnike, kombëtare dhe fetare ose ndërmjet viktimave të ngjarjeve të ndryshme të dhunshme janë të rralla, por ekzistojnë. Një shembull i tillë është bashkëpunimi në mes të shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga Serbia dhe Kosova, të cilat bashkërisht u drejtohen institucioneve përkatëse, organizojnë ngjarje dhe përvjetorë si në Serbi ashtu edhe në Kosovë.⁶³

Disa grupe janë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare, siç është rasti me Shoqatën e Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi, e cila është anëtare e Federatës Euro-Mesdhetare Kundër

54 Matthew Holliday, Drejtues i Programit të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur në Ballkanin Perëndimor, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, në bisedë me autorin.

55 Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, 30 Gusht 2020, Shoqata e Familjeve "Kosmetiski stradalnici", në dispozicion në serbisht [këtu](#).

56 Koordinimi Rajonal i Familjeve të Personave të Zhdukur: Fati i 11,000 personave ende i pazgjidhur, Gusht 2019, Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur dhe të Vrarë "Suza", në dispozicion në serbisht [këtu](#).

57 Duško Čelić, 2020. Në pritje të Ligjit për Personat e Zhdukur, buletini "Loti", Nr.56, fq. 13-15, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

58 Faqja e internetit e Shoqatës së Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

59 Natasha Šćepanović, Nuk jemi të lodhur nga Lufta e gjatë dy dekadash për të vërtetën dhe drejtësinë për viktimat serbe të luftës, buletini "E paharrueshmja", Nr.16, shkurt-mars 2020, f.3, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

60 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin. Buletini "E paharrueshmja", Nr.16, Shkurt-Mars 2020, në dispozicion [këtu](#).

61 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

62 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

63 Tryezë diskutimi në Nish, 20 tetor 2020, Shoqata e familjeve "Kosmetiski stradalnici", në dispozicion në serbisht [këtu](#). Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, 2 Shtator 2020, Shoqata e Familjeve "Kosmetiski stradalnici", në dispozicion në serbisht [këtu](#). Matthew Holliday, Shefi i Programit të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur në Ballkanin Perëndimor në bashkëbisedë me autorin.

Zhdukjeve me Forcë.⁶⁴

Ndër arsyt e bashkëpunimit modest me homologët e tyre në vende të tjera është politizimi i perceptuar i grupeve nga ana tjetër e kufirit dhe i një etnie tjetër.⁶⁵

Grupet e viktimave që përfshijnë serbët nga Kosova dhe Kroacia kanë arritur bashkëpunim të mirë në nivel lokal me veteranët e luftës, me të cilët ndonjëherë ndajnë anëtarë dhe zyra.⁶⁶ Për shembull, viktimat civile dhe veteranët e luftës së bashku ngritën një monument kushtuar të gjitha viktimave serbe dhe të gjithë luftëtarëve serbë në një nga sheshet e qendrës së qytetit të Beogradit.

Grupet e viktimave serbe nga Kroacia, si dhe grupet e refugjatëve serbë nga Kroacia, përfaqësohen në nivel lokal përmes degëve lokale ose grupeve të përbëra nga anëtarë të një lokaliteti të caktuar. Veç kësaj, partneritetet me grupe të tjera lokale, veçanërisht me veteranët e luftës, i promovojnë ata në nivel lokal – në rastin e grupeve të viktimave, zakonisht përmes udhëheqësve të tyre.⁶⁷

Viktimat boshnjake të terrorit shtetëror në Sanxhak dhe rrëmbimeve në Shtërpçi dhe Sjeverin janë të njohura brenda grupit të tyre etnik, si dhe prej autoriteteve lokale, komunitetit fetar dhe sektorit të shoqërisë civile. Këto viktima gjithashtu mund të mbështeten në solidaritetin e qytetarëve vendas nga grupet e tjera etnike.⁶⁸

Duke pasur parasysh hezitimin e tyre për t'u perceptuar si viktima, personat që u mobilizuan me forcë nuk njihen dhe as nuk janë aktiv në nivel lokal. Viktimat shqiptare të krimeve të kryera gjatë luftës së Kosovës 1998–1999 dhe konfliktit të brendshëm 2000–2001 në Luginën e Preshevës janë të njohura për bashkëqytetarët e tyre vendas, autoritetet dhe grupet qytetare, por nuk ka asnjë iniciativë në mesin e tyre për ta adresuar situatën pas konfliktit. Për shkak se etiketohen si terroristë, kanë frikë të dalin hapur dhe të këmbëngulin për masa konkrete, dhe janë të detyruar të fokusohen në mbijetesën e përditshme për shkak të privimit ekonomik dhe diskriminimit bazuar në përkatësinë e tyre etnike, duke përfshirë rritjen e spastrimit etnik administrativ.⁶⁹

VIKTIMAT GRA DHE ASPEKTET GJINORE

Pavarësisht të dhënave zyrtare që tregojnë se 26 përqind e grave e konsiderojnë veten të prekura nga lufta,⁷⁰ asnjë shoqatë apo grup joformal i viktimave nuk merret me çështjen e dhunës me bazë gjinore në luftë, as nuk njeht aspekte të veçanta të vuajtjeve të grave gjatë dhe pas luftës (p.sh. femra refugjate/PZh, viktima të dhunës në familje me bazë në trauma të luftës, gra pa të afërm të gjallë). Siç thuhet, aspekti gjinor i ndikimit të luftës është i gjithëpranishëm. Shumë gra kanë humbur anëtarët e familjes në fushën e betejës, dhe u është dashur të sigurojnë vetë ushqimin, duke u ndjerë të pasigurta për shkak të konfliktit të stërzgatur, kanë pësuar dhunë, janë përballur me kujdes të pamjaftueshëm shëndetësor, janë

64Burimi: Faqja e internetit e Federatës Euro-Mesdhetare Kundër Zhdukjeve me Forcë (FEMED), në dispozicion [këtu](#).

65Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

66Përfaqësuesit të Qendrës për Veprim jo të Dhunshëm në bashkëbisedë me autorin.

67Përfaqësuesit e Fondit për të Drejtën Humanitare në bashkëbisedim me autorin.

68Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

69Serbia po shpohullon shqiptarët në Luginën e Preshevës në nivele alarmante, Flora Ferati-Sachsenmaier, maj 2020, në dispozicion [këtu](#).

70Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Mirëqenia dhe Siguria e Grave – Raporti i Rezultateve të Serbisë, 2019, në dispozicion [këtu](#).

bërë refugjate, etj.⁷¹ Megjithatë, vetëm zhdukja me forcë e një anëtar i familjes i ka shtyrë gratë në Serbi të organizohen brenda një shoqate të viktimave. Shoqatat e familjeve të personave të pagjetur nga luftërat në Kosovë dhe Kroaci kanë një numër të konsiderueshëm të anëtareve femra dhe, për më tepër, shumica drejtohen nga gratë. Megjithatë, ato nuk janë të lidhura si gra viktimë të luftës dhe as nuk i referohen krimeve me bazë gjinore, përfshirë DhSBGj-në. Përkundrazi, gratë viktimë e perceptojnë veten si nëna, motra, bashkëshorte dhe të afërme të burrave ose grave të zhdukura ose të vrara. Përveç kësaj, ato priren të kërkojnë ose të mbështeten në mendimin e kolegëve të tyre meshkuj.⁷²

Gratë janë më pak të dukshme dhe më pak të zëshme në grupet e tjera të viktimave të përfshira në këtë studim, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me rrëmbimet dhe vrasjet e civilëve në Sjeverin dhe Shtërpci, represionin në luftë në zonën e Sanxhakut dhe refugjatët nga Kroacia. Edhe pse viktimat e dhunës në familje të shkakuar nga një person që vuante nga trauma të luftës nuk u përfshinë në këtë hulumtim, vlen të theksohet se përhapja e dhunës ndaj grave është më e lartë në familjet ku një anëtar ka marrë pjesë në luftë.⁷³ Ky problem është një shembull shumë i qartë se si ngjarjet e pazgjdhura të së kaluarës vazhdojnë ta formësojnë të tashmen dhe t'i prekin edhe ata breza dhe njerëz që nuk e kanë përjetuar kurrë luftën.

Në këto qarqe ekziston një vetëdije modeste për rëndësinë e trajtimit të vuajtjeve të grave. Anëtarët e grupit të viktimave femra vlerësojnë iniciativat për të trajtuar dhunën seksuale gjatë luftës ndaj anëtarëve të grupit të tyre etnik që po marrin hov në disa vende fqinje⁷⁴. Ato gjithashtu theksojnë rëndësinë e programeve që fuqizojnë gratë që ikin nga lufta.⁷⁵ Shoqata 'Lastavica' (Dallëndyshe) u përmend veçanërisht si shoqatë që punon në fuqizimin e grave refugjate.⁷⁶ Ato e njohin situatën sfiduese të grave beqare, të cilat papritmas u bënë të vetmet siguruese të ushqimit në familje, por që ishin gjithashtu nën presion të konsiderueshëm nga shoqëria dhe familjet e tyre për të vazhduar që t'i përballojnë sfidat të vetme.⁷⁷ Megjithatë, këto deklaratat nuk po shndërrohen në veprime konkrete. Kultura mbizotëruese patriarkale, e cila favorizon meshkujt dhe insiston në role strikte gjinore, është ndër faktorët kryesorë që dekurajon gratë që t'i vënë në pah përvojat e tyre. Grave gjithashtu u mungojnë faktorët motivues, si shoqatat e grave viktimë, organizatat e specializuara në DhSBGj dhe mbështetja shtetërore ose/dhe mediatike. Gratë viktimë të krimeve me bazë seksuale gjithashtu përballen me paragjykimet dhe stereotipet rreth këtyre llojeve të veprimeve kriminale.

Nuk ka asnjë grup të organizuar të viktimave të DHSBGJ në Serbi. Ekzistojnë disa raporte për dhunën seksuale gjatë kohës së luftës në ish-Jugosllavi, por nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme për numrin e viktimave femra dhe meshkuj të DHSBGJ-së gjatë konflikteve në vend.⁷⁸ Sipas FDH-së, "ndër arsytet e mosekzistimit të të dhënave të sakta dhe rasteve të dokumentuara të përdhunimeve është fakti se përdhunimi është ende një temë tabu në Ballkan dhe se edhe pas tre dekadash nga ngjarjet në fjalë,

71Po aty.

72Matthew Holliday, Shefi i Programit të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur në Ballkanin Perëndimor, në bashkëbisedë me autorin.

73OSBE, 2019, op cit.

74Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

75Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

76Nisma u lansua në vitin 1996 nga Qendra Autonome e Grave dhe Oxfam në Mbretërinë e Bashkuar. U siguria strehim për gratë beqare refugjate dhe u fuqizuan ato përmes arsimimit, ndërtimit të aftësive dhe sipërmarrjes.

77 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

78Informacioni mbi DhSBGj (gjatë konflikteve) ndaj burrave është shumë i pakët. Një nga burimet e pakta është në kampet e paraburgimit për boshnjakët në Serbi, në dispozicion [këtu](#).

viktimat janë ende duke u stigmatizuar si nga familjet e tyre ashtu edhe nga komunitetet e tyre të afërta.⁷⁹ Disa OJQ punojnë në çështjen e DHSBGJ-së, por nuk ekzistojnë grupe viktimash.

Akti për të drejtat e veteranëve, veteranëve me aftësi të kufizuara, invalidëve civilë të luftës dhe familjeve të tyre, i cili u miratua në mars 2020, nuk përfshin (gratë) të mbijetuarat e dhunës seksuale në kohë lufte si viktima civile të luftës. Viktimat e dhunës seksuale kanë mundësi të kufizuara për të kërkuar zgjidhje dhe dëmshpërblim. Për shembull, ekziston një mundësi për të paraqitur një kërkesë dëmshpërblimi (në këtë rast për dhunën seksuale të kryer gjatë luftës) gjatë procedurave penale kundër atyre që janë përgjegjës për krimet e luftës, por dhomat e gjykatës po i nxisin viktimat të ngrënë padi private në vend të kësaj.

Shumica e grupeve të viktimave që merren me çështjen e personave të zhdukur gjatë luftërave në Kosovë dhe Kroaci udhëhiqen nga gratë. Ato janë viktima të drejtpërdrejta (refugjat, person i plagosur), anëtare të familjes së personave të vrarë, të zhdukur ose të plagosur, ose shpesh të dyja. Në grupet e tjera të viktimave të përfshira në këtë hulumtim nuk kishte gra lidere.

Nevojat specifike të grave viktimat të luftës nuk njihen nga grupet e viktimave. Megjithëse grupet e viktimave nuk e mohojnë statusin e viktimës, ato përgjithësisht anashkalojnë nevojat specifike të grave. Edhe ato OJQ që synojnë t'i adresojnë nevojat e grave viktimat janë të prirura të merren vetëm me DHSBGJ.

POLITIZIMI I STATUSIT TË VIKTIMAVE

Në përgjithësi, interesi i politikanëve të nivelit kombëtar për viktimat sillet nga injoranca në manipulim. Më shumë se njëzet vite pas përfundimit të konfliktit të fundit të armatosur, nevojat e viktimave ende nuk janë trajtuar. Të vetmit mekanizma ekzistues kanë të bëjnë me ndjekjen penale të kriminelëve të luftës, kërkimin e personave të zhdukur dhe integrimin e refugjatëve, ndonëse me arritje modeste. Për disa viktima, edhe ata mekanizma mbeten të paqasshëm.

Viktimat vijnë në vëmendjen e politikanëve vetëm në përvjetorët e krimeve të caktuara, ose kur perceptohen si të dobishme në aspektin politik. Qëndrimi i tyre ndaj grupeve të viktimave ndryshon, duke iu përshtatur narrativës zyrtare se Serbia nuk ishte e përfshirë në luftërat e viteve 1990 dhe se populli serb është viktima më e madhe. Politikanët (dhe Qeveria) interesohen më së shumti për grupet e familjeve të personave të zhdukur nga Kosova dhe Kroacia. Bashkëpunimi zyrtar në nivel operativ është ai ndërmjet shoqatave dhe Komisionit për Persona të Zhdukur të Qeverisë së Republikës së Serbisë. Viktimat marrin pjesë në disa aspekte të punës së Komisionit, ndërsa përfaqësuesit e Komisionit marrin pjesë në aktivitete të organizuara nga grupet e viktimave.

Refugjatët dhe PZh-të gjithashtu gëzojnë një lloj mbështetje politike dhe institucionale, me një organ të posaçëm që është krijuar për të ofruar mbështetje për refugjatët dhe PZh-të – Komisariati për Refugjatë dhe Migrime.⁸⁰ Ky organ bashkëpunon me grupet përkatëse të viktimave përmes shkëmbimit të informacionit, aktiviteteve përkujtimore dhe pjesëmarrjes në ngjarje. Megjithatë, disa përfaqësues të grupeve të viktimave janë të shqetësuar sepse vullneti politik për të vazhduar mbështetjen e refugjatëve dhe PZh-ve po zvogëlohet. Një përfaqësues i popullatës refugjate, i cili është edhe deputet i Kuvendit Kombëtar, është përpjekur të marrë mbështetjen e Qeverisë dhe anëtarëve të Kuvendit për të vazhduar

79FDH, Dokument Politikash: Vendimet për dëmshpërblimin e viktimave të dhunës seksuale në procedurat e krimeve të luftës para gjykatave serbe, qershor

2021: në dispozicion [këtu](#).

80Ligji për Refugjatët, Gazeta Zyrtare 18/92, 45/02.

Programin Rajonal të Banimit, por pa sukses.⁸¹ Rreth 16,780 familje refugjatësh kishin nevojë për strehim në fillim të programit.⁸² Programi planifikoi të ofrojë rreth 7,600 shtëpi midis periudhës 2012 dhe 2017, dhe më vonë u zgjat deri në vitin 2021.⁸³ Deri në gusht 2021, ishin siguruar gjithsej 5,987 njësi,⁸⁴ që do të thotë se rreth 10,800 familje kanë ende probleme strehimi. Parlamenti ka refuzuar vendosjen e kësaj çështjeje në rendin e ditës dhe Qeveria nuk ka ofruar asnjë garanci se do të kërkohet zgjidhje për këta njerëz.

Shteti ofron mbështetje financiare vjetore për disa shoqata të viktimave të serbëve nga Kroacia, Kosova dhe BeH.⁸⁵ Kjo mbështetje, së bashku me një perceptim të imponuar se shteti serb dhe institucionet e tij janë aleati i vetëm i tyre, i jep shtetit kontroll politik mbi shoqatat.

Grupet e viktimave joserbe janë krejtësisht jashtë vëmendjes së politikanëve dhe institucioneve, të cilat nuk tregojnë interes për t'i trajtuar pasojat e luftës me të cilat po përballen joserbët.⁸⁶ Edhe ato procese që janë nisur janë stërzgatur ose nuk përfundojnë, siç është rasti me familjet e personave të rrëmbyer në Shtërpci dhe viktimat e terrorit shtetëror në Sanxhak.⁸⁷ Një përjashtim i rëndësishëm në këtë mes është kryetari i komunës së Prijepoljes, i cili merr pjesë në përkujtimet vjetore të krimit në Shtërpci dhe mbështet familjet e viktimave.

Viktimat e përkatësisë etnike shqiptare nuk njihen si të tilla fare.

Fakti që politikanët dhe institucionet shtetërore kanë pak respekt për viktimat është gjithashtu i qartë nga praktikat e përkujtimit, proceset ligjberëse dhe qasjet strategjike përkatëse. Që nga viti 2015, shteti ka monopolizuar ngjarjet që simbolizojnë përkujtimin e vuajtjeve të viktimave (të Operacionit Stuhia në vitin 1995 dhe fillimin e ndërhyrjes së NATO-s në luftën e Kosovës). Viktimat janë përjashtuar nga këto aktivitete përkujtimore të drejtuara nga shteti, pavarësisht kërkesave nga organizatat e tyre.⁸⁸

Institucionet gjithashtu i kanë shpërfillur kërkesat e viktimave në lidhje me të drejtat e tyre sipas ligjit që rregullon statusin e viktimave civile të luftës. Ligji i parë, i miratuar në vitin 1996, diskriminonte disa kategori viktimash. Në mesin e të përjashtuarve ishin familjet e personave të zhdukur, viktimat e DHSBGJ-së, të mbijetuarit me lëndime më pak të rënda fizike ose sëmundje mendore dhe ata, sëmundja e të cilëve u konsiderua psikosomatike.⁸⁹ Personat e shënjestruar nga forcat serbe, si dhe ata që pësuan dëme jashtë territorit të Serbisë, gjithashtu nuk njiheshin si viktimat civile pasi ligji ishte i paqartë dhe lejonte interpretime të ndryshme nga rasti në rast. Atyre që kualifikoheshin për mbështetjen e shtetit iu dhanë kompensime modeste në para, por vetëm pasi të vërtetonin se ishin duke jetuar në kushte të vështira socio-ekonomike. Ligji i ri i miratuar në vitin 2020 vazhdoi t'i përfshinte të gjitha masat diskriminuese të mësipërme, por tani shpreh qartë se sipas ligjit serb viktimat civile janë vetëm ata që kanë vuajtur

81 Miodrag Linta, 13 Prill 2021, Mbledhja e 7-të e Seancës së Parë të Rregullt të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë në vitin 2021.

82 Programi rajonal stambenog zbrinjavanja (Programi Rajonal i Strehimit), Broshurë, në dispozicion [këtu](#).

83 Programi Rajonal i Strehimit në Serbi, janar 2021, Fleta e të dhënave, në dispozicion [këtu](#); Të drejtat ekonomike dhe sociale

për personat e zhvendosur me forcë gjatë konflikteve në ish-Jugosllavi, Koncept Dokumenti i Konferencës, 27 – 28 qershor 2017, në dispozicion [këtu](#).

84 Programi Rajonal i Strehimit në Serbi, gusht 2021, Fleta e të dhënave, në dispozicion [këtu](#).

85 Raport për punën e Komisionit për Persona të Zhdukur për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2019, në dispozicion [këtu](#). Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

86 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

87 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

88 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

89 Relja Radosavljević, 2017.

nga forcat armike jashtë Serbisë. Kjo dispozitë në mënyrë eksplicite përjashton shumicën e viktimave të përfshira në këtë raport, veçanërisht viktimat boshnjake nga Sanxhaku dhe viktimat shqiptare nga Lugina e Preshevës. Për më tepër, ky ligj u jep më shumë përparësi veteranëve të luftës sesa viktimave civile, duke u ofruar atyre mbështetje dhe shërbime më të mëdha materiale.

Viktimat që marrin vëmendjen më të madhe dhe të vazhdueshme ligjore janë refugjatët/PZH-të. Ligji i parë që trajton gjendjen e vështirë të refugjatëve u miratua në vitin 1992 dhe qasja strategjike u zhvillua në fillim të viteve 2000. Strategjia e tretë skadoi në vitin 2020 dhe një e re për periudhën 2021–2025 ishte parashikuar të miratohej në vitin 2021. Megjithatë, edhe në fillim të vitit 2022 ajo ende nuk është miratuar.⁹⁰ Në anën tjetër, viktimat e DHSBGJ gjatë luftës janë tërësisht të neglizhuara⁹¹, dhe disa kategori të viktimave civile të luftës po përpiqen të fitojnë mbështetjen e shtetit duke përdorur strategji të ndryshme (padi, marrja e statusit të viktimës civile të luftës). Siç u tha më lart, ato përfshijnë familjet e personave të zhdukur, grupet etnike joserbe që vuajtën nga forcat serbe të sigurisë, të mbijetuarit që vuajnë pasojat psikologjike të luftës, viktimat me aftësi të kufizuara fizike në më pak se 50 për qind të trupit të tyre, dhe refugjatët e shpërngulur me forcë.

Dispozitat në Ligjin mbi Memorialet e Luftës⁹² ndalojnë ngritjen e monumenteve që nuk i kushtohen luftërave çlirimtare të Serbisë, si dhe atyre që simbolizojnë humbjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë.⁹³ Ligji gjithashtu lë hapësirë për interpretime fleksibile të asaj që përbën një fakt historik.⁹⁴ Duke pasur parasysh narrativën zyrtare të Serbisë se ajo mbrojti popullin e saj vetëm në luftërat jugosllave të viteve 1990, dhe qëndrimin e saj ndaj shkëputjes së paligjshme të Kosovës, shumica e viktimave jo-serbe nuk përkujtohen sipas këtij ligji. Disa përmendore tashmë janë hequr, madje edhe para miratimit të këtij ligji, siç ishte rasti me memorialet e Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB).⁹⁵

Megjithatë, dhjetëra memoriale kushtuar UÇPMB-së ende ekzistojnë në të gjithë Serbinë jugore,⁹⁶ si dhe memorialet për viktimat e rrëmbimit në Sjeverin dhe Shtërpci të Sanxhakut, të cilat gjithashtu janë të përjashtuar sipas ligjit. Për shembull, në vitin 2021 një memorial për komandantin e UÇPMB-së po ndërtohej afër fshatit Tërnovë, në komunën e Bujanocit.⁹⁷ Një mospërputhje e tillë ndërmjet dispozitave ligjore dhe praktikës, si dhe ndërmjet praktikave të ndryshme, dëshmon se aktivitetet përkujtimore janë politizuar dhe se disa memoriale ngriten vetëm për përfitime politike.

Në përgjithësi, ekziston një qëndrim i fortë midis grupeve të viktimave dhe akterëve të shoqërisë civile që deklaratat e mbështetjes dhe disa mekanizma institucionalë nuk shndërrohen në angazhim të sigurtë dhe të përkushtuar për të zgjidhur të gjitha çështjet me të cilat përballen viktimat pas konfliktit.

⁹⁰Plan rada Vlade za 2021. godinu (Plani Vjetor i Punës 2021), Shkurt 2021, Qeveria e Republikës së Serbisë.

⁹¹Srbija ne priznaje žrtve silovanja u ratu (Serbia nuk i njeh viktimat e përdhunimeve të luftës), 26 shtator 2017, Radio Evropa e Lirë, në dispozicion në serbisht [këtu](#)

⁹²Ligji për Memorialet e Luftës, Gazeeta Zyrtare Nr.50/2018.

⁹³Po aty, neni 20.

⁹⁴Po aty.

⁹⁵Krstiq, 2016 vep cit.

⁹⁶Marko Milosavljević, 2019. "Ligji për Memorialet e Luftës në Serbi: Monopoli Nacionalist mbi Kujtesën, Perspektiva Ballkanike – Revistë mbi Ballafaqimin me të Kaluarën, Numri 11.

⁹⁷"Leši iznad V.Trnovca dobija memorijal, radovi u toku" (Leši merr memorialin në Tërnovac të Madh, në ndërtim e sipër), Bujanovačke, 8 prill 2021, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

Shumica e politikanëve opozitarë nuk shfaqin interes për këtë gjë. Një parti politike kohët e fundit ka iniciuar një mekanizëm për kthimin e pronave të konfiskuara nga Partia Socialiste e Serbisë (PSS), partia në pushtet gjatë krizës dhe luftërave të viteve 1990, dhe duke përdorur 50 për qind të kësaj prone ka ofruar dëmshpërblim për viktimat e regjimit të Slobodan Millosheviçit, por vetëm për viktimat të dhunës politike.⁹⁸ Poashtu, asnjë politikan opozitar nuk e ka vizituar Serbinë jugore apo Sanxhakun kohët e fundit, për të kontaktuar me këto komunitete dhe grupe viktimash.⁹⁹

Duhet të theksohet gjithashtu se disa grupe viktimash janë politizuar dhe janë shumë të ndikuar nga narrativa zyrtare e viktimizimit serb. Ata e identifikojnë vuajtjen e tyre me atë të shtetit serb, i cili i vë në një pozicion ku zgjidhjet që ata i kërkojnë janë ato të imponuara nga politikanët, dhe jo ato që mund të plotësojnë nevojat e tyre. Kjo i izolon ata nga çdo bashkëpunim i sinqertë apo domethënës ndëretnik apo ndërkuftar, i cili mund të sjellë strategji të reja dhe një ndjenjë mbështetjeje. Disa grupe dhe individë kanë dalë hapur në anën e partive në pushtet dhe kanë ndjekur synime politike në vend që të ofrojnë hapësirë që viktimat të dëgjohen brenda institucioneve.¹⁰⁰

NEVOJAT E PAPLOTËSUARA TË VIKTIMAVE TË LUFTËS

Viktimat në Serbi ende janë në kërkim të kompensimit, të së vërtetës, drejtësisë dhe njohjes nga ana e shoqërisë.¹⁰¹ Ata jetojnë në vështirësi socio-ekonomike, përballen me pengesa në përmbushjen e të drejtave të tyre dhe me traumat e pasluftës.

Në përmbledhje, analiza e nevojave identifikoi këto çështje prioritare:

Nevojat socio-ekonomike – Shumë persona të zhvendosur dhe familje të viktimave nga Kosova janë të pafavorizuara dhe të marginalizuara në aspektin material, pjesërisht për shkak se nuk kanë qenë në gjendje të menaxhojnë me pronën e tyre në Kosovë. Ata gjithashtu përballen me papunësi dhe banim të papërshtatshëm, ku 166 persona ende jetojnë në kushte çnjerëzore në qendrat kolektive.¹⁰² Statusi i PZh-së u ofron atyre më pak mundësi strehimi, pasi nuk u takojnë të gjitha të drejtat që u jepen refugjatëve. Situata është gjithashtu e keqe për një numër të konsiderueshëm refugjatësh nga Kroacia dhe BeH. Megjithëse Programi Rajonal i Strehimit ka ndihmuar që shumë refugjatë të kenë një shtëpi të re, ende ekzistojnë rreth 10,800 familje që kërkojnë mbështetje.¹⁰³

Të qenit në një pozitë të vështirë socio-ekonomike e pengon edhe realizimin e disa të drejtave. Për shembull, ata që duan të shpallin të vdekur një person të zhdukur për të trashëguar dhe pronën ose për të marrë pension, duhet të paguajnë një njoftim në një gazetë zyrtare ose të punësojnë një avokat. Viktimat mbështeten kryesisht tek OJQ-të dhe avokatët që ofrojnë mbështetje ligjore falas, por të cilët janë të paktë në numër dhe shpesh viktimat nuk janë të vetëdijshme që një mbështetje e tillë ekziston. Familjet e njerëzve që u vranë ose u zhdukën pas 20 qershorit 1999 gjenden në një situatë veçanërisht të vështirë, sepse ata nuk kanë të drejtë për reparacione as në Kosovë e as në Serbi (shih gjithashtu kapitullin për Kosovën).

98 Pokret za preokret predstavio zakon o oduzimanju imovine SPS-u koja je ranije pripadala SKS i SSRNS, Prill 2021, n Leši dispozicion (në serbisht) [këtu](#).

99 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

100 "Za novine poslanika SNS-a milioni dinara iz budžeta" (Deputeti i Asamblesë Kombëtare të Partisë Progresive Serbe merr miliona dinarë nga buxheti i shtetit për botimin e buletinit), 20 maj 2020, në dispozicion (në serbisht) [këtu](#).

101 Nevojat e renditura këtu reduktohen në mënyrë të pashmangshme në çështje kyçe dhe në asnjë mënyrë nuk pretendohet të jenë një analizë gjithëpërfshirëse dhe e detajuar.

102 Të dhënat e Komisarariatit për Refugjatët dhe Migrimet, në dispozicion [këtu](#).

103 Miodrag Linta, 18 maj 2021, seanca e 12-të e seancës së parë të rregullt të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë në vitin 2021.

Viktimat nga lufta në Kroaci përballen me kosto të larta të proceseve gjyqësore të humbura, duke e bërë situatën e tyre të vështirë ekonomike edhe më sfiduese.¹⁰⁴

Familjarët e personave të zhdukur nuk kanë të drejtë në kompensimin mujor që u jepet viktimave civile në gjendje të vështirë socio-ekonomike. Në këtë kompensim nuk kanë të drejtë as ata që konsiderohen viktimat të terrorit shtetëror në Sanxhak dhe Serbinë jugore, as familjet e viktimave të konfliktit të brendshëm 2000–2001.¹⁰⁵ Për shumë vite ata kanë kërkuar që t'u njihet statusi ligjërisht në mënyrë që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të përmirësojnë pozitën e tyre ekonomike.¹⁰⁶

Viktimat e terrorit shtetëror në Sanxhak kanë nevojë për rindërtim të shtëpive dhe infrastrukturës së tyre të shkatërruar nga forcat serbe të sigurisë.¹⁰⁷ Edhe pse të shpërngulur me forcë, atyre u mohohet mundësia e regjistrimit si PZh dhe në këtë mënyrë nuk mund t'i gëzojnë të drejtat që do t'u takonin si PZh.¹⁰⁸ Përveç kësaj, ata kryesisht nuk kanë mundur të marrin kompensim material për dëmet apo traumat e shkaktuara nga forcat serbe.¹⁰⁹ Disa viktimat raportojnë se duhet ta kthejnë një pjesë të kompensimit që kanë marrë për shkak se u është llogaritur gabimisht.¹¹⁰

Viktimat shqiptare që jetojnë në Serbinë jugore përballen me probleme specifike. Nuk ka pasur asnjë investim shtetëror në ekonominë e rajonit dhe investimet private janë zvogëluar. Infrastruktura është e dobët, objektet shëndetësore janë joadekuate dhe ka probleme të rënda në arsim, duke përfshirë, deri vonë, ndalimin e importit të teksteve në gjuhën shqipe. Studentët e universitetit shqipfolës gjithashtu e kanë të vështirë të studiojnë në gjuhën serbe dhe kualifikimet që i fitojnë në Kosovë nuk njihen në Serbi, duke e bërë kështu të vështirë punësimin. Megjithatë, problemi më i theksuar është 'pasivizimi i vendbanimit', që do të thotë se shqiptarët për të cilët autoritetet besojnë se nuk jetojnë në adresat e tyre nuk mund të pajisen me letërnjoftim ose librezë mjekësore, gjë që paraqet kërcënim serioz që të pastrohet etnikisht ky rajon, e veçanërisht komuna e Medvegjës.¹¹¹

Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur – përsheptimi i kërkimit,¹¹² proceset e zhvarrimit dhe identifikimit,¹¹³ vërtetimi dhe publikimi i së vërtetës për atë që ka ndodhur me viktimat.¹¹⁴ Familjet e personave të zhdukur nga Kroacia dëshirojnë të përfshihen në proceset e udhëhequra nga institucionet kroate. Ata ndihen të painformuar dhe të nënperfaqësuar në tërë këtë proces.¹¹⁵

104Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

105Ligji për të drejtat e veteranëve, invalidëve ushtarakë, invalidëve civilë të luftës dhe familjarëve të tyre, Gazeta Zyrtare 18/2020.

106Duško Čelić, 2020. Në pritje të Ligjit për Personat e Zhdukur, buletini "Loti", Nr.56, fq. 13-15, në dispozicion në serbisht [këtu](#)

107Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin. Ćutnja o proterivanju Bošnjaka iz Priboja (Heshtja mbulon dëbimin e boshnjakëve nga Priboj), 15 shkurt 2018, Radio Evropa e Lirë, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

108Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

109Mihailo Pavlović, 2018. Anashkalimi i Drejtësisë: Statuti i Parashkrimit si Mekanizëm për Mohimin e të Drejtës për Kompensim të Viktimave të Luftës, FDH.

110Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

111Serbia po shpupullon shqiptarët në Luginën e Preshevës në nivele alarmante, Flora Ferati-Sachsenmaier, maj 2020, në dispozicion [këtu](#). Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkë bisedë me autorin.

112"Ai kishte ikur": Video Kujtimet e Luftërave Ballkanike", Persona të Zhdukur, 31 gusht 2020, BIRN, në dispozicion [këtu](#)

113Nestali ne smeju ostati broj (Personat e zhdukur nuk duhet të jenë vetëm numra), 28 gusht 2020, gazeta e përditshme Danas, në dispozicion në serbisht [këtu](#). A do të hapin Serbia dhe Kosova arkivat sekrete të luftës?, 14 gusht 2020, BIRN, në dispozicion [këtu](#). 'Ai kishte ikur': Video Kujtimet e Personave të Zhdukur të Luftërave Ballkanike, 31 gusht 2020, BIRN, në dispozicion [këtu](#).

114Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

115Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

Mbështetje administrative dhe ligjore – Grupet e viktimave shpesh nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për t'i drejtuar proceset e tyre përkatëse. Një shembull i tillë është procedura ligjore për shpalljen e një personi të zhdukur për të kërkuar përfitime ligjore, gjatë së cilës pos që paraqiten kërkesa financiare dhe administrative, por është edhe traumatike. Gjithashtu, viktimave u mungojnë kapacitetet për të aplikuar për pjesëmarrje në procedurat gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës.¹¹⁶ Viktimat gjithashtu kanë nevojë për mbështetje ligjore për të ngritur padi për kompensimin e dëmit, si dhe për të fituar statusin e viktimave civile të luftës.

Mbështetja psikologjike – Viktimat që vuajnë nga trauma të shkaktuara nga lufta, krimet e luftës, zhvendosja, humbja e një anëtar të familjes, shkatërrimi i pronës dhe abuzime të tjera të të drejtave të njeriut në lidhje me luftën, kanë nevojë për programe të veçanta terapie. Aktualisht, viktimat detyrohen të kërkojnë mbështetje psikologjike nëpërmjet shërbimeve të rregullta shëndetësore, e cila përfshin disa hapa të vështirë: njohjen dhe pranimin e problemit, vizitën te mjeku i përgjithshëm dhe referimin te një specialist. Kështu, viktimat shpesh lihen të kujdesen për veten e tyre.¹¹⁷ Trauma e pazgjidhur për dy dekada ka çuar edhe në një sulm fatale në zemër.¹¹⁸

Viktimat që dëshmojnë në gjykatë kanë nevojë specifike për mbështetje emocionale dhe psikologjike.¹¹⁹

Njohja – të gjitha viktimat dëshirojnë njohjen socio-politike në formën e deklaratave, monumenteve, memorialeve dhe formave të tjera të pranimit¹²⁰ nga shteti serb, nga shtetet dhe komunitetet e përfshira në konflikte dhe nga bashkësia ndërkombëtare. Viktimat e terrorit shtetëror në Sanxhak dhe rrëmbimet në Shtërci dhe Sjeverin ende presin që institucionet serbe të pranojnë përgjegjësinë dhe t'i njohin si viktima.¹²¹ Grupet e viktimave të serbëve nga Kroacia duan të mos shihen si agresorë nga homologët e tyre në Kroaci.¹²² Grupet e joshqiptarëve nga Kosova do të donin të njiheshin si viktima nga shteti dhe shoqëria kosovare dhe nga bashkësia ndërkombëtare.¹²³ Një dëshirë tjetër e shpeshtë e viktimave është që dikush nga pala tjetër e vijës historike të konfliktit të avokojë për të drejtat dhe njohjen e tyre. Për shembull, viktimat serbe nga Kroacia ose Kosova do të dëshironin të kenë dikë në Kroaci ose Kosovë që të avokojë për drejtësinë dhe të vërtetën.¹²⁴

Të gjitha grupet duan që historia e tyre të dëgjohet; kjo nevojë ishte e pranishme gjithkund gjatë hulumtimit në terren. Disa të intervistuar thanë se kanë vërejtur se familjet e personave të zhdukur tani janë më të gatshëm për të folur.¹²⁵

Kujtimi nga shoqëria – të gjitha grupet e viktimave shprehin nevojën për të mbajtur të gjallë kujtimin e

116Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

117Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

118Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

119Serbisë i kërkohet të mbrojë viktimat dhe dëshmitarët e krimeve të luftës, 6 dhjetor 2019, BIRN, në dispozicion [këtu](#).

120 Faqja e internetit e Shoqatës së Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi, në dispozicion në serbisht [këtu](#). [Kajeviq etj.](#)

[Transkriptet nga rasti i Shtërcit. Viktima e zhvendosjes së detyruar nga Kroacia, Qendra Qytetare e Vojvodinës, në dispozicion në serbishtkëtu](#).Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

121Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin. Çutnja o proterivanju Bošnjaka iz Priboja, 15 shkurt 2018, Radio Evropa e Lirë, në [dispozicion në serbisht këtu](#).

122Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

123Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

124Maja Stojanoviq, Iniciativat Qytetare, 7 Prill 2021.

125 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin.

viktimize dhe të asaj që ndodhi në luftë. Ata vetë përpilojnë listat e viktimize,¹²⁶ organizojnë përkujtime¹²⁷ dhe ndërtojnë përmendore.¹²⁸

Ndjekja penale e autorëve të krimit – të gjitha grupet që e perceptojnë veten si viktime këmbëngulin për t'i sjellë përgjegjësit para drejtësisë.¹²⁹ Ata presin ndjekje penale nga gjykatat në Serbi, Kroaci dhe Kosovë, duke përfshirë Dhomat e Specializuara të Kosovës. Në lidhje me këtë të fundit, disa viktime duan të përfshihen në proces, ndërsa të tjerët nuk janë në dijeni të kësaj mundësie.¹³⁰

Gratë viktime të luftës janë anashkaluar krejtësisht dhe nuk marrin asnjë mbështetje apo njohje si viktime,¹³¹ veçanërisht viktimit e dhunës seksuale dhe gratë refugjate/PZh. As grupet e viktimize nuk i kanë trajtuar çështjet e veçanta me të cilat përballen gratë.

Viktimit civile të luftës ndjehen të diskriminuar në krahasim me ish-luftëtarët.¹³² Disa viktime ndihen gjithashtu të shpëtuara nga proceset dhe iniciativat zyrtare me potencial për t'u ofruar atyre një formë kompensimi.¹³³

Përfaqësuesit e grupeve të viktimize jo-serbe përmendin atmosferën në rritje të frikësimit dhe ndarjes ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Serbi¹³⁴ dhe shprehin nevojën urgjente për reforma institucionale që garantojnë mospërsëritje pasi disa po përjetojnë kërcënime dhe frikësim.¹³⁵

Arsyeja e përgjithshme për privimin e viktimize nga mundësitë për përmblyllje domethënëse të rasteve qëndron në mosgatishmërinë socio-politike për të shqyrtuar objektivisht rolin e Serbisë në luftërat e viteve 1990. Një tendencë e tillë mund të vërehet në shumë procese, duke përfshirë ato në vijim.

Asnjë **program sistematik i dëmshpërblimit** nuk është diskutuar apo krijuar ndonjëherë. Në përgjithësi, viktimit nuk marrin mbështetje financiare nga shteti. Siç u tha më herët, ligji që ofron një formë të dëmshpërblimit përjashton disa kategori viktimize, duke përfshirë familjet e personave të zhdukur, viktimit me lëndime fizike që prekin më pak se 50 për qind të trupit të tyre, viktimit me çrregullime të stresit post-traumatik dhe forma

126 Shoqata e Familjeve të Personave të Vrarë dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi, Faqja e internetit, në dispozicion [këtu](#). Përfaqësuesit e grupeve të viktimize në bisedë me autorin.

127 Obeležavanje dana masovnog kidnapovanja Srba i ostalih na beogradskom groblju Orlovača iu Velikoj Hoči (Shënimi i ditës së kidnapimit masiv të serbëve dhe komuniteteve të tjera), 18 korrik 2021, në dispozicion [këtu](#).

128 Spomen soba Udruženja "Suza" - "Nezaborav za žrtve devedesih", 13 maj 2021, në dispozicion [këtu](#).

129 Nail Kajeviq, Selma Çoloviq, Ragip Liçina, Alija Kapetanoviq, Etem softić, Misin Rastoder, Edin Bakija, Islam Sinançeviq. pjesët e dëmtuara në rastin Shtërpçi, Transkriptet e audio-incizimit nga seancat gjyqësore të mbajtura nga 3 prilli deri më 13 maj 2019; në dispozicion në serbisht [këtu](#)

130 Përfaqësuesit e grupeve të viktimize në bisedë me autorin

131 Përfaqësuesit e grupeve të viktimize në bisedë me autorin.

132 U Beogradu održana rasprava o nacrtu zakona o pravima boraca, vojnih invalida (Dëgjimi publik për Projektligjin për të Drejtat e Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës mbajtur në Beograd), 6 qershor 2019, Aleanca e Serbëve nga Rajoni, në dispozicion në serbisht [këtu](#). Žrtve balkanske krčme (Viktimit e tregtisë ballkanike), 22 nëntor 2019, Deutsche Welle, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

133 Udruženja: Povuci nacrt zakona o pravima boraca (Shoqatat: Tërhiqni Projektligjin për të Drejtat e Veteranëve), Radio Televizioni i Serbisë, 30 dhjetor 2014, në dispozicion në serbisht [këtu](#). Projektligji për të drejtat e veteranëve të luftës dhe të aftësisë së kufizuar ruan dispozitat që diskriminojnë viktimit civile të luftës, Komunikatë për shtyp, 9 janar 2019, FDH, në dispozicion [këtu](#).

134 Përfaqësuesit e grupeve të viktimize në bisedë me autorin

135 Po aty; Žrtve kao barazno punjenje za nove ratove, 28 dhjetor 2020, Portali Autonomija, në dispozicion në serbisht [këtu](#); Policët serbë hetohen mbi këngën pro-gjenocidit, 5 janar 2022, Balkan Insight, në dispozicion [këtu](#).

të tjera të luftës, viktimat të dhunës seksuale dhe viktimat që kanë vuajtur nga forcat serbe të sigurisë.¹³⁶ Përveç kësaj, viktimat duhet të jenë në gjendje të vështirë ekonomike, që do të thotë se kjo mbështetje reduktohet në një përfitim të mirëqenies sociale. E vetmja iniciativë për dëmshpërblim që parasheh rindërtimin e komuniteteve të shkatërruara në zonën e Sanxhakut – Programi për Kthimin e Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur nga Komuna e Pribojit – gjithashtu nuk u përfundua kurrë.¹³⁷ Viktimave që nuk kanë të drejtën e mbështetjes shtetërore me asnjërin nga masat ligjore ekzistuese u duhet ta kërkojnë kompensimin e dëmit material përmes padive. Megjithatë, këto procese rrallë ofrojnë ndonjë zgjidhje për viktimat. Procedurat gjyqësore janë të gjata, me shumë kërkesa të refuzuara ose, nëse pranohen, ofrojnë kompensim joadekuat.¹³⁸

Megjithëse ekziston një mundësi për të paraqitur një kërkesë dëmshpërblimi përmes procedurave penale, gjykatat po i nxisin viktimat të ngrënë padi private kundër atyre që janë përgjegjës për krimet e luftës. Viktimat që vendosin të paraqesin padi private kanë nevojë për asistencë ligjore për t'i ndihmuar ata të kalojnë në procedura që shpesh janë komplekse. Ata që janë me kushte të vështira financiare kanë nevojë për ndihmë juridike falas, e cila mund të ofrohet vetëm në kushte të caktuara. Me opsione të tilla konfuzë dhe kufizuese, viktimat mbeten edhe të pasigurta dhe ngurrojnë për të nisur ndonjë kërkesëpadi. Viktimat e DHSBGJ-së kanë mëdyshje për të paraqitur një kërkesë kompensimi pasi kjo do t'i privonte nga mbrojtja që kishin gjatë procedurave penale.

Personat e zhvendosur nga Kosova të cilët kanë punuar në ndërmarrjet shtetërore apo institucionet publike në Kosovë janë ende zyrtarisht të punësuar por, në vend që të paguhen me pagë të plotë, ata marrin vetëm një kompensim mujor shumë modest. Pamundësia e tyre për të menaxhuar me pronën në Kosovë është një tjetër pengesë për përmirësimin e gjendjes së tyre socio-ekonomike.¹³⁹ Në vitet e fundit, Zyra për Kosovën ka përfaqësuar viktimat në kërkesat pronësore para gjykatave në Kosovë, por kjo mbështetje ka ardhur shumë vonë pasi shumë familje tashmë kanë kaluar nëpër një periudhë shumë të vështirë apo edhe kanë vdekur. Për më tepër, personat e zhvendosur nga Kosova nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në Programin Rajonal të Banimit, për shkak të hezitimit të Serbisë për t'i integruar ata. Konkretisht, Serbia e konsideron pozitën e tyre të zhvendosur si të përkohshme dhe po inkurajon kthimin e tyre në Kosovë.¹⁴⁰

Viktimat e krimeve të kryera pas 20 qershorit 1999 nuk njihen si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia. Kosova beson se lufta kishte përfunduar deri në atë kohë dhe njeh vetëm ato familje që kanë vuajtur para asaj date. Serbia beson se pas kësaj date nuk kishte asnjë detyrim për t'i mbrojtur qytetarët e saj, pasi forcat e saj ushtarake dhe policore, si dhe administrata ishin tërhequr nga Kosova.¹⁴¹

Disa familje të viktimave (serbe) nga Kosova kanë marrë ndihmë financiare nga shteti¹⁴² por, siç e përshkroi një i intervistuar, përmes një procesi selektiv dhe jotransparent, që mund të nënkuptojë politizimin apo korruptimin e individëve në institucionet shtetërore.

136 Ligji për të drejtat e veteranëve, invalidëve ushtarakë, invalidëve civilë të luftës dhe familjarëve të tyre, Gazeta Zyrtare 18/2020.

137 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin

138 Pavloviq, 2018.

139 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin

140 Strategjia Kombëtare për Zgjidhjen e Çështjeve të Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur Brenda periudhës 2015-2020, Qeveria e Republikës së Serbisë.

141 Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin. Suoçavanje s prošlošću i pomirenje na Kosovu – Pregled institucija i inicijativa, 2017,

UNDP. Gëzim Visoka dhe Besart Lumi, 2020. Demokratizimi i Drejtësisë Tranzicionale - Drejt një Infrastruktura të Diskutimit për Ballafaqimin me të Kaluarën në Kosovë, Pax, Integra dhe Nisma e Re Sociale.

142 Përfaqësuesit e viktimave në bashkëbisedë me autorin.

Vetëm në vitin 2021 ka nisur procesi i përgatitjes së ligjit për personat e pagjetur. Pa rregullim ligjor të statusit të tyre, familjeve u kërkohet të deklarojnë të vdekur anëtarin e familjes së tyre të zhdukur për t'i gëzuar disa të drejta socio-ekonomike.

Nuk ka pasur asnjë nismë mbarëkombëtare për t'i inkurajuar viktimat që të kërkojnë mbështetje psikologjike. Programet e ofruara nga akterët e shoqërisë civile janë sporadike ose janë mbyllur.¹⁴³ Për më tepër, traumat e lidhura me luftën nuk njihen në një kontekst më të gjerë shoqëror dhe ekziston një lloj tabuje në lidhje me kërkimin e ndihmës psikologjike.

Gjyqet e krimeve të luftës po shuhen dalëngadalë, pavarësisht kuadrit të krijuar institucional dhe ligjor dhe kërkesave të vendosura nga BE-ja brenda kornizës së anëtarësimit. Bashkëpunimi rajonal i pamjaftueshëm në ndjekjen penale të krimeve të luftës, veçanërisht mungesa e bashkëpunimit me institucionet prokuroriale të Kosovës, i pengon disa viktima që jetojnë në Serbi të arrijnë drejtësinë që u takon.

Viktimave u mungojnë kapacitetet për të aplikuar për pjesëmarrje në procedurat gjyqësore të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë. Shoqatat e viktimave serbe të Kosovës ofrojnë njëfarë mbështetjeje, por shpesh atyre u mungon kapaciteti i mjaftueshëm, duke i bërë ato të paafte për të kontaktuar të gjithë individët potencialë të interesuar.

Gjestet simbolike, të tilla si deklaratat publike dhe monumentet i shërbejnë qëllimit të ruajtjes së narrativës serbe të viktimizimit në vend që të mundësohet pranimi i sinqertë i të kaluarës. KOMRA, si iniciativa më e spikatur që ka për qëllim të mundësojë dhe përkrahë vërtetimin e fakteve për luftërat, është shpërfillur nga shteti.

Asnjë **reformë institucionale** nuk është inicuar, ndërkohë që ligji i vetëm ekzistues për llogaridhënie skadoi pa u zbatuar kurrë. Së fundi, arkivat e forcave të sigurisë mbeten të mbyllura, pavarësisht se e kanë potencialin më të madh për të gjurmuar numrin e madh të personave të zhdukur, si dhe për të mundësuar procedurat e verifikimit.

Viktimat mbeten peng i interesave politike.¹⁴⁴ Shembulli më i qartë është ndoshta politika serbe ndaj Kosovës, e cila prek viktimat në mënyra të ndryshme. Siç është përmendur tashmë, bashkëpunimi dypalësh në ndjekjen penale të krimeve të luftës praktikisht nuk ekziston. Po kështu, kërkimi i personave të zhdukur varet, ndër të tjera, nga gatishmëria serbe për të konsoliduar listat me organizatën homologe në Kosovë. Nga ana tjetër, pozita e viktimave shqiptare në Serbinë jugore ndikohet, ndër të tjera, nga pritshmëria e Serbisë që marrëdhëniet me Kosovën të zgjidhen me ndarje të territoreve apo ricaktim të kufijve. Krejt në fund, shoqatat e viktimave të serbëve nga Kosova janë të lidhura dhe të ndikuar nga politikanët, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të avokuar për atë që duan.

Vetëm shoqëria civile ka bërë përpjekje të konsiderueshme në plotësimin e nevojave të viktimave për drejtësi, të vërtetën dhe njohjen e tyre. Megjithatë, shoqëria civile nuk ka qenë gjithmonë e suksesshme në arritjen e të gjitha grupeve të viktimave, veçanërisht atyre që përfaqësojnë serbët nga Kroacia, BeH dhe Kosova. Gjithmonë ka pasur një barrierë të caktuar që pengon komunikimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet grupeve të viktimave dhe akterëve të shoqërisë civile.

¹⁴³ Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

¹⁴⁴ Matthew Holliday, Drejtues i Programit të Ballkanit Perëndimor, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, në bashkëbisedë me autorin.

NEVOJAT E VIKTIMAVE PËR KAPACITETE ORGANIZATIVE

Grupet e viktimave udhëhiqen nga njerëz që janë vetë viktimat dhe që nuk kanë pasur përgatitje për të udhëhequr një organizatë, për të menaxhuar projekte ose për të hartuar dhe zbatuar fushata avokuese, etj.¹⁴⁵ Shumica nuk kanë plan të regjistruen zyrtarisht për të vazhduar punën si shoqatë e viktimave. Në fakt, për një sërë arsyesh, shumica nuk parashikojnë ndonjë të ardhme për grupin e tyre, p.sh. për shkak të rezultateve zhgënjyese në arritjen e drejtësisë, shumica e anëtarëve aktivë kanë vdekur, ose për shkak të mungesës së mbështetjes nga pjesa tjetër e shoqërisë. Sidoqoftë, ndonjë lloj programi për ngritjen e kapaciteteve duhet t'u ofrohet atyre grupeve.

Disa shoqata kanë kapacitetin për të përgatitur propozime për financim dhe për të zbatuar projekte në shkallë të vogël. Të tjerët mbështeten në financimin vjetor shtetëror, i cili shpesh është i pamjaftueshëm për punën e duhur, por u siguron atyre kontroll politik. Prandaj, eksplorimi i mundësive për mbledhjen e fondeve mund të pranohet gjerësisht. Sfidë mbetet raportimi për realizimin e projekteve. Nevojitet ngritja e kapaciteteve në avokim, lobim dhe zhvillim të fushatave.

Ngritja e ndërgjegjësimit për aspektet gjinore të vuajtjes dhe nevojat specifike të grave është gjithashtu një gjë e nevojshme. Duket se grupet e udhëhequra nga gratë po bëhen më të hapura për të folur dhe diskutuar për qasjet e mundshme. Grupet e udhëhequra nga gratë nuk kanë qenë domosdo të shqetësuara për gjininë dhe patriarkalizmin. Prandaj, ngritja e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore do të ishte pikënisje për to.

Krijimi i partneriteteve, si me grupet e tjera të viktimave ashtu edhe me OJQ-të, do të ndihmonte në zgjerimin e fokusit të tyre në aspektin gjinor, forcimin e pozicionit të tyre avokues dhe rritjen e aftësive të menaxhimit të projektit. Grupet e viktimave mund të lidhen gjithashtu me grupe të tjera viktimash në mbarë botën, për të shkëmbyer përvoja dhe për të ndërtuar koalicione.

Duke pasur parasysh ndërrimin e brezave dhe lodhjen e viktimave për shkak të kërkimit të drejtësisë për më shumë se 20 vite, mund të jetë e dobishme që brezat e rinj të marrin përsipër disa aspekte të punës së tyre.

1.3 Nismat zyrtare për të trajtuar të kaluarën e dhunshme të Serbisë

Të vetmet iniciativa zyrtare ekzistuese me potencial për të adresuar trashëgiminë e luftërave të viteve 1990 në Serbi janë gjyqet e krimeve të luftës, kërkimi i personave të zhdukur dhe riintegrimi i refugjatëve. Megjithatë, progresi në rastet e krimeve të luftës në familje ka qenë i ngadalshëm. Në raportin e vet për 2020–2021 për Serbinë, Amnesty International thekson: *“Asnjë përparim nuk është bërë drejt zbatimit të strategjisë kombëtare të krimeve të luftës, hapjes së hetimeve për grumbullimin e më shumë se 2,500 rasteve të krimeve të luftës, apo akuzimit të zyrtarëve të lartë policorë apo ushtarakë për përgjegjësi komanduese. [...] Ndjekjet penale të autorëve të nivelit të ulët në rastet e transferuara nga Bosnja dhe Hercegovina ishin jashtëzakonisht të ngadalshme. Procedurat kundër 10 burrave në lidhje me gjenocidin e Srebrenicës vazhduan të vonohen për shkak të mungesës së të akuzuarve.*¹⁴⁶ Kërkimet për personat e zhdukur po avancojnë ngadalë, për shkak të pasivitetit të institucioneve përkatëse. Një numër i konsiderueshëm refugjatësh nga Kroacia dhe BeH jetojnë ende në Serbi, disa në kushte joadekuate banimi.

Presidenti i Serbisë mbështeti Iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal për Kërkim të së Vërtetës dhe Fakteve për Krimet e Luftës (KOMRA), por nuk u morën masa konkrete për promovimin e kësaj ideje

¹⁴⁵Po aty.

¹⁴⁶Amnesty International, 'Raporti i Amnesty International 2020/21: Gjendja e të Drejtave të Njeriut në Botë', f. 315. Raporti i plotë [këtu](#)

në nivel rajonal apo vendor. Ligji për Llogaridhënien është miratuar në vitin 2003, por gjatë 10 viteve të ekzistencës së tij nuk është zbatuar asnjëherë. Në vitin 2012, Qeveria e Serbisë miratoi “Programin për kthimin e refugjatëve dhe boshnjakëve të zhvendosur nga komuna e Pribojit në periudhën 1991–1999”, i cili synonte të lehtësonte kthimin e boshnjakëve të dëbuar nga shtëpitë e tyre në komunën e Pribojit gjatë luftës në BeH. U prezantuan një sërë masash, të tilla si rindërtimi i ndërtesave dhe infrastrukturës, subvencionet dhe stimulimet bujqësore, dhe zhvillimi i komunitetit lokal, për të mundësuar kthimin e qëndrueshëm të qytetarëve boshnjakë që u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Megjithatë, ligji nuk u zbatua si kompensim, por më tepër si një program rindërtimi.¹⁴⁷

Për vite me radhë, grupet e viktimave kanë avokuar për një ligj të specializuar që do të rregullonte pozitën ligjore dhe socio-ekonomike të familjeve të personave të zhdukur. Në vitin 2019, Koordinimi i Shoqatave Serbe të Familjeve të të Zhdukurve dhe Personave të Vrarë nga ish-Jugosllavia mori mbështetje deklarative për këtë iniciativë nga Presidenti Vuçiq. Koordinimi shkoi më tej, duke zhvilluar një ligj model për personat e zhdukur dhe mori garanci nga autoritetet përkatëse se do të kalonte në procesin e miratimit në vjeshtën e vitit 2021.¹⁴⁸ Megjithatë, ai nuk është përfshirë në planin vjetor të punës së Qeverisë për vitin 2022 dhe as nuk është miratuar.¹⁴⁹

Vitet e fundit ka pasur një rritje të eventeve zyrtare përkujtimore për t’i përkujtuar luftërat e viteve 1990, por ato janë etnocentrike dhe nuk ka angazhim të sigurt për të përmirësuar pozitën e viktimave. Dy ngjarje përkujtimore – njëra që shënon krimet gjatë dhe pas operacionit ushtarako-politor kroat “Stuhia” e gushtit 1995 dhe tjetra fillimi i ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në mars 1999 – spikasin si ngjarjet kryesore të politikave zyrtare përkujtimore të Serbisë. Të dyja këto ngjarje përkujtimore njohin vetëm viktimat serbe, duke mos e vendosur ngjarjen në një kontekst më të gjerë dhe duke mos përmendur viktima nga grupe të tjera etnike. Edhe ngjarjet e tjera përkujtimore zyrtare të shkallës më të vogël e ndjekin këtë model. Që nga viti 2015, dy përvjetorët janë kthyer në një projekt shtetëror, me burime të konsiderueshme financiare dhe kohë të investuar në përgatitjen dhe promovimin e tyre. Mbështetja e qeverisjes lokale për ngjarjet përkujtimore me bazë lokale të viktimave jo-serbe dhe të varrëve të trenit në Shtërpçi ndodh në ngjarje të rralla.

Në vitin 2020, ligji i ri për të drejtat e veteranëve të luftës, invalidëve të luftës, invalidëve civilë të luftës dhe anëtarëve të familjeve të tyre zëvendësoi ligjin e vitit 1996 që rregullonte përfitimet socio-ekonomike të invalidëve civilë të luftës. Megjithatë, të dy ligjet nuk i njohin të gjitha viktimat civile të luftës dhe në vend të kësaj diskriminojnë kategori të caktuara viktimash.

Korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të grave është kryesisht e plotë, por mungon zbatimi i legjislacionit. Mungesa e njohurive të specializuara në mesin e gjyqtarëve, policisë dhe punonjësve socialë, financimi i pamjaftueshëm, politizimi dhe mungesa e sinergjisë ndërmjet institucioneve përkatëse, si dhe me ofruesit e shërbimeve me përvojë nga shoqëria civile, luan një rol të rëndësishëm.¹⁵⁰ Gratë e ekspozuara

147Programi për kthimin e refugjatëve dhe boshnjakëve të zhvendosur nga komuna e Pribojit në periudhën 1991-1999, Qeveria e Republikës së Serbisë, 2012.

148Zakon o prinudno nestalim licima prvi put u pravnom poretku Srbije (Ligji për Personat e Zhdukur për herë të parë në Sistemin Ligjor Serb), 23 shkurt 2021, Danas, në dispozicion në serbish [të këtu](#).

149Plan rada Vlade za 2021. godinu (Plani Vjetor i Punës 2021), Shkurt 2021, Qeveria e Republikës së Serbisë.

150 Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) 2020. Raporti i Vlerësimit Bazë mbi masat legjislative dhe masat e tjera që zbatohen në dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Shtetit të Serbisë, Janar 2020, Këshilli i Evropës. Raporti CEDAW (shih fusnotën 160).

ndaj diskriminimit ndërsektorial shpërfillen nga autoritetet përkatëse.¹⁵¹ Vetëm viktimat e dhunës në familje kanë automatikisht qasje në ndihmë juridike falas. Viktimat e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore të përfshira nga Konventa e Stambollit duhet të kalojnë nëpër një proces të gjatë aplikimi dhe të ofrojnë dokumentet përkatëse.¹⁵²

Dhuna seksuale¹⁵³ është vepër penale, por ekzistojnë disa mangësi ligjore. Për shembull, sipas ligjit, sulmi seksual përkufizohet si përdhunim vetëm nëse është përdorur forca, pavarësisht nga Konventa e Stambollit, të cilën Serbia e ka ratifikuar, që përfshin idenë e pëlqimit të lirë.¹⁵⁴ Nuk ka asnjë ligj që njeh DHSBGJ-në në situatë lufte dhe kjo çështje ka marrë pak vëmendje nga institucionet e specializuara në ndjekjen penale të krimeve të luftës.¹⁵⁵ Ka pasur vetëm tre aktakuza për përdhunim.¹⁵⁶ Në maj të vitit 2021, në një aktgjykim të shkallës së parë, Gjykata e Lartë e Beogradit dënoi një ish oficer policie serbe të Bosnjës me nëntë vjet burg për përdhunimin e një gruaje boshnjake në gusht të vitit 1992.¹⁵⁷ Në shumicën e rasteve, përdhunimi është ndjekur penalisht krahas krimeve të tjera të luftës. Për më tepër, viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës janë të mbrojtura shumë pak gjatë procedurave penale, duke çuar shpesh në stigmatizim dhe ritraumatizim të tyre.¹⁵⁸

Edhe pse dhuna në familje është vepër penale sipas Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje, ajo zbatohet vetëm për disa lloje të marrëdhënieve.¹⁵⁹ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Grave nga Dhuna ka skaduar në vitin 2015 dhe nuk është hartuar ndonjë strategji e re lidhur me këtë.¹⁶⁰

Grave u mungojnë njohuritë për të drejtat e tyre, veçanërisht në zonat rurale, e sidomos gratë rome, ato të moshuara dhe migrante, si dhe gratë me aftësi të kufizuara.¹⁶¹ Për më tepër, ato nuk mbështeten gjithmonë nga të afërmit, për shkak të njohurive të tyre të kufizuara, besimeve personale ose frikës.¹⁶² Mungesa e interesit dhe veprimit të institucioneve për t'i mbrojtur gratë i pengon ato nga raportimi i abuzimit dhe mosekzistenca e mekanizmave vendorë të mbrojtjes i lë gratë pa asnjë lloj mbrojtjeje.¹⁶³ Klima sociale ndikon ndjeshëm në perspektivat e grave për drejtësi. Ekziston një tendencë e fortë për t'i rivendosur rolet tradicionale gjinore dhe diskursi antigjinor dominon në domenin publik.¹⁶⁴ Mbrojtja e të drejtave të grave është bërë më sfiduese gjatë pandemisë Covid-19, ku viktimat ishin më të ekspozuara

151Raporti GREVIO, 2020, vep cit.

152Raporti GREVIO, 2020, vep cit.

153Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje Stamboll, 11 maj 2011, nenet 36 dhe 40.

154Kodi Penal, Republika e Serbisë, Gazeta Zyrtare Nr. 35/2019.

155Žanić, 2019, vep cit.

156FDH, Dokument Politikash: Miratimi i kërkesave për kompensim për viktimat e dhunës seksuale në procedurat e krimeve të luftës para gjykatave serbe, qershor 2021: https://hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2021/06/Policy_Paper_-_ENG.pdf

157Stojanović, Milica, 'Serbia dënon ish-ushtarin serb të Bosnjës për përdhunim gjatë kohës së luftës', 13 maj 2021, BIRN <https://balkaninsight.com/2021/05/13/serbia-convicts-bosnian-serb-ish-ushtar-of-wartime-rape/>

158Po aty.

159Vëzhgimet përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik të Serbisë, 28 shkurt 2019, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Raport CEDAW).

160Tanja Ignjatovic, 2020, f. 5.

161Raporti i CEDAW.

162Reagujtë pre zločina, ne posle! (Reagoni para, jo pas krimin!), Njoftim për shtyp, 5 shkurt 2021, Qendra Autonome e Grave në Beograd, në dispozicion në serbisht [këtu](#).

163Raporti i CEDAW.

164Raportet e GREVIO dhe CEDAW.

ndaj dhunës dhe ishin më pak në gjendje të kërkonin mbështetje.¹⁶⁵

Disa OJQ mbështesin gratë dhe promovojnë barazinë gjinore, duke përfshirë edhe DHSBGJ-në gjatë luftës. Këtë e bëjnë duke avokuar për zgjidhje ligjore, duke raportuar për zbatimin e ligjeve, duke i bërë thirrje qeverisë që të përmbushë detyrimet e saj ndërkombëtare (p.sh. sipas Konventës së Stambollit dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave), duke rritur ndërgjegjësimin publik mbi çështjet gjinore, duke ofruar perspektiva feministe dhe duke ofruar mbështetje ligjore, psikologjike dhe mbështetje nga ekspertët për viktimat e krimeve me bazë gjinore. Ekziston një shkallë e konsiderueshme e ekspertizës dhe përvojës në shoqërinë civile, por kjo mbetet e paeksploruar nga institucionet.

Sa i përket nismave të viktimave, janë ngritur disa monumente, duke përfshirë monumentin për viktimat serbe të luftërave të viteve 1990 në parkun Tašmajdan, Beograd, i cili u ngrit nga Koordinimi i Shoqatave Serbe të Familjeve të të Zhdukurve në ish-Jugosllavi.¹⁶⁶ Koalicioni i Shoqatave të Refugjatëve në Serbi mori iniciativën për ndërtimin e një memoriali për viktimat serbe që vdiqën në luftërat e viteve 1991–2000, me mbështetje nga autoritetet lokale, por kjo deri më tani nuk ka ndodhur.¹⁶⁷ Në vitin 2009, familjet ngritën një memorial për njerëzit e rrëmbyer në Shtëpçin në qytetin e Prijepoljes,¹⁶⁸ dhe grupet e viktimave ngritën një memorial kushtuar viktimave të rrëmbimit në Sjeverin në 2015.¹⁶⁹ Në vitin 2019, me iniciativën e shoqatës “Kosmetski stradalnici” me seli në Beograd, në Osojanë të Kosovës u ngrit një memorial në përkujtim të serbëve të vrarë në komunën e Istogut, Kosovë.¹⁷⁰

Thirrja e familjarëve dhe të afërmëve për përfshirjen e personave të zhdukur nga lufta e Kosovës në dialogun Serbi-Kosovë të ndërmjetësuar nga BE-ja është pranuar.¹⁷¹ Megjithatë, vetë dialogu po zhvillohet me vonesa dhe me shumë vështirësi.

1.4 Diskursi publik për të kaluarën në Serbi

Sipas shtetit serb, luftërat në Kroaci dhe BeH ishin akt i mbrojtjes, të zhvilluara vetëm për të mbrojtur popullin serb në pjesë të ish-Jugosllavisë ku ata ishin të rrezikuar. Kur bëhet fjalë për Kosovën, diskursi kufizohet në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në vitin 1999. Përleshjet e armatosura në vitin 1998, por veçanërisht krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës, mbulohen në heshtje. Për të ndihmuar në promovimin e këtij këndvështrimi dhe gjithashtu për të vënë në dukje vazhdimësinë e vuajtjeve të Serbisë përgjatë shekullit të 20-të, kujtimi i kësaj periudhe lidhet gjithnjë e më shumë me Luftën e Dytë Botërore. Në të njëjtën kohë po nacionalizohet Lufta e Dytë Botërore: po fshihet jugosllavi, pra karakteri multi-etnik i rezistencës ndaj fashizmit për ta paraqitur atë ekskluzivisht si serb. Rishikime të tilla të njëkahshme të ngjarjeve historike imponojnë një kuptim të veçantë të rolit të Serbisë në luftëra, që më pas ndikon në përcaktimin e përgjegjësisë.

¹⁶⁵Reaguje pre zločina, ne posle! (Reagoni para, jo pas krimin!), Njoftim për shtyp, 5 shkurt 2021, Qendra Autonome e Grave Beograd.

¹⁶⁶Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bisedë me autorin. I njëjti park mban monumentin “Pse?”, i ngritur nga familjet e punonjësve të RTS-së të vrarë kur raketa e NATO-s goditi ndërtesën gjatë ndërhyrjes ushtarake të vitit 1999.

¹⁶⁷Krstić, 2016, vep cit.

¹⁶⁸Izveštaj o tranzicionoj pravdi u Srbiji, Crnoj Gori i na Kosovu 1999 – 2005 (Raport mbi drejtësinë tranzicionale në Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë në 1999-2005), 2006, FDH. Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

¹⁶⁹Krstić, 2016, vep cit.

¹⁷⁰ Përfaqësuesit e grupeve të viktimave në bashkëbisedë me autorin.

¹⁷¹A mund të presim përparim në dialogun Beograd-Prishtinë?, Shtator 2020, portali European Western Balkans.


Teoria se luftërat ishin akt i mbrojtjes bazohet dhe përforcohet nga dy elementë: viktima serbe dhe heroizmi i forcave serbe të sigurimit. Që nga viti 2014/15, i gjithë mekanizmi shtetëror është angazhuar në prodhimin e përmbajtjeve që promovojnë këtë narrativë, të mbështetur nga media dhe sistemi i arsimit formal. Procesi i reformimit të kujtesës publike të së kaluarës së afërt zhvillohet përmes ngjarjeve përkujtimore dhe rehabilitimit publik të kriminelëve të dënuar të luftës. Politika zyrtare e përkujtimit fokusohet në Operacionin Stuhia dhe fillimin e bombardimeve të NATO-s. Operacioni Stuhia është portretizuar si spastrimi etnik më i madh që nga Lufta e Dytë Botërore, ndërsa ndërhyrja ushtarake e NATO-s shihet si “agresion” për të mposhtur Serbinë dhe për të kapur territorin e saj. Megjithatë, ajo që është vërejtur në dy vitet e fundit është se ngjarjet në lidhje me luftën e Kosovës po marrin prioritet. Në këtë kuptim, publiku është i mbingarkuar me histori për vuajtjet e serbëve, të treguara shpesh jo nga viktimat, por nga ish-luftëtarët apo edhe kriminelët e dënuar të luftës. Këta të fundit promovohen në publik dhe janë figura kyçe në përkujtimet zyrtare. Ky diskurs i përjashton plotësisht vuajtjet e grupeve të tjera etnike, veçanërisht të shqiptarëve të Kosovës, pasi zërat e tyre do ta pengonin narrativën zyrtare. Duhet thënë se edhe zërat e viktimave serbe janë heshtur, pasi i gjithë rikrijimi i kujtesës kolektive është rrëmbyer nga politikanët dhe institucionet.

Diskursi është kryesisht ushtarak dhe mashkullor, duke zmadhuar fitoret ushtarake mbi viktimat civile dhe heroizmin e burrave mbi vuajtjet e grave. Edhe pse ka pasur njëfarë pranimi të përgjegjësisë së palës serbe për krimet e kryera, këto pranime nuk janë hulumtuar më tej nga institucionet e prokurorisë, mediat apo programet formale arsimore. Në të njëjtën kohë, provat në lidhje me sjellje të tilla kriminale fshihen sistematikisht nga institucionet. Në këtë diskurs publik mungojnë krejtësisht përvojat e grave të luftës.

Në përputhje me një diskurs kaq të politizuar, përjashtues dhe militarist, shteti mbetet i shurdhër ndaj shumicës së nevojave të viktimave. Përkundër kësaj, nevojat e të paditurve për krime lufte, të dënuarve apo veteranëve të luftës janë në qendër të vëmendjes.¹⁷² Këtë e dëshmon jo vetëm promovimi publik i kriminelëve të luftës që përmendëm më lart, por edhe ligji i sapomiratur, i cili u jep përparësi veteranëve të luftës ndaj viktimave civile të luftës, duke u ofruar atyre mbështetje dhe shërbime më të mëdha materiale.¹⁷³ Po kështu, Ligji i vitit 2004 mbi të Drejtat e të Paraburgosurve të TPNJ-së është ende në fuqi, duke ofruar kompensim financiar për personat e paditur dhe të dënuar për krime lufte dhe familjet e tyre.

172P.sh.: Vladimir Lazarevic, një kriminel lufte i dënuar nga TPNJ me 14 vjet burgim për krime kundër njerëzimit, u soll në shtëpi në një aeroplan të qeverisë së Serbisë kur u lirua nga burgu në 2014: <http://www.hlc-rdc.org/?p=30815&lang=de>. Më vonë u angazhua si pedagog në Akademinë Ushtarake të Serbisë: (<https://balkaninsight.com/2017/10/18/serbian-war-criminal-will-teach-at-military-academy-10-18-2017/>). Gjithashtu, Vojislav Sheshelj, i cili u dënua nga TPNJ me 11 vjet burg për nxitje të ndjekjes penale, dëbimit dhe akteve të tjera çnjerëzore si krime kundër njerëzimit, është mysafir i rregullt në emisionet televizive dhe deri vonë ishte deputet i Parlamentit: <https://b92.tv/video/fokus/fokus-b92-gost-dr-vojislav-seselj-1871532> https://www.youtube.com/watch?v=-_yVQ-Uvw1o <https://www.youtube.com/watch?v=565TgUgNVjk>

173Ligji për të drejtat e veteranëve, invalidëve ushtarakë, invalidëve civilë të luftës dhe familjarëve të tyre, Gazeta Zyrtare Nr. 18/2020.



Kjo fotografi iu kushtohet personave të rrëmbyer dhe të zhdukur nga lufta në Kosovë.

Foto nga: Borislav Pešić Blagoja, 2022.



SHTRPI

UP FAHRI MUMSHI
02.1988 - 22.05.1999

DRITON RIFAT MURSELI
15.07.1972 - 22.05.1999

ARSIM SHAJI MUSA
02.12.1979 - 22.05.1999

HAT FERAT TIRIQI
1977 - 22.05.1999

ZEQIR ZEQIRI
08.02.1947 - 22.05.1999

IGBALLE OSHLANI
14.07.1954 - 22.05.1999

AZIZ HALILI
15.12.1944 - 02.05.1999

BURIM LUTFI HOKHA
28.11.1979 - 22.04.1999

FEHMI i ISTREPI
20.06.1975 - 27.03.1999

FERIT JASHAR REXHEPI
04.07.1960 - 23.04.1999

ENVER M. RRUSTOLLI
01.09.1966 - 05.05.1999

REXHEP ILLI VERDOCI
1991 - 1999



PROVCI

IDRIZ BEGIR IDRIZI
1987 - 1999

EM-DAN JASHARI
1991 - 1999



Hasan Shkreli, duke treguar fotografinë e dy fëmijëve të tij, Bukuries (16) dhe Rrahimit (19) të cilët iu morën me forcë nga duart e tij dhe ai nuk i pa më. Foto nga: Atdhe Mulla, 2022

2. Kosova

2.1 Hyrje

Viktimit e luftës së Kosovës përbëjnë një numër të konsiderueshëm të popullsisë. Gati gjysma e popullsisë është prekur në një mënyrë apo tjetër nga konflikti i viteve 1998-1999 dhe masat adekuate për t'i plotësuar nevojat e tyre socio-ekonomike dhe shëndetësore ende nuk janë marrë nga institucionet e Kosovës, agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit dhe OSHC-të. Lufta e Kosovës filloi në fund të shkurtit të vitit 1998 me ofensivën e ushtrisë serbe/jugosllave në Kosovë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Nën Federatën Jugosllave (1942-1992), Kosova kishte qenë pjesë e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, në kuadër të republikës jugosllave të Serbisë. Slobodan Millosheviç, presidenti nacionalist i Republikës Socialiste të Serbisë, hoqi statusin autonom të Kosovës në vitin 1989 si pjesë e një plani më të madh për të bërë Kosovën pjesë të Serbisë. Pas kësaj, tensionet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës për shkak të diskriminimit strukturor ndaj popullsisë shqiptare u rritën edhe më shumë. Në atë periudhë, UÇK-ja u zhvillua nga një ushtri guerile e lirshme e grupuar në një lëvizje për rezistencë të armatosur. Pas ndërhyrjes së NATO-s në mars të vitit 1999, lufta e Kosovës përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës ndërmjet misionit paqeruajtës të udhëhequr nga NATO Forca e Kosovës (KFOR) dhe qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Republikës së Serbisë në qershor 1999.

Ndërmjet janarit 1998 dhe dhjetorit 2000, janë dokumentuar 13,548 vrasje, vdekje dhe zhdukje gjatë luftës në Kosovë.¹⁷⁴ Nga këta, 10,333 ishin civilë; 8692 shqiptarë, 1196 serbë, 151 romë, 86 boshnjakë, 77 ashkali, 55 malazezë, 37 egjiptianë, 11 goranë, 9 turq dhe 19 anëtarë të grupeve të tjera etnike.¹⁷⁵ Shumica u vranë ose u zhdukën në vitin 1999 (11,225 persona). Pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova nga 15 qershori 1999 deri në fund të dhjetorit 2000, 1257 persona të tjerë u vranë, u rrëmbyen ose u zhdukën: 717 serbë, 307 shqiptarë dhe 233 romë.¹⁷⁶ Shumica e njerëzve që dyshohet se janë rrëmbyer nga anëtarët e UÇK-së gjatë kësaj periudhe ishin ose serbë ose shqiptarë të Kosovës që konsideroheshin 'bashkëpunëtorë' me Serbinë.¹⁷⁷ Menjëherë pas luftës, 6064 persona u shpallën si të zhdukur.¹⁷⁸ Mbi 70% e këtyre rasteve janë zbardhur, por në mars 2022, 1620 persona ishin ende të

174FDH, '31,600 dokumente padyshim konfirmojnë vdekjen ose zhdukjen e 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë', 6 shkurt 2015, <http://www.hlc-rdc.org/?cat=281&lang=de>. Mund të qasen në bazën e të dhënave të FDH-së për humbjet në njerëz në lidhje me luftën në Kosovë ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 [këtu](#).

175Në këtë raport ne përdorim emërtimet 'shqiptarët' dhe 'serbët' për këto grupe etnike në Kosovë kur i referohemi periudhës para shkurtit 2008 kur Kosova u shpall e pavarur (që nuk njihet nga Serbia dhe disa vende të tjera); për periudhën pas pavarësisë përdoren 'kosova-shqiptarët' dhe 'serbët kosovarë'.

176FDH, 'Baza e të dhënave të Librit të Përkujtimit të Kosovës: Prezantimi dhe Vlerësimi', 4 shkurt 2015, në dispozicion [këtu](#). Shih gjithashtu, Human Rights Watch (HRW), 'Abuzimet kundër serbëve dhe romëve në Kosovën e Re', gusht 1999, vëllimi 11, nr. 10 (D), <https://www.hrw.org/reports/1999/kosov2>

177Amnesty International, 'Varrosja e së kaluarës: 10 vjet mosndëshkim për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë në Kosovë', 8 qershor 2009, <https://www.amnesty.org/fr/wp-content/uploads/2021/09/EUR700072009ENGLISH.pdf>

178 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) në Serbi & Iniciativa e Re Sociale (NSI), 'Efikasiteti i mekanizmave të institucioneve të Serbisë dhe Kosovës në gjetjen e personave të zhdukur nga lufta në Kosovë ndërmjet viteve 2016 dhe 2020', Mars 2021, në dispozicion [këtu](#)

zhdukur.¹⁷⁹ Ende po vazhdojnë zhvarrosjet në Serbi dhe Kosovë. Vetëm në vitin 2021, sipas Komisionit të Qeverisë së Kosovës për Persona të Zhdukur janë identifikuar 25 mbetje mortore.¹⁸⁰ Që nga marsi i vitit 2000, në hetimet për krimet e luftës, të inicuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) janë identifikuar 529 varreza masive me trupat e 4,300 viktimave, shumica dërrmuese në Kosovë.¹⁸¹ Deri në momentin kur testimi i ADN-së ishte në dispozicion në vitin 2002, u përdorën metoda tradicionale të identifikimit vizual.¹⁸² Këto përbëjnë shumicën e rasteve të sotme të dyshuara të keqidentifikimit. Për shumë familje që identifikuan të afërmit e tyre në atë periudhë, trazirat emocionale të zhvarrosjes së të dashurve për verifikimin e ADN-së janë shumë të vështira dhe shumë refuzojnë si zhvarrosjen ashtu edhe të japin mostrat e tyre të ADN-së.¹⁸³

Pas marrëveshjes së Kumanovës, Kosova u vu nën administrimin e OKB-së përmes Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), mandati i të cilit ishte të 'sigurojë kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor'. Që atëherë, janë ndërmarrë disa nisma për t'u marrë me trashëgiminë e luftës, duke përfshirë ndjekjen penale të krimeve të luftës, kërkimin e personave të zhdukur dhe dëshmitë dhe dokumentacionin nga shoqëria civile. Megjithatë, kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për t'i adresuar nevojat e ndryshme të viktimave dhe të mbijetuarve të luftës dhe as e kaluara nuk është trajtuar gjerësisht në aspektin social.¹⁸⁴

METODOLOGJIA

Në studim janë përdorur metoda të përziera të mbledhjes së të dhënave. Hulumtimi i dokumentacionit që i parapriu këtij studimi vlerësues përfshinte një rishikim të raporteve nga institucione të ndryshme akademike, OJQ dhe burime të tjera relevante. Kjo u pasua nga 20 intervista gjysmë të strukturuar me kryetarët dhe anëtarët e shoqatave të personave të zhdukur të shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera joshumicë, si dhe me viktimat civile të luftës, viktimat gra të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, dhe akterët vendorë e ndërkombëtarë që i trajtojnë dhe mbështesin rastet e të humburve dhe viktimave civile. Gjatë përzgjedhjes së të intervistuarve, jemi kujdesur që të sigurohet përfaqësim proporcional etnik, mbulim i barabartë gjeografik dhe të mbulohen nevojat specifike të grupeve të ndryshme të viktimave. Në përgjithësi, 14 të intervistuar ishin gra dhe 6 ishin burra, dhe 15 ishin përfaqësues ligjorë të shoqatave të njohura, nga të cilat tre ishin me shoqata të viktimave gra të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin dhe një ishte me një të mbijetuar të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin. Është intervistuar edhe një ish i burgosur politik, nënkryetar i shoqatës së të burgosurve politikë. Tre të intervistuar ishin kryetarë të shoqatave serbe në Graçanicë, Mitrovicë Veriore dhe Serbi. Një tjetër udhëheqëse e shoqatës së viktimave/grave ishte me prejardhje

179 Lista e përditësuar e personave të zhdukur në Kosovë e marrë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) më 11 mars 2022 (nuk ka ndarje sipas përkatësisë etnike).

180 Në dispozicion në Facebook postimi i kreut të Komisionit, Andin Hoti [këtu](#)

181 Cani, B., Shehu, B. & I. Petrovic, 'Dialogu: Të vrarët, të pagjeturit dhe të zhvendosurit' (Dialogue: The Killed, the Missing and the Displaced), Deutsche Welle, 23 korrik 2020 disponueshme <https://www.dw.com/sq/dialogu-t%C3%AB-vrart%C3%AB-t%C3%AB-pagjeturit-dhe-t%C3%AB-zhvendosurit/a-54270211>

182 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) në Serbi & Iniciativa e Re Sociale (NSI), 'Efikasiteti i mekanizmave të institucioneve të Serbisë dhe Kosovës në gjetjen e personave të zhdukur nga lufta në Kosovë ndërmjet viteve 2016 dhe 2020', Mars 2021, në dispozicion [këtu](#).

183 Fazliu, E.: 'Mbetjet e paidentifikuara dhe dhimbjet e vazhdueshme', Kosovë 2.0, 6 qershor 2018; <https://kosovotwopointzero.com/en/eshtrat-e-paidentifikuara-mbajne-dhimbjen-e-hapur/>

184 Visoka, Gezim & Lumi, Besart, 'Perspektivat qytetare për një strategji të ardhshme për drejtësinë tranzicionale për Kosovën', Integra, PAX, NSI, Dhjetor 2020, në dispozicion [këtu](#)

ashkali nga Fushë Kosova, dhe një tjetër ishte një grua boshnjake e Kosovës nga shoqata që bën bashkë të vejat e të gjitha përkatësive etnike nga Mitrovica e Veriut.

Nga 20 intervista, vetëm pesë janë kryer ballë për ballë për shkak të kufizimeve të pandemisë Covid-19. Të tjerat u kryen përmes platformave të tilla si Zoom, Google Meet, Facebook, Viber ose WhatsApp. Janë realizuar katër intervista me organizata që fokusohen në mbështetjen e punës me viktimë dhe shoqata të personave të pagjetur, si Ambasada Britanike në Kosovë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), UNMIK-u dhe Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Ky rast studimor shqyrton së pari situatën dhe nevojat e grupeve të ndryshme të viktimave. Më pas diskutohen nismat formale për t'u marrë me të kaluarën e dhunshme të Kosovës. Në fund, bëhet një diskutim i shkurtër mbi diskursin kombëtar rreth dhunës në të kaluarën dhe se si kjo ndikon në situatën e grupeve të ndryshme të viktimave në Kosovë. Dimensionin e dytë dhe i tretë përmbledhen në mënyrë përshkuese, duke rishikuar politikën, iniciativat dhe legjislacionin ekzistues dhe diskursin publik për trajtimin e së kaluarës. Dimensionin e parë, analiza e gjetjeve për statusin e shoqatave të të pagjeturve dhe grupeve të viktimave, shtjellon tërësisht nevojat e këtyre kategorive.

2.2 Situata dhe nevojat e viktimave të luftës në Kosovë

Lufta e viteve 1998–1999 dhe pasojat e saj i prekën praktikisht të gjithë banorët e Kosovës pasi ajo u përhap në të gjithë territorin e Kosovës. Disa zona, si Prizreni, Gjakova, Rahoveci, Shtërpca, Peja dhe Drenica, janë goditur veçanërisht rëndë. Përveç vdekjeve dhe zhdukjeve, civilët përjetuan forma të tjera të shkeljeve të të drejtave të njeriut që lidhen me luftën, si shpërngulja e detyruar, burgimi dhe abuzimi seksual. Shumë njerëz përjetuan abuzime të shumta. Shumica e informatorëve e identifikuan veten ose si të afërm të ngushtë të personave të zhdukur, të mbijetuar ose viktimë civile, por të burgosurit politikë nuk e identifikojnë veten si viktimë.

Një numër grupesh viktimash përfaqësohen nga OJQ dhe fondacione/shoqata. Sipas bazës së të dhënave të Ministrisë së Administratës Publike, që nga viti 1999, 169 organizata janë krijuar për të ofruar një lloj mbështetje për grupet e viktimave të luftës, krahas organizatave që merren me drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin në përgjithësi.¹⁸⁵ Rreth gjysma e këtyre organizatave (80) u formuan ndërmjet viteve 1999 dhe 2005, në pesë vitet e para pas luftës. Që atëherë, organizatat që përfaqësojnë ose mbështesin disa nga kategoritë e ndryshme të viktimave të luftës kanë vazhduar të regjistrohen edhe më tutje. Që pesë vite e gjysmë (nga viti 2016 deri më sot), janë regjistruar 25 organizata. Ky trend në rënie, por në vazhdimësi e sipër, tregon se grupet e viktimave ende ndjehen si të nënpërfaqësuar.

Tre të katërtat e këtyre organizatave kanë qëllime të shumëfishta, por një e katërta (39) deklaroi se qëllimi i tyre primar është ofrimi i ndihmës humanitare për kategori të ndryshme të viktimave të luftës – të vejave, jetimëve, personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), familjeve të dëshmorëve, familjeve të veteranëve, familjeve të civilëve të zhdukur apo të vrarë dhe invalidëve të luftës. Përfaqësuesit më të drejtpërdrejtë të viktimave janë shoqatat e familjeve të civilëve të pagjetur ose të vrarë, dhe janë 25 prej tyre. Organizata të tjera të përbëra nga grupe, interesat e të cilave i përfaqësojnë drejtpërdrejt janë shoqatat e veteranëve të luftës së UÇK-së (9), invalidëve të

¹⁸⁵Analizë e bazuar në bazën e të dhënave të Ministrisë së Administratës Publike.

luftës (10), të burgosurve politikë (6) dhe të zhvendosurve (3). Përveç kësaj, shtatë organizata të tjera janë të regjistruara me qëllim parësor mbledhjen e provave për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Organizatat e mbetura përfaqësojnë interesat e grupeve specifike në mënyrë indirekte, duke përfshirë: – ato që ndihmojnë PZHBV-të (20), ato që ofrojnë mbështetje për gratë (16), ato që ofrojnë mbështetje psikologjike (14), ato që mbështesin viktimat e dhunës seksuale (4), ato që mbështesin viktimat e minave tokësore (4), ato qëllimi i të cilave është përkujtimi (5) dhe ato që qëllim kanë rimëkëmbjen pas luftës (4). Këto organizata janë të regjistruara në 29 nga 38 komunat e Kosovës, shumica (50) e tyre në Prishtinë.¹⁸⁶

Deri më tani nuk është bërë asnjë analizë gjithëpërfshirëse mbi situatën sociale të viktimave të luftës, apo vlerësim i kapaciteteve teknike të shoqatave dhe OJQ-ve që merren me viktimat civile apo personat e zhdukur dhe familjet e tyre. Vlerësimi i nevojave të viktimave të luftës i ndërmarrë nga Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP) në vitin 2012 i identifikoi barrierat që i pengojnë viktimat të kenë qasje në shërbimet në dispozicion të tyre, duke përfshirë mungesën e njohurive për përfitimet, burimet e pamjaftueshme, mbështetjen institucionale, njohjen, ofrimin e shkathtësive arsimore/punësimit, mbështetje psikologjike dhe shqetësimet mbi sigurinë.¹⁸⁷ Të intervistuarit zbuluan se barrierat më të mëdha lidheshin drejtpërdrejt me varfërinë, ku shumica ishin të shqetësuar për gjetjen e punës dhe kostot në rritje të ushqimit, energjisë elektrike, kujdesit shëndetësor dhe arsimit. Në vitin 2019, UNDP-ja ka hartuar një raport të brendshëm të vlerësimit të nevojave për shoqatat e familjeve të personave të zhdukur dhe fuqizimin ekonomik të familjeve, duke paraqitur të dhëna për tri komuna. Raporti sugjeron fusha potenciale të mbështetjes për fuqizimin ekonomik të këtyre shoqatave dhe viktimave civile në përgjithësi, dhe në veçanti për gratë e përfshira në shoqata.¹⁸⁸ Ndër gratë e intervistuar, niveli më i lartë i arsimit të arritur ishte shkolla e mesme ose arsimit profesional. Vetëm gjysma kishin mbaruar shkollën fillore dhe shumica ishin të papuna, me disa të vetëpunësuar në bujqësi, tekstil ose shërbime pastrimi. Fushat e sugjeruara për ofrimin e ndihmës përfshijnë mbështetjen për ngritjen dhe funksionimin e sipërmarrjeve të biznesit, trajnimin profesional, informimin për mundësitë e punësimit dhe mënyrën e aplikimit për punë, si dhe mbështetjen profesionale për të rinjtë dhe fëmijët nga këto familje.

VIKTIMAT CIVILE TË LUFTËS DHE FAMILJET E TYRE

Viktimat civile

Gjatë luftës së Kosovës e humbën jetën 10,333 civilë ndërmjet periudhës prej janarit 1998 deri në dhjetor 2000, shumica e të cilëve ishin shqiptarë (shih Hyrjen). Kishte edhe disa mijëra civilë që u bënë invalidë si pasojë e luftës. Nuk ka shifra të sakta, por aktualisht 1,801 civilë kanë statusin zyrtar të invalidit civil dhe marrin pension sipas ligjit nr. 04/L-172 (shih Rubrikën 2, faqe 58). Sipas këtij ligji, familjet e viktimave civile të luftës dhe invalidëve të luftës kanë të drejtë për pension nëse janë vrarë ose plagosur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 ose nëse kanë pësuar pasojat brenda tre viteve pas përfundimit të luftës nga mjetet shpërthyes të luftës. Në këtë mënyrë, ligji përjashton viktimat që humbën jetën pas kësaj date në dhunën si pasojë nga konflikti, p.sh. vrasjet me hakmarrje

¹⁸⁶Komunat tjera me organizata të shumta që përfaqësojnë apo mbështesin viktimat e luftës në ndonjë mënyrë: Prizreni (13), Peja (11), Gjakova (11), Rahovec/ (9), Mitrovica e Jugut (10) /Mitrovica Veriore (3), Shtërpçë (3), Graçanicë (2).

¹⁸⁷Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP), 'Vlerësimi i Nevojave të Viktimave të Kosovës', 2012.

¹⁸⁸UNDP, draft punues, Raporti i vlerësimit të nevojave për shoqatat e familjeve të personave të zhdukur dhe fuqizimi ekonomik i familjeve, 2019

të serbëve të Kosovës ose të shqiptarëve të Kosovës nga pjesëtarët e UÇK-së.¹⁸⁹

Familjet e personave të pagjetur

Siç u përmend në hyrje, deri në mars të vitit 2022, 1,620 persona mbeten ende të pagjetur në Kosovë, shumica civile (rreth 1,560) dhe pjesa tjetër anëtarë të grupeve të armatosura.¹⁹⁰ Familjet e të pagjeturve përbëjnë grupin më të madh të viktimave brenda shoqatave të familjeve të të pagjeturve dhe viktimave civile. Në Kosovë janë të regjistruara 25 shoqata të familjarëve të personave të pagjetur dhe viktimave civile të luftës të etnive të ndryshme. Ka edhe organizata të tjera të formuara nga familjarët e të pagjeturve, por qëllimi i tyre parësor është përmirësimi i gjendjes ekonomike të grave që kanë humbur anëtarët e familjes gjatë luftës.

Shoqatat e familjeve kosovare të të pagjeturve dhe viktimave civile që morën pjesë në këtë studim janë themeluar në periudha të ndryshme ndërmjet viteve 2000 dhe 2019. Qëllimi i tyre ka qenë mbledhja dhe shkëmbimi i informacioneve dhe kërkimi i së vërtetës për vendndodhjen e anëtarëve të pagjetur të familjes së tyre. Ata e panë të nevojshme të regjistroheshin si OJQ apo shoqatë, sepse, si individë, e kishin më të vështirë qasjen në institucione sesa personat juridikë. Pavarësisht ndryshimeve të shpeshta administrative në Kosovë dhe përpjekjeve jo të plota të organizatave ndërkombëtare për të zbuluar fatin e atyre personave që mbeten të pagjetur, pritjet mbeten të mëdha. Si rezultat, familjarët e personave të pagjetur punojnë vazhdimisht dhe fort për ta përforcuar këtë si prioritet në çdo administratë që vjen. Disa shoqata kosovare gjithashtu merren me dokumentacion dhe ndihmë juridike:

“Aktivitetet fokusohen, por nuk kufizohen në: mbledhjen e fakteve për humbjet ekonomike, rehabilitimin psikologjik të viktimave dhe mbledhjen e dokumentacionit mbi dëmin ekonomik të luftës dhe dëmin moral të shkaktuar ndaj njerëzve. Më pas, kundër autorëve të krimit janë ngritur padi dhe janë ezauruar të gjitha mjetet juridike brenda territorit të Kosovës. Ne shpesh kemi ofruar edhe shërbimet e një avokati.” (Përfaqësues i shoqatës së viktimave shqiptare nga Kosova)¹⁹¹

“Deri më tani na kanë ndihmuar organizata të mëdha si QKRMT-ja në Prishtinë, por duhet të punojmë në mënyrë të pavarur. Kemi një numër të vogël të stafit ndërsa nevojat e të mbijetuarve dhe viktimave të dhunës në familje janë të mëdha. Kohët e fundit, për mungesë fondesh na është dashur të reduktojmë stafin dhe pandemia na e ka vështirësuar punën në terren.” (Përfaqësuese e shoqatës së grave kosovare).²⁴⁶

Një organizatë tjetër që fokusohet në viktimat e dhunës seksuale të lidhur me luftën është Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), e cila është themeluar në vitin 1999 për të dokumentuar krimet e luftës dhe për të ofruar mbështetje psikosociale dhe rehabilitim fizik për njerëzit që kanë përjetuar trauma të lidhura me konfliktin, për shembull si rezultat i zhvendosjes, dhunës politike ose humbjes së të afërmeve ose miqve të ngushtë.²⁴⁷ Këtu përfshihen ish të burgosurit, të mbijetuarit e masakrave, gratë e përdhunuara, të vejat, jetimët, të kthyerit dhe viktimat e torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, si dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Problemet me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës seksuale janë të shumta, por të anketuarit në këtë hulumtim kanë theksuar se stigma dhe varfëria janë ndër më kryesoret.

243Prokurori i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë kundër Haradinajt, R., Balaj, I., Brahimaj, L. (2005), në dispozicion në:<https://www.icty.org/x/cases/haradinaj/ind/en/har-ii050224e.pdf>

244Fondi për të Drejtën Humanitare – FDH (2021), Zoran Vukotiq merr dënimin e tij të dytë për krime lufte në Kosovë, në dispozicion në:<https://www.hlc-kosovo.org/en/media/saopstenje/82/zoran-vukotic-po-drugi-put-osuden-za-ratne-zlocine-na-kosovu>

245EULEX (2014), 'Dy të pandehur të dënuar për përdhunim si krim lufte', në dispozicion në:<https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,1342>

246Intervista 7, Prill 2021

247Historia e QKRMT-së:<https://krct.org/about-us/history/>

“Qendra jonë është në parim e certifikuar për të ofruar ndihmë për gratë dhe burrat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Kushtet e tyre ekonomike janë shpesh të vështira. Kemi disa gra që presin pafund që Komisioni Shtetëror i Verifikimit t’ua konfirmojë statusin që janë abuzuar seksualisht. Shumë prej grave nuk kanë marrë ende ndonjë trajtim psikoterapeutik dhe madje nuk kanë përdorur as barna. Thjesht i kanë tejkaluar vuajtjet dhe kanë ndarë shqetësimet e tyre me njëra-tjetrën dhe kanë punuar. Kemi 30 gra të tilla që vijnë në punëtoritë tona. Ky ka qenë rehabilitimi më i mirë për to.” (Përfaqësuese e shoqatës së grave kosovare).²⁴⁸

Shumë të mbijetuar të dhunës seksuale fshehin traumën e tyre nga familjet e tyre nga frika se mos refuzohen. Disa kanë kryer vetëvrasje për shkak të qëndrimeve ndaj viktimave të abuzimit seksual dhe një numër i vogël janë vrarë nga një anëtar i familjes në emër të nderit. Shumë viktimat kanë pasur frikë të kërkojnë ndihmë për shkak të abuzimit dhe stigmës.

Disa studiues argumentojnë se ka njëfarë rezistence ndaj pranimit të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin si pjesë e historisë së luftës së Kosovës, sepse rrezikon të minojë parimin qendror të nderit të burrit në identitetin kombëtar shqiptar. Diskursi mbizotërues shqiptar mbi kulturën, dhe përkujtimin në Kosovë i jep përparësi nderimit të burrave dhe heronjve, ndërkohë që rikonfirmon statusin tradicional të grave që kombit i shërbejnë përmes rolit të tyre si bashkëshorte dhe nëna.²⁴⁹

Në vitin 2018, QKRMT dhe Shoqata e Grave Medica Gjakova nisën fushatën ‘Bëhu zëri im’ për të sfiduar stigmën rreth të mbijetuarve të dhunës seksuale të kohës së luftës në Kosovë dhe për të inkurajuar publikun që të diskutojë hapur dhunën seksuale që ka ndodhur gjatë luftës. Gjithashtu ofruan burime dhe informacione për të ndihmuar të mbijetuarit të aplikojnë për statusin e viktimave të dhunës seksuale.²⁵⁰ Ka ende shumë gra viktimat të dhunës seksuale që duan të aplikojnë për pension, por nuk lejohen nga bashkëshortët e tyre.

“Ne kemi shumë gra viktimat të dhunës seksuale që jetojnë me frikën se burrat e tyre do ta marrin vesh këtë gjë. Disa nga ata burra as nuk e dinë që gratë e tyre marrin pension nga shteti. Sa herë që shpërndahen pensionet, vijnë këtu për t’i marrë, pastaj blejnë ushqime dhe i vendosin në pako dhe u thonë burrave dhe familjes së tyre se Shoqata e Grave u ka dhënë pako ushqimore si ndihmë. Kjo u jep grave stres shtesë se si të merren me presionin e familjes dhe komunitetit. Nga 320 gra të identifikuar si të dhunuara seksualisht nga shoqata jonë, vetëm 20% patën guximin t’u tregojnë këtë gjë burrave të tyre. Shumica e këtyre grave tani janë bërë gjyshe dhe duan ta mbajnë të fshehtë historinë e tyre.” (Përfaqësuese e shoqatës së grave kosovare)²⁵¹

Të anketuarit në këtë hulumtim thanë se diskutimi për abuzimin e tyre bëhet edhe më i vështirë kur të abuzuar seksualisht janë meshkujt. Gjersa shumica e njerëzve që janë abuzuar seksualisht gjatë luftës janë gra, edhe shoqata më e vogël që dokumenton dhunën seksuale ka dëshmi të abuzimit të burrave.²⁵²

Komisioni Qeveritar i Kosovës për Verifikimin e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës shpesh kritikohet nga publiku për ngurrimin dhe numrin e vogël të aplikacioneve në lidhje me abuzimin

²⁴⁸Po aty

²⁴⁹Krasniqi V., Sokolić I. dhe Kostovicova D., ‘Fundet si flamuj: drejtësia tranzicionale, gjinia dhe nacionalizmi i përditshëm në Kosovë’ në: Kombet dhe nacionalizmi, prill 2020; 26:461–476. Artikulli i plotë në dispozicion [këtu](#)

²⁵⁰Fushata e Kosovës ‘Bëhu Zëri Im’, https://wp.nyu.edu/gallatin_human_rights_fellows/2019/08/06/kosovos-be-my-voice-behu-zeri-im-campaign/

²⁵¹Po aty

²⁵²Po aty

seksual të lidhur me konfliktin që i shqyrton në krahasim me numrin e pretenduar të viktimave. Megjithatë, anëtarët e Komisionit punojnë vetëm me kohë të pjesshme për këtë çështje dhe thonë se numri i aplikacioneve që ata marrin është i vogël dhe se ato shpesh janë të paplota.

“Është viti i tretë që pranojmë aplikime për verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe numri i aplikimeve është shumë i vogël dhe i cilësisë së dobët. E kuptoj që stigma është e lartë, por numri i aplikimeve nuk është ai që ne synonim.”²⁵³

Të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës theksojnë se ndihma e ofruar për ta ka qenë shumë më e ngadalshme se ajo e ofruar për veteranët pasi, për shkak të stigmës, nuk janë në gjendje të tërheqin vëmendjen për kauzën e tyre përmes protestave në rrugë.

Asnjë organizatë e drejtuar nga serbët në Kosovë nuk merret me viktimat e mundshme të dhunës seksuale gjatë luftës. Një i intervistuar vuri në dukje se, për shkak se viktimat e keqtrajtuara pas qershorit 1999 nuk njihen si viktimat të luftës sipas legjislacionit aktual, siç është rasti me shumicën e viktimave serbe, është e vështirë t'u qasesh viktimave të mundshme dhe t'u kërkosh atyre të dalin publikisht.

“Edhe pse ndihma për të gjitha viktimat e dhunës seksuale, duke përfshirë edhe ato abuzimi i të cilëve ka ndodhur gjatë konfliktit, është në mandatin e organizatës sime, deri më tani ne nuk jemi marrë me këtë çështje dhe as nuk kemi pasur kontakte me viktimat të mundshme. Përveç që është një temë tabu, çdo punë e mundshme nga OJQ-të për identifikimin e këtyre grave ose inkurajimin e tyre për të folur, vështirësohet shumë nga fakti se ato nuk njihen nga ligji si viktimat. As sistemi ligjor serb dhe as ai i Kosovës nuk i njeh viktimat potenciale serbe të dhunës seksuale”. (Përfaqësuese e OJQ-së së grave serbe nga Kosova).²⁵⁴

Siç u shpjegua edhe më sipër, viktimat e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin që ndodhi drejtpërdrejt pas luftës midis qershorit 1999 dhe fundit të vitit 2000 nuk janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës me arsyetimin se gjatë asaj kohe KFOR-i dhe UNMIK-u ishin përgjegjës për sigurinë.

Disa të intervistuar sugjeruan se nevojitet një strategji e re midis OJQ-ve të certifikuara për të punuar mbi dhunën seksuale të lidhur me konfliktin, në bashkëpunim me organizata të tjera të rrjetit të grave dhe komunitetin e donatorëve. Strategjia duhet të fokusohet në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të propozuara dhe të përfshijë trajnimin dhe avokimin e stafit. Pas ndryshimeve në ligj dhe formimit të Komisionit për Verifikimin e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës, është bërë thelbësore të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi të komunitetit për të thyer stigmën që lidhet me dhunën seksuale të lidhur me luftën.

Përmbledhje e nevojave të identifikuara

Për kategoritë e ndryshme të viktimave civile/të mbijetuarve të luftës dhe familjeve të tyre, prioriteti më i lartë është gjetja e së vërtetës dhe arritja e drejtësisë, së bashku me njohjen për sakrificat e bëra nga familjet. Për të arritur këtë, duhet të adresohen edhe nevoja të tjera të shoqatave të viktimave:

- Mbështetje financiare për të drejtuar dhe zgjeruar aktivitetet e tyre, p.sh. përmes granteve të vogla si dhe mbështetjes jofinanciare, të tilla si hapësira për zyra, përjashtimi nga

²⁵³Intervista 2, 7 prill 2021

²⁵⁴Intervista 17, 13 mars 2021

- tarifat e shërbimeve dhe ofrimi i inventarit, në mënyrë që shoqatat të mund të mbijetojnë.
- Përmirësimi i kapaciteteve organizative për të përmirësuar aftësitë e tyre menaxhuese, operacionale dhe komunikuese
- Përmirësimi i njohurive rreth ballafaqimit me të kaluarën (BmK) dhe drejtësinë tranzicionale, dhe parimet themelore, për t'i vendosur aktivitetet e tyre në një këndvështrim më të gjerë dhe për t'u lidhur me iniciativa të tjera.
- Ndërlidhja e aktiviteteve të tyre, siç është mbledhja e provave për krimet e luftës, me organet kompetente dhe mbledhja dhe ruajtja e informatave në bazat e të dhënave.
- Duke qenë se anëtarët e shoqatave më të mëdha po plaken, duhen zhvilluar aktivitete për të motivuar dhe trajnuar të rinjtë për t'u përfshirë në punë, gjë që do të përmirësonte cilësinë e punës dhe do t'i bënte organizatat më të qëndrueshme.

TË BURGOSURIT POLITIKË

Nuk ka të dhëna të besueshme ose gjithëpërfshirëse për numrin e të burgosurve politikë të mbajtur në ish-Republikën Jugosllave, apo në shtetet pasardhëse të saj. Kundërshtarët politikë të regjimit socialist (të të gjitha etnive) u futën në burg me akuzat për 'separatizëm', 'organizim dhe pjesëmarrje në demonstrata' ose 'aktivitet në grupe ilegale'.²⁵⁵ Në luftërat gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, kishte kampe burgu në territorin e ish-republikës që mbanin kundërshtarë ushtarakë dhe civilë, shpesh pa proces të rregullt.²⁵⁶ Gjatë viteve 1990, shumë shqiptarë u mbajtën në burgje nën kontrollin e policisë serbe. Shumë prej tyre u mbajtën për disa vite, ndonjëherë disa herë, dhe iu nënshtuan torturave.²⁵⁷

Hulumtimi në vitin 2015 nga Komisioni Qeveritar i Kosovës për Verifikimin dhe Njohjen e të Burgosurve Politikë konfirmoi se 6,774 burra dhe gra shqiptare të Kosovës ishin burgosur politikisht gjatë viteve 1990.²⁵⁸ Megjithatë, jo të gjithë janë njohur ende zyrtarisht. Që nga viti 2014, Komisioni ka konfirmuar statusin e mbi 2,840 ish të burgosurve politikë, por deri në vitin 2020 janë pranuar 12,670 aplikime.²⁵⁹ Balkan Insight zbuloi se "shumica e atyre që po kompensohen u burgosën gjatë periudhës 1990–95, dhe ka shqetësime se do të duhen disa vite për të përfunduar i gjithë procesi sepse 4,000 persona të tjerë kanë aplikuar për kompensim për periudhën 1998–99".²⁶⁰

Pas lirimimit nga burgu, disa nga shqiptarët e burgosur politikë vazhduan aktivitetin e tyre ose duke iu bashkuar partive politike ose duke iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Shumë ish të burgosur politikë u aktivizuan në parti politike apo sindikata, ndërsa disa nga ata që ishin më të rinj morën pjesë aktive në luftën e Kosovës.

Drejtimesit e shoqatave shqiptare të ish të burgosurve politikë refuzojnë të identifikohen si viktime.

²⁵⁵Ristanović, P. (2020), 'Kosovsko pitanje 1974–1989' (Çështja e Kosovës 1974–1989), botimi i dytë, Prometej, Novi Sad dhe Informatika Beograd, fq. 218 – 221

²⁵⁶Amnesty International. 'Republika Federale e Jugosllavisë: Vdekja e dy shqiptarëve të tjerë në paraburgim nxjerr në pah frikën për qindra të burgosur të Kosovës', 18 gusht 1998, njoftim për shtyp në dispozicion [këtu](#).

²⁵⁷Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG), 'Shqiptarët e Kosovës në burgjet serbe: puna e papërfunduar e Kosovës', 26 janar 2000, në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/3ae6a6e10.html> [qasur më 22 dhjetor 2021]

²⁵⁸Fazliu, Eraldin, 'Të Burgosurit Politikë të Kosovës', Kosovë 2.0, 26.04.2016. <https://kosovotwopointzero.com/en/kosovos-political-prisoners/>

²⁵⁹Serbeze Haxhijaj, "Guerilët e Kosovës" kërkojnë statusin e të burgosurit politik", Balkan Insight, 13 janar 2020, [Armëtarët e Guerilëve të Kosovës kërkojnë statusin e të burgosurit politik | Balkan Insajti](#)

²⁶⁰Serbeze Haxhijaj, "Vrasjet politike të Kosovës: të pandëshkuara por jo të harruara", Balkan Insight, 5 mars 2018. <https://BalkanInsight.com/2018/03/06/kosovo-s-political-vrasjet-të-pandënuara-por-jo-të-harruara-03-05-2018/>

“Ne respektojmë kategoritë e tjera të luftës. Por ne nuk identifikohemi në asnjë mënyrë me viktimat e tjera sepse konsiderojmë se me vetëdije dhe për të mirën e vendit i kemi rezistuar regjimeve në ish-Jugosllavi, si dhe i jemi bashkuar luftës për çlirim”. (Zëvendëskryetari i shoqatës së të burgosurve politikë kosovarë)²⁶¹

Në qershor të vitit 2020, me kërkesë të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, Qeveria e Kosovës vendosi ta kthejë Burgun e Prishtinës në muze.²⁶²

2.3 Nismat zyrtare lidhur me drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, mekanizma të ndryshëm janë themeluar për t'u ballafaquar me periudhën e kohës së luftës. Dy raporte të mëhershme i kanë renditur të gjithë mekanizmat zyrtare dhe institucionet në Kosovë që merren me drejtësinë tranzicionale në hollësi.²⁶³ Këtu, janë përmbledhur vetëm institucionet, politikat dhe ligjet kryesore.

Korniza ligjore e Kosovës

Dhjetëra akte normative dhe ligjore në Kosovë e përcaktojnë respektimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, si dhe mbrojtjen e pakicave nga diskriminimi. Pasi që Kosova nuk është shtet anëtarë e OKB-së, nuk mund ta ratifikojë Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike. Megjithatë, të njëjtat parime themelore janë të mishëruara në Kushtetutën e Kosovës.²⁶⁴ Edhe para shpalljes së pavarësisë, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ('Plani i Ahtisarit') i paraqiti obligim shtetit që po lindte për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë trashëgiminë fetare dhe kulturore të qytetarëve dhe të drejtat e refugjatëve dhe emigrantëve dhe për të krijuar mekanizma për gjetjen e personave të zhdukur dhe trajtimin e problemeve ekonomike dhe varfërinë.²⁶⁵ Kështu, Kosova zgjodhi parime demoraktike që janë themelore. Poashtu, Kosova zgjodhi rrugën evropiane, duke e hartuar Planin e Veprimit për Bisedime për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në vitin 2012, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2016. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit fokusohet në zbatimin e vlerave thelbësore demokratike dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kushtetuese në përputhje me normat evropiane. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit dhe politikave të të drejtave të njeriut shpesh pengohet nga burimet e pamjaftueshme financiare dhe të tjera, sidomos në nivel lokal, prioritetet e kufizuara politike dhe mungesa e koordinimit.²⁶⁶ Sipas raportit të BE-së për Kosovën në vitin 2020, zbatimi i legjislacionit të të drejtave të njeriut si dhe monitorimi dhe koordinimi i mekanizmave të themeluar për të drejtat e njeriut, mbetet sfidë sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.²⁶⁷

Ligjet përkatëse janë renditur në Rubrikën 2 në faqe 58.

²⁶¹ Intervistë 20, 27 Prill 2021

²⁶² Serbeze Haxhiaj, 'Kosova do ta shndërronë burgun për të burgosurit politikë në muze', Balkan Insight, 2 qershor 2020, <https://balkaninsight.com/2020/06/02/kosova-to-transform-burg-for-political-prisoners-into-museum/>

²⁶³ Ahmetaj, N. & Unger, Th. (2017), op cit. dhe Visoka, G. & B. Lumi, 'Democratizing Transitional Justice: Towards a Deliberative Infrastructure for Dealing with the Past in Kosovo', Integra, NSI, PAX, Qershor 2020, <https://paxforpeace.nl/what-we-do/publications/democratizing-transitional-justice-in-kosovo>

²⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e disponueshme në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

²⁶⁵ Plani i Ahtisarit është një zgjidhje e propozuar për statusin nga ish-Presidenti i Finlandës Martti Ahtisaari.

²⁶⁶ Komisioni Evropian, 'Raporti i Progresit për Kosovën 2020', shih https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

²⁶⁷ Po aty.

Skemat pensionale për viktimat e luftës

Në maj të vitit 2021, gjithsej 13,426 persona morën pensione në kuadër të skemës pensionale të ligjit 4/L-054 dhe 04/L-172, sipas të dhënave të ofruara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Skema i kushton qeverisë mbi €3,3 milion në baza mujore. Mbi 90% e përfituesve janë shqiptarë-K (13,313), ndërsa 113 përfitues janë nga grupet etnike joshumicë. Gratë përbëjnë 6,799 të përfituesve në kuadër të kësaj skeme, që është pak më shumë se numri i përgjithshëm i përfituesve meshkuj (6,627). Familjet e dëshmorëve të UÇK-ës dhe familjet e personave të zhdukur të UÇK-së marrin shumat më të mëdha me këtë skemë, që arrin shumën rreth 448€ në muaj. Dallimi në asistencën që marrin këto grupe është i madh duke marrë parasysh që familjet e civilëve të zhdukur marrin një asistencë mesatare mujore prej 172€, ndërsa familjet e viktimave civile marrin 171€.

Invalidët e luftës janë kategoria më e madhe në kuadër të kësaj skeme, me mbi 4,700 përfitues. Përveç kësaj, më shumë se 230 familje të invalidëve të luftës vazhdojnë ta marrin pensionin pas vdekjes së invalidit të luftës. Familjet e viktimave civile përbëjnë mbi 3,800 përfitues, pasuar nga më shumë se 2,200 familjarë të dëshmorëve dhe 1,801 invalidë civilë. Kategoria më e vogël në kuadër të kësaj skeme janë kujdestarët e invalidëve të UÇK-së (82) dhe kujdestarët e invalidëve civilë (33). 114 familje të invalidëve civilë vazhdojnë t'i marrin pensionet pas vdekjes së tyre.

Përfaqësuesit e grupeve të viktimave që morën pjesë në këtë hulumtim u ankuan për atë që e shohin si diskriminim për shkak të dallimit të dukshëm në shumën e pensioneve të aprovuara për grupe të ndryshme të viktimave. Për shembull, nëse një grua që merr një pension si e mbijetuar e dhunës seksuale është e veja e një ushtari të vrarë gjatë luftës, ajo duhet të zgjedhë cilin pension ta marrë. Në fakt, sipas Ligjit, asnjë përfitues i pensionit të kësaj skeme nuk mund të përfitojë nga një pension tjetër, duke përfshirë pensionin për moshë të shtyrë që iu ofrohet të gjithë qytetarëve kosovarë më të vjetër se 65 vjeç. Pakënaqësia me një marrëveshje të tillë është shprehur edhe nga kryetari i shoqatës Ngritja e Zërit, e cila merret me dokumentimin e humbjeve ekonomike dhe dëmeve fizike të luftës:

"Nga niveli qendror, të gjitha kategoritë e viktimave vazhdojnë të marrin asistencë sociale. Kjo vlen edhe për veteranët. Por diskriminimi ndodh kur një veteran arrin moshën 65 vjeçare, atij i kërkohet të zgjedhë cilin pension dëshiron ta marrë." (Përfaqësues i shoqatës së viktimave shqiptare-K)²⁶⁸

Njëkohësisht, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka paralajmëruar që pagesat e pensioneve/dëmshpërblimeve për ish-të burgosurit politikë, veteranët e luftës dhe kategoritë e tjera të dala nga lufta janë bërë barrë e rëndë për buxhetin e Kosovës dhe vazhdimisht i ka bërë thirrje Kosovës të ketë kujdes për këto skema për shkak të kostos së tyre të lartë.²⁶⁹

Ndjekja penale e krimeve të luftës

Menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur, UNMIK-u mori nën kontroll qeverisjen, policinë dhe sistemin e drejtësisë në Kosovë. Në përpjekje për ta përsheptuar procesin e hetimeve dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës, UNMIK-u shumë shpejt e miratoi një rregullore e cila i lejonte administratës emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në tërë Kosovën. Ky ishte model hibrid i një sistemi të gjykatave i mandatuar nga OKB-ja me juridiksion për krime të luftës. Për ta shmangur anshmërinë etnike në gjykimet e krimeve të luftës, gjykatësit dhe prokurorët vendorë

²⁶⁸ Intervistë më 5, 6 prill 2021

²⁶⁹ Serbeze Haxhijaj, 'Kosovo guerrillas' gun runners demand political prisoner status', Balkan Insight, 13.01.2020, <https://Balkan-Insight.com/2020/01/13/kosovo-querrillas-gun-runners-demand-political-prisoner-status>

nuk patën dëshirë ose mundësi të vazhdonin me ndjekjen penale të krimeve të luftës.²⁷⁰ Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, gjykatat e Republikës së Kosovës morën përsipër ndjekjen penale të krimeve të luftës, të plotësuara me Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), një organ gjyqësor i mandatuar nga BE-ja për ndjekjen penale të krimeve të luftës. Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it funksionuan në kuadër të sistemit prokurorial dhe gjyqësor të Kosovës por funksionuan në mënyrë të pavarur në përzgjedhjen e rasteve. Në një raport të mëhershëm janë përmbledhur sfidat e mëdha të rasteve të krimeve të luftës për sistemin gjyqësor të Kosovës:

“Megjithëse UNMIK-u i ka identifikuar rreth 1,200 krime të mundshme të luftës, për vetëm dhjetë raste (23 individë) janë ngritur aktakuza mes viteve 2000 dhe 2008. EULEX-i e mori përsipër këtë numër të madh të rasteve prej pothuajse 1,200 rastesh të krimeve të luftës. Deri në vitin 2004, i kishte përmblyllur 500 raste për shkak të mungesës së dëshmitë, ndërsa 600 raste janë në pritje dhe 51 raste të reja të krimeve të luftës kanë filluar. Nga viti 2009 deri në vitin 2018, EULEX-i arriti të ngrisë aktakuza në vetëm 22 raste (52 individë). Së paku një e treta e tyre kanë përfshirë autorë të supozuar të krimeve të përkatësisë etnike serbe.”²⁷¹

Poashtu, TPNJ i ka ndjekur penalisht krimet e rënda të kryera në Kosovë mes vitit 2007 dhe 2014, me dy raste kundër komandantëve të lartë të UÇK-së (gjashtë individë; një i dënuar) dhe dy raste kundër forcave jugosllave/serbe (tetë individë; pesë të dënuar).²⁷²

Gradualisht, EULEX-i ua transferoi gjykatave vendore rastet e krimeve të luftës. Që nga qershori i vitit 2018, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) i mori kompetencat ekskluzive për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës penale në Kosovë. Strategjia e Krimeve të Luftës e vitit 2019 e cila e udhëzon punën e PSRK-së synon të sigurojë përkushtim më të madh nga autoritetet kosovare për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës.²⁷³

Përkundër kësaj strategjie, ndjekja penale e rasteve të krimeve të luftës në Kosovë vazhdon t'i ketë dy sfida kryesore, përveç dekadave që kanë kaluar që nga përfundimi i luftës. Fillimisht, ekziston një kontekst i pafavorshëm social dhe politik që gjykatat e Kosovës t'i hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë rastet e krimeve të luftës ku përfshihen ish-anëtarët e UÇK-së. Së dyti, shumica e kriminelëve të supozuar serbë të luftës banojnë në Serbi por bashkëpunimi gjyqësor me Serbinë është i kufizuar. Përkundër Marrëveshjes së vitit 2013 të ndërmjetësuar nga BE-ja për Asistencë të Ndërsjellë Ligjore, bashkëpunimi për rastet penale është larg nga të qenët i lehtë, gjë që e pengon mundësinë për t'i hetuar dhe gjykuar rastet e krimeve të luftës të kryera nga autorët serb.²⁷⁴ Këto rrethana lënë një numër të madh dosjesh të rasteve të krimeve të luftës të hapura, duke e penguar qasjen e viktimave në drejtësi.²⁷⁵

Në vitin 2016, u krijuan zyrtarisht Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Prokuroria Speciale (DHSK

270 QHDP, 'Vështirësi në të gjitha frontet: Për institucionet, gjyqësorin dhe mediat e Kosovës, ballafaqimi me të kaluarën është një çështje e ngatërruar, 2013

271 Schenkel, Kathelijne, 'Gjykata Speciale e Kosovës dhe Drejtësia Tranzicionale: Përshtypjet e publikut për GJSK-në dhe nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse të DT-së, f.14. Integra & PAX, mars 2021, i disponueshëm [këtu](#)

272 Tribunali Ndërkombëtar Penal i Kombeve të Bashkuara për Ish-Jugosllavi, 'Figurat Kryesore të Rasteve', i disponueshëm [këtu](#)

273 Republika e Kosovës, 'Strategjia e Krimeve të Luftës', shkurt 2019, e disponueshme [këtu](#)

274 Bami, Xhorxhina & Blerta Iberdemaj, 'BIRN Fact-Check: Do Serbia and Kosovo Really Cooperate on Court Cases?', 2 mars 2022, <https://balkaninsight.com/2022/03/01/birn-fact-check-do-serbia-and-kosovo-really-cooperate-on-court-cases>

275 Visoka & Lumi (qershor 2020), op cit.

& PS) “me një mandat dhe juridiksion të caktuar për krime kundër njerëzimit, krime të luftës dhe krime të tjera sipas ligjit të Kosovës, që kanë filluar ose janë kryer në Kosovë në periudhën nga 1 janari 1998 dhe 31 dhjetori 2000 nga ose ndaj qytetarëve të Kosovës ose të Republikës Federative të Jugosllavisë”.²⁷⁶ DHSK/PS është një gjykatë në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës por me bazë në Hagë (Holandë), ku ndodhen katër Dhoma të Specializuara dhe Prokuroria Speciale. Ajo merret me krime të pretenduara që kanë ndodhur gjatë dhe menjëherë pas luftës në Kosovë dhe që janë kryer ndaj pakicave etnike dhe kundërshtarëve politik të UÇK-së. DHSK/PS dallon nga institucionet e tjera kosovare dhe vepron në vetvete.²⁷⁷ Në mesin e shqiptarëve të Kosovës, e ashtuquajtuara “Gjykata Speciale” në përgjithësi përçmohet, pasi që shihet si një përpjekje për ta delegitimizuar luftën e UÇK-së për liri kundër shtypjes serbe. Në tetor të vitit 2020, ish-Presidenti Hashim Thaçi dhe ish-Kryetari i Kuvendit Kadri Veseli, të dy figura të larta të UÇK-së gjatë luftës, u arrestuan dhe u dërguan në Hagë për t’u ballafaquar me akuzat.²⁷⁸ DHSK aktualisht ka katër raste kundër tetë personave, dy prej të cilëve janë në procedurë paraprake, një që është në fazën finale të gjykimit dhe një për të cilin tashmë ka një aktgjykim të shkallës së parë.

NISMAT TJERA INSTITUCIONALE PËR BALLAFAQIM ME TË KALUARËN

Përveç mekanizmave gjyqësorë, Instituti i Kosovës për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, një institut publik hulmues në kuadër të Ministrisë së Dretjesisë, filloi së funksionuari më 15 qershor 2011. Misioni i Institutit ishte të mblidhte, të organizonte, të përpunonte dhe të publikonte informata për krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe gjenocidin e kryer në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999. Nëntë vite më pas, u mbyll pasi që nuk arriti të prodhonte rezultate domethënëse. Megjithatë, në vitin 2020, Ministria e Dretjesisë së Kosovës themeloi një ekip përgatitor të shikonte mundësitë e krijimit të një Instituti të ri për Hulumtimin e Krimeve të Luftës.²⁷⁹

Para përfundimit të mandatit të saj në fund të vitit 2012, Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) për Kosovën, e cila e kishte mbikëqyrur zbatimin e Planit të Athisarit nga Qeveria e Kosovës, i la Qeverisë së Kosovës një pako masash për t’i zbatuar. Një nga ato pako ishte krijimi i një Grupi Punues Ndërministror (GPM) për zhvillimin e Strategjisë për Ballafaqimin me të kaluarën dhe Pajtimin, i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe anëtarë të ministrive përkatëse. Mbështetja politike dhe financiare për projektin nga institucionet kosovare ishte tejet e kufizuar. Përfaqësuesit e ministrive që duhej të kishin qenë akterët kryesorë në këtë proces nuk ishin të gatshëm të angazhoheshin në punën e tij dhe eventualisht u reduktua në një forum diskutimesh për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe stafin teknik të UNDP-së. Nisma përfundoi në vitin 2016 pa e realizuar strategjinë.²⁸⁰ Pesë vite më vonë, në korrik të vitit 2021, Divizioni për Drejtësi Tranzicionale në kuadër të Departamentit të Drejtësisë Tranzicionale dhe Mbështetjes për Viktima në Ministrinë e Dretjesisë e mori nismën për hartimin e një strategjie kombëtare për drejtësinë tranzicionale për Kosovën. U themelua një Grup Punues, i përbërë nga anëtarët e institucioneve të Kosovës dhe akterët e shoqërisë civile, për hartimin e

276 Uebfaqja e DHSK & PS: <https://www.scp-ks.org/en>

277 Për një pasqyrë të plotë të strukturës dhe funksionimit të DHSK & PS, shih Schenkel (mars 2021), op cit.

278 Haxhijaj, Serbeze, ‘Gjykata e re ballafaqohet me problem të vjetra në mbrojtjen e dëshmitarëve të Kosovës’, 8 mars 2021; <https://BalkanInsight.com/2021/03/08/new-court-faces-old-problems-in-protecting-kosovo-witnesses/>

279 Haxhijaj, S., ‘Kosova përpiqet përsëri ta themelojë Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës’, 20 maj 2020, <https://balkaninsight.com/2020/05/20/kosovo-tries-again-to-establish-war-crimes-research-institute/>

280 Ahmetaj, Nora & Unger, Thomas, ‘Kosovo’s Framework for Dealing with the Past at a Turning Point: Civil society review of progress towards a National Strategy on Transitional Justice’, 2017, i disponueshëm në: <https://paxvoorvrede.nl/media/download/civil-society-review-report-final-eng.pdf>

Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale.²⁸¹ Dallimi mes kësaj dhe procesit të vitit 2012 është se nisura aktuale e plotëson një hendek të identifikuar në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën dhe strategjia është miratuar zyrtarisht në programin e punës të Ministrisë së Drejtësisë.

Në vitin 2017, presidenti i atëhershëm, Hashim Thaçi, mori një nismë për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit (KVP) për Kosovën. Pas tri konsultimeve të përgjithshme, në vitin 2018 Presidenti e mandatoi një Ekip Përgatitor për ta përgatitur një Akt Normativ për themelimin e Komisionit. Një anketë publike tregoi se shumica e qytetarëve të Kosovës mendojnë se pajtimi është i nevojshëm dhe se e vërteta dhe drejtësia janë parakushte të rëndësishme për arritjen e tij dhe për këtë arsye do ta mbështesin KVP-në. Megjithatë, u shprehën dyshime serioze pasi që Thaçi kishte qenë ish-komandant i lartë i UÇK-së.²⁸² Pas një procesi gjithëpërfshirës të konsultimeve, Ekipi Përgatitor e finalizoi Projekt Aktin Normativ në vitin 2020. Menjëherë më pas, Presidenti Thaçi dha dorëheqje sepse ndaj tij u ngrit aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga DHSK/PS.²⁸³ Presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, ka premtuar se do ta vlerësojë punën e Ekipe Përgatitor para se të vendosë se si do të finalizohet dokumentimi dhe themelimi eventual i KVP-së.

MEMORIALET DHE CEREMONITË PËRKUJTIMORE

Memorialet për konfliktin e armatosur në Kosovë janë kryesisht monoetnike, etno-nacionaliste dhe janë të ndërthurura me diskurse nacionaliste që e përjetësojnë patriarkatin.²⁸⁴ Një numër monumentesh i janë kushtuar kujtimit të civilëve të vrarë në masakra, por shumica e simbolizojnë krenarinë kombëtare (shqiptare-K), tregimet legjendare të triumfit, guximin dhe sakrificën e ushtarëve të rënë për luftën çlirimtare dhe virtytet e mëdha të heronjëve individualë, siç ndodh zakonisht në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor. Përkujtimet zyrtare janë përqendruar kryesisht në heroizmin e UÇK-së dhe viktimave shqiptare-K,²⁸⁵ gjë që rrezikon t'i mbajë "gjallë emocionet ekskluzive dhe përçarëse të viteve të luftës".²⁸⁶ Ky memorializim etno-nacionalist ndodh jo vetëm me memorialet dhe ceremonitë përkujtimore por edhe në emërimin e hapësirave publike dhe në simbolet e ritualet e tjera përkujtimore që kanë të bëjnë me luftën.²⁸⁷

Mënyra në të cilën shteti i Kosovës i realizon ose i mban memorialet mbetet tejet e kontestuar. Çdo vit, më 27 prill, në Ditën Kombëtare të Personave të Zhdukur në Kosovë, qindra njerëz mblidhen në Mejë për t'i përkujtuar viktimat e Masakrës së Mejës të vitit 1999, masakra më e madhe në luftën e Kosovës. Rreth 370 civilë shqiptarë, në mesin e tyre tri femra, u vranë nga policia dhe forcat e armatosura serbe derisa po iknin për në Shqipëri për strehim. Qeveria e sponsorizoi ndërtimin e një memoriali në Mejë 'Varrezat e Dëshmorëve', por ka mbetur i papërfunduar. Familjeve të të vrarëve dhe

281 Shih uebfaqen e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1.162>

282 Ahmetaj, N. & K. Schenkel, 'Anketa e përshtypjeve publike dhe dialogu publik për Komisionin e ardhshëm të së Vërtetës dhe Pajtitimit (KVP) të Kosovës', Integra dhe NSI, 4 mars 2020, https://ngo-integra.org/publication/Perception_Survey_KS-%20final%20ENG.pdf

283 Haxhijaj, S., 'Kosovo Truth Commission's Future in Doubt After Thaci's Indictment', Balkan Insight, 15 dhjetor 2020, <https://BalkanInsight.com/2020/12/15/kosovo-truth-commissions-future-in-doubt-after-thacis-indictment/>

284 Visoka, G., 'Arrested Truth: Transitional Justice and the Politics of Remembrance in Kosovo', *Journal of Human Rights Practice*, 8:1 (2016): 62-80

285 Për shembull, dita e dëshmorëve më 5 maj fokusohet në kujtimin e luftëtarëve të rënë të UÇK-së. Janë edhe një sërë ditësh të lokalizuara përkujtimore në të cilat përkujtohen vende të ndryshme të masakrave.

286 Schrader, Lutz, 'Monuments and politics of identity in the Western Balkans', *Made in KS: Periodical dedicated to learning from the past in Kosovo*, Nr. 11, 2012, p6

287 Baliqi, B., 'Divided memories – divided youth: How war remembrance affects ethnic identity and political attitudes among youth in Kosovo?' e disponueshme në https://www.bpb.de/medien/237737/Baliqi_paper.pdf

të zhdukurve nuk iu pëlqeu plani dhe puna e bërë nga kompania e kontraktuar nga qeveria, kështu që iu kërkuan artistëve që e kishin bërë planin e një memoriali për komunën e Gjakovës ta bënte një plan të ri në bazë të asaj që donin ata.²⁸⁸ Një shoqatë lokale, '27 Prilli', ka thënë se do të kujdesej për varrezat, por ka nevojë për mbështetje nga qeveria ose donatorët për ta paguar dike që të merret me delegacionet, mysafirët zyrtarë, hulumtuesit dhe gazetarët që e vizitojnë atë.²⁸⁹

Një shembull tjetër është Memoriali i ushtarëve të UÇK-së në Marinë, Skënderaj. Ky lokacion u themelua me fonde të jashtme në vitin 2005, por pas vitesh neglizhence nga ana e autoriteteve të Kosovës, donatorët vendosën ta mbyllnin në vitin 2014.²⁹⁰ Më vonë, Qeveria e Kosovës vendosi ta bënte memorial kolektiv dhe t'i rivarroshte luftëtarët e ndjerë të UÇK-së aty, në disa raste pa i njoftuar familjet e të ndjerëve.²⁹¹

Shpesh, emrat e viktimave joshqiptare janë lënë jashtë memorialeve. Në pllakën përkujtimore në Mitrovicën e Jugut, në të cilën radhiten emrat e gjashtë viktimave etnike shqiptare të masakrës së Tregut të Gjelbër në mars 1999, fillimisht u la jashtë emri i një vajze rome. Pasi që hulumtimet në fillim të gushtit 2020 konfirmuan që ajo ishte vrarë në atë masakër, autoritetet reagues me indiferencë. Vetëm pas një fushate të aktivistëve të të drejtave civile që i kërkuan komunës, u shtua emri i saj në memorial.²⁹²

Në përputhje me qëllimin e ndërtimit të kombit, shumica e memorialeve në Kosovë paraqesin simbole të luftës, luftëtarë të fortë dhe heroizëm mashkullor, në përputhje me normat patriarkale. Kjo paraqet pengesa të mëtejshme për gratë që kërkojnë ta sfidojnë status kuo-në e dominuar nga meshkujt.²⁹³ Më 12 qershor 2015, u zbulua memoriali *Heroinat* në Prishtinë, dedikuar viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit të viteve 1998-99. Megjithatë, nuk kishte përpjekje për t'i përfshirë dhe konsultuar të prekurat, as një proces më të gjerë të diskutimit social, duke ua mohuar viktimave çdo ndjenjë të pronësisë mbi memorialin.²⁹⁴

Në zonat me shumicë serbe, një numër monumentesh dhe pllakash përkujtojnë viktimat kryesisht civile të përkatësisë etnike serbe. Më i njohuri është monumenti i të pagjeturve në Graçanicë, i cili u ngrit nga shoqata lokale e familjeve të të pagjeturve dhe autoritetet lokale në vitin 2014 dhe iu kushtohet të gjithë personave të pagjetur. Në disa komuna të tjera me shumicë serbe, si Shtërpca, Zubin Potoku dhe Mitrovica Veriore, monumentet iu kushtohen banorëve vendas të pagjetur dhe të vrarë, duke përfshirë viktimat e "agresionit të NATO-s". Sa iu përket përkujtimeve kushtuar luftëtarëve, një shesh përballë urës kryesore në Mitrovicën e Veriut i kushtohet tre vëllezërve nga familja Miliq, të cilët ishin ushtarë serbë të vrarë në Kosovë.

288 Intervistë 20 prill 2020

289 Intervistë 12, 20 prill 2021

290 Edona Peci, 'Kosovo MPs Outraged as War Memorial Closes', Balkan Transitional Justice, 2014, e disponueshme në: <http://www.BalkanInsight.com/en/article/kosovo-mps-slam-government-on-memorial-neglect>

291 Haxhijaj, S., 'Kosovo reburies Wartime Guerrillas at new "Martyrs Complexes"', Balkan Insight, 17 gusht 2018, <https://balkaninsight.com/2018/08/20/kosovo-reburies-wartime-guerrillas-at-new-martyrs-complexes-08-17-2018/>

292 Prishtina Insight, 'Elizabeta Hasani's name added to Mitrovica memorial', 18 gusht 2020, <https://prishtinainsight.com/elizabeta-hasanis-name-added-to-mitrovica-memorial/>

293 QHDP, 'Memorializimi pas luftës dhe ballafaqimi me të kaluarën në Republikën e Kosovës', shtator 2015, https://recom.link/wp-content/uploads/2015/10/Post-war_Memorialisation_and_Dealing_with_the_Past_in_the_Republic_of_Kosovo.pdf

294 Po aty.

Në vitin 2012, dega e Kosovës e Asociacionit të Gazetarëve në Serbi vendosi një pllakë përkujtimore për 14 gazetarët e pagjetur dhe të vrarë në Rahovec, ku dy gazetarët e parë që u zhdukën në Kosovë u panë për herë të fundit në vitin 1998. Pllaka është vandalizuar vazhdimisht dhe është zëvendësuar ose restauruar tetë herë që nga vendosja e saj.²⁹⁵ Vendet përkujtimore janë vandalizuar në disa vende, si në memorialet e shqiptarëve ashtu edhe të serbëve të Kosovës.

Agjenda politike përçarëse, nacionaliste e elitës politike po e dëmton memorializimin gjithëpërfshirës, jo vetëm në Kosovë por në tërë rajonin e ish-Jugosllavisë. Institucionet në të gjithë rajonin kanë marrë masa agresive për t'i dekurajuar programet e tilla, përkujtimet gjithëpërfshirëse ose qasjet e bazuara në shumë perspektiva për mësimin e historisë, përveç refuzimit të kërkesave për bashkëpunim ose leje zyrtare.²⁹⁶ Një politikë gjithëpërfshirëse dhe e përbashkët e përkujtimit në Kosovë aktualisht promovohet vetëm nga OJQ-të, të cilat aspirojnë ta çlirojnë të kaluarën nga tendencat etno-nacionaliste duke përfshirë të gjitha anët e konfliktit dhe duke ndërtuar memorializimin lokal, nga poshtë lart ose në mënyrë virtuale.²⁹⁷ Shembuj të tillë janë Libri i Kujtimit i Kosovës i FDH-së, në të cilin janë dokumentuar të gjitha viktimat e luftës në Kosovë dhe projekti i Integra-s 'Trashëgimia e Kujtesës në Kosovë', i cili hulumton trashëgiminë e kujtesës në Kosovë duke përdorur disiplina të ndryshme (hulumtime historike, informatikën dhe teknologjinë) për të ofruar të dhëna historike të sakta dhe jo fiktive.²⁹⁸

Më shumë se dy dekada pas konfliktit, autoritetet e Kosovës nuk kanë një regjistër të hollësishëm zyrtar të monumenteve të luftës. Së fundmi, shefi i Agjencisë Kosovare për Menaxhimin e Memorialeve tha për *Balkan Insight*; "Jemi duke punuar në një bazë të të dhënave në mënyrë që të kemi informata të përgjithshme. I kemi më shumë se 1,600 memoriale të luftës". Ai shtoi se legjislacioni duhet të sigurojë që memorialet janë të sakta historikisht, të punuara në mënyrë profesionale dhe të vendosura në mënyrë të duhur. "Duke iu lejuar të gjithëve të ngrisin monumente dhe memoriale kudo, duke përfshirë qendrat tregtare, zhvlerësohen simbolet e luftës".²⁹⁹

NISMAT E SHOQËRISË CIVILE

Shumica e programeve që e trajtojnë historinë e dhunshme të Kosovës dhe kujtesën/përkujtimin dhe që ofrojnë platforma për perspektiva të shumta në Kosovë janë nisma të shoqërisë civile, aktivistëve dhe artistëve. Ka shumë për t'i renditur këtu, por i kemi përfshirë:

- Hulumtimi dhe dokumentimi i krimeve të luftës dhe viktimave të luftës në Kosovë. Në fillim të viteve 1990, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) veçse kishte filluar mbledhjen e dëshmimeve për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, të cilat u përdorën në rastet e krimeve të luftës. Libri i Kujtesës i Kosovës nga FDH, i përmendur më herët, ofron një përshkrim të detajuar të të gjitha viktimave njerëzore, duke përfshirë të dhënat e tyre personale dhe një

295 KoSsev, 'Burgim me kusht për tre muaj dhe një gjobë për Shaban Berishën për shkatërrimin e monumentit të gazetarëve të rrëmbyer', 9 korrik 2019, <https://kossev.info/sabanu-berisi-uslovna-kazna-od-tri-meseca-zatvora-za-rusenje-ploce-otetim-novinarima/>

296 PAX, 'Mapping Inclusive Memory Initiatives in the Western Balkans', October 2020, <https://paxforpeace.nl/what-we-do/publications/mapping-inclusive-memory-initiatives-in-the-western-balkans>

297 Visoka, G., 'Arrested Truth: Transitional Justice and the Politics of Remembrance in Kosovo', *Journal of Human Rights Practice*, 8:1 (2016):62-80; Visoka & Lumi (dhjetor 2020) op cit.

298 Visoka, G. (qershor 2020), op cit.

299 Haxhiaj, S., 'Unregulated and Unlicensed, War Memorials Proliferate in Kosovo Towns', *Balkan Insight*, 26.03.2021, i disponueshëm këtu

përmbledhje të shkurtër të jetës dhe rrethanave të vdekjes së tyre.

- Dokumentimi dhe ndarja e historive personale nga të mbijetuarit e luftës. Në vitin 2017, Integra publikoi një libër me histori të të mbijetuarave të torturës, 'Unë dua të dëgjohem'.³⁰⁰
- Kërkimi i njohjes për përvojat e grave në luftë, duke përfshirë, mes tjerash, dhunën seksuale gjatë luftës, siç u përmend më herët.
- Monitorimi i zbatimit të ligjeve përkatëse, mes tjerash, nga Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim, realizimi i anketave për të kuptuar se çfarë kanë nevojë qytetarët dhe idetë e tyre në lidhje me përballjen me të kaluarën dhe përkthimi i gjetjeve në avokim me akterët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Mbështetja e familjeve të personave të zhdukur, për shembull përmes ekspozitës "Të jetosh me kujtimet e të pagjeturve", për t'iu dhënë atyre një zë dhe për të siguruar të drejtën e tyre për t'u njohur dhe statusin e dëshmitarëve historikë. Ekspozita është e vendosur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke dërguar një mesazh të fortë se kush ka përgjegjësi më të madhe për përcaktimin e fatit të të zhdukurve.³⁰¹ Kjo dhe nisma të tjera nga OSHC-të, aktivistët dhe artistët që specializojnë në ballafaqimin me të kaluarën, kanë tërhequr vëmendjen kombëtare dhe ndërkombëtare për familjarët e personave të pagjetur.
- OSHC të ndryshme të Kosovës i janë bashkuar 'Koalicionit për RECOM', një rrjet i përbërë nga mbi 2,000 OSHC nga shtetet e ish-Jugosllavisë që avokon për themelimin e Komisionit Rajonal për Zbulimin e Fakteve për të Gjitha Viktimat, Krimet e Luftës dhe Shkeljet e tjera të Rënda të të Drejtave të Njeriut të Kryera në Territorin e Ish-Jugosllavisë nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001 (KOMRA). Për shkak të mungesës së vullnetit politik në disa vende post-jugosllave, nisma për KOMRA-n tani përqendrohet në "krijimin e listës nominale të viktimave të luftërave të viteve 1990 në territorin e ish-Jugosllavisë".³⁰² Rezultati pozitiv i themelimit të KOMRA-s ka qenë që 'ballafaqimi me të kaluarën' është futur në agjendë.

Megjithëse shumë prej këtyre nismave janë të vlefshme në ofrimin e platformave për të ndarë historitë e viktimave dhe të mbijetuarve dhe për ta mbrojtur të vërtetën e drejtësinë për viktimat, sukcesi i tyre në tejkalimin e së kaluarës dhe përmirësimin e lidhjeve etnike në Kosovë është ende në dyshim.³⁰³ Disa aktivistë kritikojnë mungesën e guximit të shoqërisë civile për të qenë më të zëshëm në lidhje me rrëmbimet dhe vrasjet e njerëzve të një etnie tjetër gjatë kohës së luftës. Pa një bazë të fortë institucionale për t'u ballafaquar me të kaluarën, programet e bazuara në projekte dhe të shpërndara kanë pasur një ndikim të kufizuar deri më tani.³⁰⁴

300 Integra, "Unë dua të dëgjohem": libër i kujtesës me histori të të mbijetuarave të torturës gjatë luftës së fundit në Kosovë, 2017, i disponueshëm [këtu](#)

301 Ekspozita ishte nismë e Integrës dhe ForumZFD, në bashkëpunim me QBPZh-në dhe me Kuvendin e Republikës së Kosovës, 2019

302 Rrjeti për Pajtim KOMRA, <https://www.recom.link/en/coalition-for-recom-takes-charge-of-creating-list-of-war-victims-on-the-territory-of-the-former-yugoslavia/>

303 Visoka, G., 2016, op cit. *

304 Visoka, G. & Lumi, B. 'Democratizing Transitional Justice: Towards a Deliberative Infrastructure for Dealing with the Past in Kosovo', Integra, PAX & NSI, korrik 2020 ; <http://newsocialinitiative.org/publications/democratizing-transitional-justice/>

2.4 Diskursi publik për të kaluarën në Kosovë

Në përgjithësi, ekzistojnë disa të vërteta 'ekskluzive' për të kaluarën në Kosovë në përputhje me agjendat etno-nacionaliste të shumicës së akterëve politikë dhe mungesën e përgjithshme të informimit faktik për shumë ngjarje të kohës së luftës.³⁰⁵ Shqiptarët në përgjithësi e shohin luftën e tyre kundër Serbisë si legjitime dhe të vetmen rrugë përmes së cilës Kosova mund të ishte bërë e pavarur. Narrativa dominuese është se ushtarët e UÇK-së ishin luftëtarë të lirisë dhe, si rrjedhojë, heronj, ndërsa forcat serbe ishin agresorët dhe autorët e krimeve masive. Përderisa shkalla e krimeve të UÇK-së nuk mund të barazohet me ato të kryera nga forcat ushtarake, inteligjente dhe policore serbe në Kosovë, vështirë se përmendet ndonjë krim që mund të jetë kryer nga ana e UÇK-së. Kështu, në Kosovë, viktima është ekskluzivisht shqiptare.³⁰⁶ Kjo 'konfirmohet' nga ligji që i nje vetëm (familjet e) viktimave civile të luftës që vdiqën ose u plagosën në periudhën nga 27 shkurti 1998 deri më 20 qershor 1999, duke e përjashtuar të ardhmen e dhunshme të pasluftës me të cilën u përballën kryesisht serbët dhe pakicat tjera.

E gjithë kjo ndodh në një kontekst më të gjerë ku Serbia nuk merr përgjegjësi për represionin e saj ndaj shqiptarëve të Kosovës para luftës, rolin e saj agresiv në luftërat e shpërbërjes së Jugosllavisë, apo shkatërrimet masive dhe krimet e luftës që i kreu në Kosovë, të përkeqësuar nga refuzimi i vazhdueshëm për ta njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Në vitin 2020, Kryeministri Kurti e pushoi njërin prej këshilltarëve të tij pasi që komentoi se luftëtarët individualë të UÇK-së kishin kryer krime gjatë luftës së vitit 1998-1999, që nxiti reagime të ashpra në mesin e shqiptarëve të Kosovës.³⁰⁷ Siç u pa më sipër me memorializimin, shumica e politikanëve të Kosovës vazhdojnë ta lavdërojnë luftën e UÇK-së për liri dhe heroizmin e luftëtarëve të saj. Shumë deputetë, shqiptarë dhe serbë të Kosovës, përgjatë viteve kanë dhënë deklarata problematike lidhur me tema të luftës (shih Rubrikën 3 më poshtë për shembuj).

Një shembull shumë shqetësues i kohëve të fundit ishte kur deputetja e PDK-së Flora Brovina tregoi një fotografi eksplicite në një seancë në sallën e Kuvendit duke pretenduar se tregonte përdhunimin e një gruaje shqiptare nga ushtarët serbë. Fotoja u shpërnda menjëherë nga mediat, me ç'rast vetëm disa media e mjegulluan fotografinë në mënyrë retroaktive, e cila doli të ishte pamje nga një film pornografik. Incidenti tregoi mungesën e ndjeshmërisë së deputetes dhe mediave në lidhje me viktimat e dhunës seksuale dhe brishtësinë e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. FDH-Kosova raportoi se kjo i kishte mërzhitur viktimat dhe kërcënonte sigurinë në zonat me shumicë serbe.³⁰⁸ Reagime të shumta pasuan, ndërsa ish-Presidentja Jahjaga deklaroi që kjo i dekurajon viktimat që të mos flasin dhe ta tregojnë të vërtetën për krimet e kryera në trupin e tyre. Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë e karakterizoi veprimin e deputetes si "oportunizëm politik".

305 Visoka, G. & Lumi, B (qershor 2020), op cit.

306 Visoka (2017), op cit.

307 Balkan Insight, 'In Kosovo Distrust of Hague War Crimes Court Simmers', 12 May 2020, <https://balkaninsight.com/2020/05/12/in-kosovo-distrust-of-hague-war-crimes-court-simmers/>

308 FDH, Parimet e Ballafaqimit me të Kaluarën, i disponueshëm [këtu](#)

SHEMBUJ TË DEKLARATAVE PROBLEMATIKE NGA ZYRTARËT

- Në vitin 2017, deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj kërcënoi se do të kishte spastrim etnik nëse autoritetet franceze do ta ekstradonin vëllaun e tij, Ramush Haradinaj, tek autoritetet e Beogradit për akuza të krimeve të luftës.³⁰⁹
- Në qershor të vitit 2021, deputetja e LVV, Arbëreshë Kryeziu Hyseni, deklaroi në një debat televiziv që çështja e shqiptarëve të pagjetur duhet të ketë përparësi ndaj serbëve të pagjetur.³¹⁰
- Në vitin 2019, zëvendës Ministrja e Drejtësisë, Vesna Mikiq (K-serbe), u pushua pasi postoi në Facebook që bombardimet e NATO-s ishin gjenocid i planifikuar i kryer ndaj një shteti të pavarur që kishte luftuar kundër terrorizmit shqiptar me dekada.
- Dhe e fundit, në vitin 2019, një deputet i Listës Serbe dhe Ministri i atëhershëm, Ivan Todorosijević, u dënua në instancën e parë me dy vite burgim pasi deklaroi se krimet e kryera në Reçak ishin fabrikuar nga 'terroristët shqiptarë'. Dënimi u apelua, pastaj u vërtetua nga Gjykata e Apelit në vitin 2021, por më vonë aktgjykimi u hodh poshtë nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe në fillim të vitit 2022 filloi rigjykimi.³¹¹

309 'UN Urges Kosovo to Probe "Ethnic Cleansing Threat"', Balkan Insight, 11.04.2017, <https://Balkan Insight .com/2017/04/11/un-calls-kosovo-to-investigate-haradinaj-ethnic-cleansing-threat-04-11-2017/>

310 FDH, 'Parimet e Ballafaqimit me të Kaluarën – Barazi, gjithëpërfshirje dhe pajtim: raste studimore', 2020, i disponueshëm [këtu](#)

311 KosSev, 'Vlajic: Hidhet poshtë aktgjykimi për Todorosijevićin, gjykimi i ri fillon në shkurt', 14.02.2022, <https://kossev.info/vlajic-todorosijevics-verdict-returned-a-new-trial-to-start-in-february/>

Aktet e politikanëve për t'i nderuar viktimat e palës tjetër priten me kritika. Në dhjetor 2016, presidenti i atëhershëm Thaçi, ish-komandant i UÇK-së, vendosi lule në nderim të 84 serbëve të Kosovës që vdiqën në Hoçën e Madhe gjatë konfliktit të vitit 1999, duke thënë se *"duhet bërë sakrificë për të arritur pajtim"*.³¹² Partitë opozitare e kritikuan ashpër këtë gjest, ndërsa shoqëria civile heshti dhe nuk e mbështeti publikisht. Në Kuvend, Thaçi e arsyetoi veprimin e tij duke thënë se qëllimi i tij ishte të dërgonte mesazh pajtimi. Ai i hodhi poshtë sugjerimet se me veprimet e tij po e përçmonte betejën e UÇK-së.³¹³ Reagimet e qytetarëve ndaj mbulimit mediatik ishin shumë negative, duke argumentuar se liderët e Serbisë duhet të bëjnë këtë gjest të parët dhe të kërkojnë falje për krimet e kryera kundër civilëve shqiptarë të Kosovës gjatë viteve 1998-1999.

Raportimi i mediave shpesh është ende i njëanshëm, duke ndjekur narrativën e thjeshtë se të gjithë shqiptarët ishin viktima, ndërsa të gjithë serbët janë kriminelë. Në vitin 2004, transmetuesi publik i

312 Morina, D., 'Kosovo President Commemorates Serb War Victims', 16.12.2016, <https://Balkan Insight .com/2016/12/12/president-thaci-commemorates-kosovo-serb-war-victims-12-12-2016/>

313 Morina, D., 'Presidenti i Kosovës e mbron vizitën në memorialet serbe të luftës', Balkan Transitional Justice, 23.12.2016; <https://balkaninsight.com/2016/12/23/kosovo-s-president-justifies-his-visits-at-serb-victims-memorials-12-23-2016/>

Kosovës RTK dhe media të tjera raportuan për akuza të pabaza se djemtë shqiptarë në Çabër ishin mbytur nga serbët, duke shkaktuar fushatën më të madhe të dhunës etnike kundër serbëve dhe monumenteve ortodokse që nga fundi i luftës.³¹⁴ OSBE e vlerësoi rolin e mediave elektronike në këtë incident dhe përfundoi se ishte “raportim i pamatur dhe sensacionalist”.³¹⁵ Kjo nuk i ka ndaluar disa politikanë që të vazhdojnë ta rrotullojnë këtë histori dhe t’i akuzojnë serbët në Kosovën veriore vite më pas.³¹⁶ Shembulli i përmendur më herët për kthimin e serbëve të Kosovës në shtëpitë e tyre në Kosovë poashtu tregon që mediat shpesh luajnë me ndjenja negative duke e quajtur këtë “të jashtëligjshme”.³¹⁷

Në janar të vitit 2021, transmetuesi publik Radio Kosova refuzoi të transmetonte episodin e tretë të një serie prej dhjetë audio dramash për personat e pagjetur gjatë luftës, pavarësisht marrëveshjes me producentin, Koliqi të OJQ-së kosovare, Integra. Episodi i tretë përshkruan historinë e një familjeje serbe. Radio Kosova argumentoi se përmbajtja e “ka ofenduar shumicën”.³¹⁸ Ky akt i transmetuesit publik bëri që Integra dhe Forum ZFD (OJQ gjermane) të lëshojnë një deklaratë duke përmendur censurën. Integra komentoi se “diskursi publik etnocentrik në Kosovë vazhdon të ushqehet dhe të ruhet, në të cilin dominon një narrativë e njëanshme dhe e politizuar. Me një vendim të tillë, Radio Kosova si institucion publik, i financuar nga taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, shkel të drejtat elementare të përfaqësuesve të viktimave civile të luftës, duke ua mohuar të drejtën e shprehjes, të drejtën për të ditur dhe të drejtën për të marrë pjesë në ndërtimin e kujtesës kolektive”.³¹⁹

Politikanët dhe mediat lokale, me përjashtim të disave, nuk i mbulojnë profesionalisht vrasjet, rrëmbimet apo zhdukjet e civilëve joshqiptarë. Këto fakte zakonisht përmenden vetëm kur i referohemi Ligjit për Dhomat e Specializuara ose akuzave të ngritura nga Dhomat e Specializuara kundër ish-komandantëve të UÇK-së. Me fuqinë e tyre për ta formësuar diskursin publik dhe mënyrën se si Kosova e shikon të kaluarën, gazetarët në redaksitë anembanë Kosovës duhet të kishin inkurajuar debatin dhe mbulimin e çështjeve që lidhen me të kaluarën tonë kolektive – jo vetëm krimet e luftës, pasi që ato bëjnë pjesë në drejtësinë tranzicionale, por edhe tregimin e historive për jetën e vërtetë të personave të prekur nga lufta.

314 OSBE, 'Roli i medias në ngjarjet e marsit 2004 në Kosovë', 2004, <https://www.osce.org/files/f/documents/6/8/30265.pdf>

315 Po aty.

316 KosSev, 'Deputetët e Kosovës e akuzojnë ashpër veriun: serbët që kryen krime jetojnë në veri, ata janë fajtor për vdekjen e të rinjve nga Çabra në vitin 2004', 2.11.2020, i disponueshëm [këtu](#)

317 Andric-Rakic, Milica, 'Kthimi i personave të zhvendosur – Kolonializmi: Temat tabu në dialog', KosSev, 2.09.2020, i disponueshëm [këtu](#)

318 KosSev, 'Radio Kosova refuzon të transmetojë audio dramat për familjet serbe të të zhdukurve', 13.01.2021, i disponueshëm [këtu](#)

319 Po aty.



H.F. SIZANE

ZIMBERI

SILUPCAN 14.04.1976

SILUPCAN 24.05.2001

JENUZ

ZIMBERI

SILUPCAN 28.05.1976

SILUPCAN 27.05.2001

HAFIZI

1971

SILUPCAN 28.05.1976

SILUPCAN 27.05.2001



Sizane



Mersim



Selviqe



Hisniqe



Neale

Martirët e luftës - Familja ZIMBERI



Ftore



Nirimane



Valbona



Jenuz



Fitim

3. Republika e Maqedonisë së Veriut

3.1 Hyrje

Tridhjetë vite më parë, më 8 shtator 1991, Republika e atëhershme e Maqedonisë e shpalli pavarësinë dhe u shkëput në mënyrë paqësore nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, gjë që i bëri udhëheqësit maqedonas në atë kohë ta quajnë vendin me krenari 'oaza e paqes'.³²⁰ Në të njëjtën kohë, Preambula e Kushtetutës së shtetit që sapo kishte fituar pavarësinë, mes tjerash, parashihte në mënyrë të qartë Republikën e Maqedonisë³²¹ si "shtet kombëtar i popullit maqedonas, në të cilin shqiptarëve, turqve, vlllehëve, romëve dhe kombësive të tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut iu ofrohet barazi e plotë si qytetarë dhe bashkëjetesë e përvetshme me popullin maqedonas".³²² Tutje, me të parashihej gjuha maqedonase (duke përdorur alfabetin cirilik) si gjuha zyrtare e shtetit. E formuluar në këtë mënyrë, Kushtetuta u miratua pa konsensus të mirëfilltë ndër-etnik dhe pa mbështetjen e anëtarëve etnikë shqiptarë të Parlamentit të asaj kohe.³²³ Kjo më pas u përkthye në "zgjdhje të rrepta për gjuhën, arsimin e lartë dhe mënyrën e vendimmarrjes në Parlament", gjë që çoi në më shumë mosbesim në mesin e partive politike shqiptare,³²⁴ vazhdim të diskriminimit të shqiptarëve etnikë të cilin e kishin përjetuar gjatë periudhës jugosllave dhe, më e rëndësishmja, shkelje të të drejtave të komunitetit etnik shqiptar në shtetin e ri të pavarur. Pakicat e ndryshme etnike u ballafaquan me nivele të ndryshme të diskriminimit dhe shkelje të të drejtave të pakicave gjatë periudhës jugosllave dhe/ose pavarësisë së hershme. Në atë kontekst, komuniteti rom ishte mbase komuniteti që u diskriminua më së shumti në mënyrë sistematike, edhe pse kjo manifestohej bindshëm në një mënyrë tjetër nga diskriminimi dhe shkelja e të drejtave që i bëhej komunitetit etnik shqiptar, që ishte dhe vazhdon të jetë pakica më e madhe.

Mohimi sistematik që shteti iu bëri të drejtave të shqiptarëve etnikë, duke përfshirë mundësinë për t'u arsimuar në gjuhën e tyre amtare dhe për t'u përfshirë në institucionet shtetërore, i nxitur edhe nga zhvillimet në rajon dhe numri i incidenteve në vend, kontribuoi në konfliktin e armatosur të vitit 2001.³²⁵ Konflikti i armatosur³²⁶ mes forcave shtetërore të sigurisë, të përbëra nga shumica etnike maqedonase por që përfshinte

320 Karajkov, Risto (2004) "The Oasis of Peace," *Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa*, mund të gjendet në: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/North-Macedonia/The-Oasis-of-Peace-27557>.

321 Në tërë studimin, vendi përmendet si Republika e Maqedonisë ose Maqedonia (kur përmenden dinamikat dhe dokumentet e brendshme nga viti 1991 deri më 2019), ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (kur citohen dokumente nga organe ndërkombëtare që e njohën vendin me atë emër deri në vitin 2019) dhe Maqedonia e Veriut (për t'iu referuar ngjarjeve dhe zhvillimeve që nga ndryshimi i emrit zyrtar të shtetit në vitin 2019).

322 Parathënia e Kushtetutës së vitit 1991 e Republikës së Maqedonisë. Kombësitë e tjera, mes tjerash, përfshinin serbët etnikë. Nuk ka të dhëna të sakta demografike të përditësuar; të dhënat nga regjistrimi i ri i popullsisë priten në vitin 2022.

323 Shasivari, Jeton (2013) "The past and the present of the constitutional systems of the Republic of Macedonia in terms of the position of Albanians." *European Scientific Journal* 9(17): 190–206, 191.

324 Po aty..

325 Intervistë me Xhevdet Hajredinin, Ministër i Financave 1992–1994, Viber, 21 prill 2021. Interviewees: Elena Stavrevska.

326 Në studim, termi i përdorur për t'iu referuar ngjarjeve të vitit 2001 është konflikt i armatosur. Megjithatë, është e rëndësishme të ceket që të intervistuarit i kanë përdorur të dy termet – konflikt dhe luftë – ku pothuajse të gjithë shqiptarët etnikë e përdorin të fundit.

edhe shqiptarë³²⁷, romë dhe pakica të tjera, dhe grupi gueril i quajtur Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e përbërë nga shqiptarët etnikë, u zhvillua nga janari deri në gusht 2001 në Polog dhe në rajonin Statistikor të Verilindjes, si dhe afër kryeqytetit, Shkup. Ky konflikt i armatosur që zgjati tetë muaj rezultoi në më shumë se 171,000 persona të zhvendosur.³²⁸ Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) u nënshkrua nga presidenti i shtetit dhe përfaqësuesit e dy partive politike më të mëdha etnike maqedonase dhe dy partive më të mëdha etnike shqiptare, në praninë e ndërmjetësuese, përfaqësuesve të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara. MKO-ja përfshiu dispozita mbi ndërprerjen e luftimeve, çarmatosjen e plotë vullnetare të grupeve të armatosura shqiptare, zhvillimin e qeverisë së decentralizuar dhe garantimin e të drejtave politike dhe kulturore të pakicave.³²⁹ Poashtu, në të u përfshinë ndryshime kushtetuese që do t'i garantonin këto të drejta.³³⁰

Ndryshimet e prezantuara me MKO-në në kornizën kushtetuese, ligjore dhe institucionale të vendit në disa mënyra filluan procesin e drejtësisë tranzicionale në vend. Megjithatë, këto ndryshime nuk u përcollën nga përpjekje zyrtare shtetërore për t'i përcaktuar faktet e konfliktit të armatosur dhe për tu ballafaquar si shoqëri me të kaluarën, duke përfshirë periudhën para dhe gjatë vitit 2001. Kështu, përpjekjet parësore, sado të kufizuara që ishin, për tu ballafaquar me të kaluarën ose edhe për ta mbajtur konfliktin e armatosur të vitit 2001 në diskursin publik në çfarëdo mënyre, kanë ardhur nga pjesë të shoqërisë civile në vend. Mungesa e diskursit kombëtar rreth konfliktit të armatosur, e shoqëruar me mungesën e përfaqësimit të grupeve të organizuara të viktimave dhe viktimave në përgjithësi, ka çuar në padukshmëri të konsiderueshme të trashëgimisë së konfliktit të armatosur, duke dhënë përshtypje të gabuar të një kapitulli të mbyllur në historinë e vendit, ndërkohë që kjo trashëgimi ende ndikon dhe i formëson marrëdhëniet sociale mes grupeve të ndryshme etnike sot. Për shembull, shoqëria është ende jashtëzakonisht e polarizuar, pa debat publik rreth konfliktit dhe me narrativa shumë të fuqishme nacionaliste, pa hapësirë për pikëpamje të ndryshme. Poashtu, ekziston mosbesim i thellë mes maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë, që bartet nga gjenerata në gjeneratë dhe shpërthen gjatë krizave politike. Në të njëjtën kohë, përkujtesit e vetëm publikë të konfliktit të armatosur të vitit 2001 vijnë nga familjet e viktimave, grupet e veteranëve, disa komuna si dhe nga Aksioni Paqësor.

Brenda një konteksti të tillë ky studim përpiqet ta hartëzojë situatën aktuale, narrativat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të prekura nga konflikti i armatosur i vitit 2001. Studimi vazhdon duke dhënë fillimisht një përshkrim të metodologjisë së përdorur në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, pasuar nga një kapitull ku shqyrtohet situata dhe nevojat e viktimave dhe grupeve të tjera të prekura nga konflikti i armatosur. Në pjesën pasuese analizohen nismat zyrtare, si dhe disa jozyrtare, për tu ballafaquar me të kaluarën, duke përfshirë ligjet dhe politikat që kanë të bëjnë me viktimat dhe grupet e tjera të prekura nga konflikti i armatosur. Kapitulli i fundit shpalos diskursin e përgjithshëm kombëtar rreth konfliktit të armatosur të vitit 2001, apo thënë më mirë dinamikat që kanë kontribuar në mungesën e diskursit kombëtar rreth tij.

METODOLOGJIA

Hulumtimi për këtë studim të avancuar është zhvilluar në tri faza. Faza e parë ka përfshirë mbledhjen

327 Është e rëndësishme të përmendet se ka pasur raste kur shqiptarë etnik të cilët kanë qenë pjesë e Armatës së Republikës së Maqedonisë e që më pas janë bashkangjitur UÇK-së, siç është shembulli i Talat Xhaferit i cili në fillim të konfliktit të armatosur ka qenë oficer i lartë në ARM.

328 Këshilli Norvegjez për Refugjatët (2004) "Profile of Internal Displacement: Macedonia," në dispozicion [këtu](#), 7.

329 Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001), e disponueshme [këtu](#).

330 Po aty..

e të dhënave përmes rishikimit të nismave ekzistuese ose të mëparshme të ballafaqimit me të kaluarën, kornizave ligjore dhe politikave lidhur me konfliktin e armatosur të vitit 2001 dhe viktimat e grupet e tjera të prekura nga ai, historive gojore në formën e intervistave të publikuara me viktimat dhe veteranë të përzgjedhur, publikimeve nga mediat, si dhe hulumtimeve ekzistuese mbi këto tema. Materialet janë mbledhur në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Kjo fazë e hulumtimit konfirmoi mungesën e nismave dhe studimeve mbi çështjet e drejtësisë tranzicionale në vend, por ofroi poashtu një bazë të fuqishme për fazën e dytë.

Në fazën e dytë të mbledhjes së të dhënave, u realizuan intervista gjysmë të strukturuar dhe grupe fokusi me gjithsej 50 persona, në prill 2021. Këtu hynë 44 intervista dhe dy grupe fokusi, një me punonjës të organizatave joqeveritare dhe një me mësimdhënës të historisë, me nga tre pjesëmarrës në çdo grup fokusi. Të intervistuarit përfshinë viktimat civile, familjarët e tyre si dhe familjarë të viktimave ushtarake dhe shoqatat e veteranëve. Duke përdorur një qasje socio-ligjore të ndërtimit të identiteteve civile,³³¹ viktimat civile përfshinë persona që nuk kanë marrë pjesë në luftë që janë vrarë ose lënduar, ata që janë rrëmbyer ose zhdukur, refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV) dhe komunitetet lokale të prekura nga konflikti i armatosur. Më saktësisht, të intervistuarit përfshinë persona të zhvendosur, veteranë dhe përfaqësues të shoqatave të veteranëve, persona nga ish-zonat e konfliktit të armatosur (duke përfshirë të rinjtë nga ato zona), familjarë të viktimave civile, familjarë të viktimave ushtarake, mësimdhënës të historisë, aktivistë të paqes, persona që kanë punuar me grupe të ndryshme të viktimave përgjatë viteve dhe persona që kanë punuar në aktivitete të përqendruara në ballafaqimin me të kaluarën. Ata reflektuan mbi përjetimet e tyre, shpesh para, gjatë dhe pas konfliktit të armatosur dhe i ndanë pikëpamjet e tyre lidhur me situatën aktuale dhe të ardhmen. Intervistat dhe grupet e fokusit u realizuan në gjuhën maqedonase dhe shqipe (me ndihmën e një përkthyesi), varësisht nga preferencat e bashkëbiseduesve. Të gjitha intervistat dhe grupet e fokusit u mbajtën në mënyrë elektronike (përmes Zoom, Viber, Skype, Google Meet, Facebook dhe WhatsApp) për shkak të kufizimeve të lëvizjes dhe shqetësimeve etike lidhur me pandeminë e COVID-19.

Të intervistuarve iu dha mundësia për t'u përfshirë në studim në mënyrë anonime dhe përderisa disa e zgjedhën atë opsion, shumica e të intervistuarve dhe pjesëmarrësve të grupeve të fokusit e panë këtë si mundësi të rrallë që të përfshihet zëri i tyre dhe të merren parasysh njohuritë dhe përvoja e tyre, gjë që duket se e konfirmon nevojën për një proces formal i cili do ta mundësonte njohjen zyrtare të së kaluarës. Shumica e intervistave dhe grupeve të fokusit u organizuan nga ekipi i Aksionit Paqësor, i cili luajti një rol të rëndësishëm në ndërtimin e raporteve me të intervistuarit, përkundër distancës fizike dhe kohës së limituar. Shumica e personave të kontaktuar u pajtuan për intervistë, por megjithatë, kishte raste të atyre që refuzuan, qoftë për shkak të zhgënjimit me nismat e mëhershme të drejtësisë tranzicionale apo të pas konfliktit të armatosur, për shkak se nuk kishin kohë apo interesim. Për këtë arsye, sidomos duke pasur parasysh mungesën e grupeve formale të viktimave në Maqedoninë e Veriut, është me rëndësi të theksohet që ky studim i avancuar i ka kufizimet e veta pasi që nuk mund t'i paraqesë pikëpamjet e viktimave të caktuara (siç janë familjet e viktimave civile përveç familjes Zymberi ose të familjeve të personave të kidnapuar ose të zhdukur, për shembull, të cilët nuk mund të kontaktoheshin ose nuk ishin të interesuar për t'u intervistuar). Njëkohësisht, në shumë kategori të personave të intervistuar u arrit mbledhja e nevojshme e të dhënave, kur edhe u paraqitën format e ndryshme në përgjigje në fund të kësaj faze të studimit.

Faza e tretë u përqendrua në analizimin e të dhënave dhe interpretimin e gjetjeve. Të dhënat nga

331 Garbett, Claire (2015) *The Concept of the Civilian: Legal Recognition, Adjudication and the Trials of International Criminal Justice*. Mbretëri e Bashkuar: Taylor & Francis.

intervistat, politikat dhe dokumentet ligjore, deklaratat zyrtare, si dhe të dhënat e tjera dytësore kaluan nëpër analizë të diskutit. Përpilimi i gjetjeve u bë në një mënyrë që i trajton denjësisht përvojat e përbashkëta dhe është e dobishme për punën e ardhshme në ballafaqimin me të kaluarën në Maqedoninë e Veriut. Në këtë fazë, ishte e rëndësishme të kthehemi tek të dhënat e dorës së parë dhe të analizohet me kujdes çfarë është thënë si dhe të analizohen meta të dhënat.³³² Disa prej intervistave u përdorën në radhë të parë për ta kuptuar kontekstin dhe nuancat e tij. Në analizën e paraqitur këtu kombinohen fjalët e bashkëbiseduesve me interpretimin e hulumtueses për të siguruar që historitë e ndara përçohen në një mënyrë që i paraqet më së miri pikëpamjet dhe përvojat e bashkëbiseduesve.

3.2 Situata dhe nevojat e viktimave dhe grupeve të tjera të prekura nga konflikti i armatosur i vitit 2001

Marrë parasysh mungesën e grupeve formale dhe madje edhe atyre joformale të viktimave në vend, ky kapitull përqendrohet në grupe të ndryshme të viktimave dhe personave të prekur nga konflikti i armatosur, të cilët mund të identifikohen në kontekstin aktual. Në shumicën e rasteve, është përmendur çështja e mungesës së të dhënave të sakta mbi situatën dhe nevojat e grupeve të ndryshme, që është e kuptueshme duke pasur parasysh mungesën e të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë në periudhën kur u bë ky hulumtim, organet zyrtare që përqendrohen dhe punojnë me këto grupe dhe/ose shoqatat formale/joformale. Për këtë arsye, ky kapitull ndahet në gjashtë pjesë, për ta analizuar situatën e PZhBV-së, familjeve të të rrëmbyerve dhe të zhvendosurve, familjeve të viktimave civile, familjeve të viktimave ushtarake, grupeve të veteranëve dhe personave që jetojnë në ish-zonat e konfliktit të armatosur.

PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT

Konflikti i armatosur i vitit 2001 vlerësohet ta ketë shkaktuar zhvendosjen e më shumë se 170,000 personave.³³³ Prej tyre, sipas shifrave nga shtatori 2001, 76,054 konsideroheshin persona të zhvendosur brenda vendit (PZhBV), ndërsa 3,228 prej tyre u strehuan në qendra kolektive në vend.³³⁴ PZhBV-të, duke përfshirë persona të kombësive të ndryshme, u larguan nga të tri rajonet ku po zhvillohej konflikti i armatosur. Disa u larguan në Kosovë, gjë që e ndryshoi statusin e tyre në refugjatë, ndërsa shumica e PZhBV-ve qëndruan me familjet pritëse (kryesisht të afërm dhe miq) në pjesë të ndryshme të vendit. Sigurisht, jo të gjithë ata që u larguan iu drejtuan autoriteteve për ta marrë statusin e PZhBV-së. Kështu ndodhi veçanërisht mes shqiptarëve etnikë, ku në disa raste shqiptarëve etnikë nuk iu dha një status i tillë edhe pse kishin aplikuar për të. Lidhur me këtë, shifrat e numrit të PZHBV-ve, si dhe ndarja e përbërjes etnike ndryshojnë jo vetëm nga koha, por edhe nga burimet që i referohen së njëjtës periudhë.³³⁵

Marrëveshja Kornizë e Ohrit përfshinte dispozita për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur, duke përfshirë rehabilitimin dhe rindërtimin e zonave të prekura nga luftimet. Të gjitha palët ishin pajtuar “të punojnë për të siguruar kthimin e refugjatëve të cilët [ishin] qytetarë ose banorë ligjorë të Maqedonisë së Veriut dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre brenda afatit më të shkurtër kohor”.³³⁶ Sipas Zyrës së OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare, mbi 95 përqind

332 Fujii, Lee Ann (2010) “Shades of Truth and Lies: Interpreting Testimonies of War and Violence.” *Journal of Peace Research* 47(2): 231–41.

333 Këshilli Norvegjez i Refugjatëve, op cit., 7.

334 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2016) “Tomovski v. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,” e disponueshme [këtu](#).

335 Këshilli Norvegjez i Refugjatëve, op cit., 42.

336 Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001) Shtojca C, 3.1, në dispozicion [këtu](#).

e atyre që u çrrënjësën gjatë periudhës së konfliktit të armatosur, mund ta bënin këtë, pra mund të ktheheshin deri në fund të vitit 2002.³³⁷ Megjithatë, analizimi i më hollësishëm i kësaj mundësie për t'u kthyer edhe në periudhat e mëtejshme zbulon një realitet tjetër. Me të dhënat e regjistrimit të popullsisë që janë pothuajse dy dekada të vjetra, numrat e saktë mbeten të panjohur, por dëshmitë anekdotale tregojnë se shumë prej atyre që UNOCHA konsideronte se mund të ktheheshin, kryesisht maqedonasit etnikë dhe serbët etnikë, por jo vetëm, ose nuk kthyen ose u kthyen përkohësisht dhe eventualisht i shitën shtëpitë e tyre para se të largoheshin. Në Tearcë, për shembull, disa persona nuk u kthyen sepse shtëpitë e tyre ishin dëmtuar ose për shkak të shqetësimeve lidhur me sigurinë e tyre.³³⁸ Në Opajë në vitin 2003, u plaçkitën dhe u thyen 46 shtëpi të rindërtuara. Kjo ndodhi përsëri pas rindërtimit të dytë disa vite më vonë.³³⁹ Kush u kthye e kush jo dallon nga vendi në vend, varësisht nga dinamikat ndër-etnike pas konfliktit të armatosur. *"Pothuajse të gjithë u kthyen në fshat, por fqinjët tanë – fqinjët tanë maqedonas, e që kemi pasur shumë – nuk u kthyen. Nuk i kemi parë më kurrë"* – tha një e intervistuar e cila si fëmijë ishte zhvendosur nga Opaja.³⁴⁰

Historitë nga Haraçina janë të ngjashme. Duke folur për kthimin e gjyshërve të tij, të cilët kishin jetuar me vite në një qendër kolektive, një i intervistuar tha: "Gjyshërit e mi donin të ktheheshin dhe u kthyen, por nuk ishin plotësisht të sigurtë për këtë ide. E kanë parë shtëpinë para se të riparohej, duke parë nga cila anë ishin përdorur armët... Në njëfarë mënyre, besonin se shtëpia e tyre ishte sulmuar. Ishin të pashpresë, donin të ktheheshin dhe nuk e dinin se ku tjetër mund të shkonin. Eventualisht, e shitën shtëpinë dhe u larguan për shkak se frika dhe pasiguria nuk u larguan kurrë."³⁴¹ Një i intervistuar tjetër, ish-PZhBV nga Haraçina që jetoi dhjetë vite në një qendër kolektive, reflekton ngjashëm lidhur me përvojën e familjes së tij/saj: "Donim të ktheheshim, por në ndërkohë ndodhnin incidente. Për shembull, edhe pse shtëpia jonë u dëmtua shumë pak gjatë konfliktit të armatosur, në vitin 2008-2009 shtëpia u dogj. Edhe shumë shtëpi të tjera u dëmtuan. Incidentet si këto bënë që shumë prej atyre që fillimisht donin të ktheheshin ta ndërrojnë mendjen. Prandaj, në fund e shitëm shtëpinë tonë dhe nuk u kthyem. Në fakt, shumica e shtëpive janë shitur që nga konflikti i armatosur. Aktualisht, nuk është asnjë familje etnike maqedonase në Haraçinë, e fundit u largua disa vite më parë. Për ta qartësuar, ka edhe shumë familje shqiptare nga Haraçina që nuk u kthyen kurrë."³⁴² Ndërkohë që në grup hollësitë individuale dallojnë, nga shtëpitë e djegura dhe të shembura pas konfliktit të armatosur deri tek vrasja e një të rikthyeri nga një granatë, një e përbashkët që del në pah është që mungesa e sigurisë dhe shtëpitë e dëmtuara janë dy pengesat më të zakonshme për tu kthyer.³⁴³

Në vitet e para pas konfliktit të armatosur, me ndihmën e donatorëve të huaj, PZhBV-ve iu ofrua mundësia e renovimit të shtëpive të tyre dhe kthimit në shtëpi. Por nëse do të pranonin, do ta humbnin statusin e PZhBV, mundësinë e paditjes së shtetit dhe, në mënyrë kritike, u desh të ktheheshin në shtëpitë e tyre pavarësisht frikës dhe shqetësimeve për sigurinë e tyre.³⁴⁴ Ata që pritën që gjykata të vendoste për dëmshpërblim në rastet e tyre qëndruan në qendra kolektive për një dekadë e në disa raste edhe më

337 Zyra e OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (2002), "Prioritetet Humanitare për vitin 2003 në IRFJ," 31 dhjetor, në dispozicionin [këtu](#).

338 Intervistë me Metin Muaremin, Zoom, 6 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

339 Koment nga Boro Kitanoski, Aksioni Paqësor, 5 gusht 2021.

340 Intervistë me një ish-banor të Opajës, Zoom, 16 prill 2021.

341 Intervistë me një ish-banor të Haraçinës, Zoom, 26 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

342 Intervistë me një ish-banor të Haraçinës dhe PZhBV, Viber, 7 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

343 Këshilli Norvegjez i Refugjatëve, op cit., 72.

344 Intervistë me një ish-banor të Haraçinës dhe PZhBV.

gjatë. Disa prova sugjerojnë, për shembull, që personi i fundit i zhvendosur brenda vendit nga Haraçina u largua nga qendra kolektive vonë në vitin 2013.³⁴⁵ Në gusht të vitit 2001, PZhBV-të nga Haraçina që jetonin në gjashtë qendra kolektive formuan një shoqatë të quajtur *Agimi (Zora)*.³⁴⁶ Rreth 80 prej këtyre familjeve e dërguan shtetin në gjyq në vitin 2003 për dëme materiale dhe jo-materiale të pësura si rezultat i konfliktit të armatosur të vitit 2001.³⁴⁷ Padia e tyre për dëme për stres, cenim të nderit dhe aftësi të zvogëluar për jetesë u refuzua në vitin 2011,³⁴⁸ ndërsa paditë e tyre për dëme materiale u zgjidhën në vitin 2013. Deri vonë në mars të vitit 2012, rreth 250 persona nga Haraçina dhe rreth 500 nga ish-rajonet e tjera të konfliktit të armatosur jetonin në qendrat kolektive, pa një vend të sigurt ku mund të ktheheshin.³⁴⁹ *Agimi* pushoi së ekzistuari kur u mbyll procesi për paditë e fundit.

Fshatrat Haraçinë, Radushë dhe Mateç e kanë numrin më të vogël të personave të kthyer.³⁵⁰ Në rastin e Radushës, në korrik të vitit 2019 ishte një numër i madh prej 26 familjesh që ishin ende të zhvendosura brenda vendit.³⁵¹ Këtyre familjeve iu kishin thënë që mund të aplikonin për strehim social, por kishin frikë se do të klasifikoheshin si përfitues të asistencës për mirëqenie sociale dhe kështu do ta humbnin statusin e tyre të PZhBV.³⁵² Ata frikësoheshin se do të shtoheshin në listën e gjatë të personave që prisnin për t'iu dhënë një banesë, të cilën nuk do të kishin mjete të mjaftueshme për ta mobiluar dhe që kjo do t'ia mundësonte qeverisë të deklaronte që më në fund e kishte zgjidhur çështjen e personave të zhvendosur brenda vendit.³⁵³

Sa i përket Mateçit, PZhBV-të jetonin në dy hotele të shndërruara në qendra kolektive në Kumanovë, Kristal dhe Ku-ba. Dy hotelet poashtu strehonin PZhBV-të nga fshatrat Ropalcë dhe Opajë. Ata e paditën shtetin për kompensim për frikën që e kishin përjetuar, për përkeqësimin e shëndetit të tyre mendor dhe fizik dhe për tokën e shtëpitë që iu dëmtuan në konfliktin e armatosur. PZhBV-të, që përfshinin serbë etnikë dhe maqedonas etnikë, në fund e nënshkruan një marrëveshje me qeverinë për t'i tërhequr paditë e tyre dhe që shteti t'i kompensonte.³⁵⁴ Shumica morën kompensim dhe në vitin 2010 u vendosën, kryesisht në Kumanovë.³⁵⁵ Në disa raste, grupet e familjeve blenë ose ndërtojnë shtëpi afër njëra-tjetrës në Kumanovë, pasi që kishin nevojë për mbështetje dhe për të qenë afër njëri-tjetrit.³⁵⁶

Kur u pyetën nëse gjyshërit e tyre të zhvendosur brenda vendit e shohin veten si viktimë, një i/e intervistuar u përgjigj: "E shohin veten si viktimë. Gjithmonë. Historitë e tyre janë tipike. 'Ne iu kemi dhënë gjithçka, ata na kanë marrë gjithçka', që ndoshta tingëllon e vërtetë për personat që janë

345 Po aty..

346 Shoqata e PZhBV-ve nga Haraçina *Agimi*, 'Për ne', në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

347 Po aty..

348 Makfax (2011), "PZhBV-të nga Haraçina i kërkohet Gjykatës Supreme të mos ua marrë paratë," 8 qershor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

349 Telma TV (2012) "Të pastrehë nëntë vite pas Marrëveshjes së Ohrit," *Platforma Maqedonase kundër Varfërisë*, 22 mars, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

350 Nakovski, Martin (2015) "Integrimi dhe/ose riintegrimi i personave të zhvendosur brenda vendit në konfliktin e 2001-tës në Republikën e Maqedonisë,"

EthnoAnthroZoom Nr. 14, e disponueshme [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

351 Topalova, Katerina (2019) "Familjet e konfliktit në Maqedoninë e Veriut ende presin për shtëpi," *BIRN Skopje*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

352 Po aty..

353 Po aty..

354 Antikj Jovčevska, Svetlana (2010) "Të zhvendosurit po largohen nga qendrat kolektive," *Radio Evropa e Lirë*, 1 shtator, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

355 KumanovoNews (2010) "Të zhvendosurit e vizitojnë 'Mala Bogorodica' në Mateç," 20 shtator, Në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte]; Antikj

Jovčevska, Svetlana (2012) "Martina është rritur, por ende nuk e ka parë Mateçin," *Radio Evropa e Lirë*, 11 mars, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

356 Intervistë me Divna Jankova, psikoterapiste, kishte punuar paraprakisht me PZhBV-të në Kumanovë, Zoom, 19 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska

detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre. Por kjo nuk është e vërteta kolektive, sidomos pasi që askush nuk lodhet për t'i kuptuar rrënjët e gjithë kësaj, arsyet që çuan në atë situatë. Pra, ishin viktimat, por viktimat të situatës në të cilën ndodheshin dhe të sistemit që lejoi t'iu ndodhte kjo.”³⁵⁷

Sa iu përket nevojave të ish-PZhBV-ve dhe PZhBV-ve të mbetur, nga këndvështrimi i cilësdo formë të përfaqësimit, është kritike të hartëzohen lokacionet e tyre, statusi i tyre aktual dhe nevojat e tyre. Tani për tani, ata nuk përfaqësohen nga askush dhe përvojat e tyre janë të padukshme në sferën publike. Këto dy aspekte janë të ndërlidhura. Siç thotë një ish-PZhBV: “Është e rëndësishme të informohet publiku për atë që ka ndodhur sepse në shumë mënyra kjo çështje është harruar. Por nuk duhet të harrohet. Dhe nuk duhet të ndodhë përsëri. Njerëzit duhet të dëgjojnë për përvojat e PZhBV-ve [...] Pavarësisht zgjedhjeve që i kanë bërë – a janë kthyer, a i kanë shitur shtëpitë e tyre apo janë shpërngulur diku tjetër – ata kanë filluar nga zero. Poashtu, njerëzit duhet të inkurajohen për t'i ndarë përvojat e tyre. Këtu hyjnë njerëzit e të gjitha etnive. Shumë shpesh përpara, madje edhe sot, jemi stigmatizuar nga pjesa tjetër e popullsisë dhe jemi gjykuar nga njerëzit që nuk e kishin përjetuar të njëjtën gjë se kinse nuk kemi luftuar sa duhet, se kemi lejuar që vendi të shndërrohet në atë që është sot. Nga ana jonë, mendojmë se shteti nuk na ka mbrojtur sa duhet në atë kohë. Por e gjithë kjo është harruar. Situata do të kishte qenë shumë më ndryshe sikur t'i kishte përfaqësuar dikush PZhBV-të, edhe pas përmbylljes së rasteve në gjykatë. Është shumë ndryshe kur një përfaqësues ose një organizatë e përfaqëson grupin, ka ndikim shumë më të madh në krahasim me atë që mund të arrihet individualisht.”³⁵⁸

Shumë PZhBV vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi materiale dhe e kanë të vështirë të gjejnë punë, prandaj u theksua edhe nevoja për ndihmë në atë proces.³⁵⁹ Përveç kësaj, u theksua fuqishëm nevoja për ndihmë psikologjike, në të cilën ishin të pranishme edhe elementi i gjinisë dhe ndikimi ndër breza. Divna Jankova, psikoterapiste që punonte për një vit e gjysmë me disa prej PZhBV-ve në Kumanovë menjëherë pas konfliktit të armatosur reflektoi se si fillimisht ishin kryesisht gratë ato që merrnin pjesë në seanca, duke dashur jo vetëm ta procesonin përvojën e tyre, por edhe të gjenin mënyra për t'iu ndihmuar fëmijëve të tyre për t'u përshtatur.³⁶⁰ Ajo po ashtu theksoi nevojën për mbështetje psikologjike që duhet t'iu ofrohet fëmijëve të PZhBV-ve të cilët janë rritur që atëherë, por shumica e tyre vazhdojnë të mbajnë “pikëllim të pazgjidhur”, i cili manifestohet në forma të ndryshme.³⁶¹ Çështja e pikëllimit të pazgjidhur, edhe nëse nuk u quajt kështu, u paraqit në disa prej intervistave të tjera. “Gjyshërit kishin nevojë për ndihmë psikologjike, kishin nevojë t'iu njihej statusi i tyre si viktimat të sistemit të kaluar dhe pak mbështetje për të krijuar rrjete dhe komunitete të solidaritetit ku do të mund të flisnin për përvojat e tyre. Nëse do t'i pyesnit se çfarë mund të bëni për t'iu ndihmuar, me siguri e vetmja gjë që do të thonin do të ishte ta kthenit kohën pas. Në qendrën kolektive kanë jetuar në një dhomë të vetme dhe gjithçka ndodhej aty, ndërsa përpara kanë jetuar në një shtëpi trekateshe me një oborr të madh. Gjyshja ime e kalonte kohën si amvise, duke u kujdesur për shtëpinë dhe duke u vizituar nga nipat e mbesat atje. Pastaj u detyrua të jetonte në një dhomë. Në anën tjetër, praktika e gjyshit tim për ta kaluar kohën jashtë shtëpisë vazhdoi kur u shpërngulën, edhe pse ndryshimi ishte shumë i rëndë edhe për të. Kjo e ktheu mbrapsht jetën e tyre por ata vuajtën në një mënyrë shumë ndryshe.”³⁶²

357 Intervistë me një ish-banor/e të Haraçinës.

358 Intervistë me një ish-banor/e të Haraçinës dhe PZhBV.

359 Po aty..

360 Intervistë me Divna Jankova.

361 Po aty..

362 Intervistë me një ish-banor/e të Haraçinës.

Tutje, rekomandimi afatgjatë për të punuar me këtë grup të viktimave është të hartëzohen dhe të bashkohen ata që identifikohen si PZhBV, si dhe fëmijët e PZhBV-ve ose gjenerata e dytë. Kështu do të ofrohej hapësirë që ata të krijojnë lidhje por edhe mundësisht ta gjejnë një mënyrë për t'u përfaqësuar dhe për të avokuar për të drejtat e tyre. Një rekomandim tjetër është të punohet me gjeneratën e dytë në mënyrë specifike për të krijuar dialog me PZhBV-të e tjerë. Poashtu, pasi që gjenerata e vjetër e PZhBV-ve po vdes, është më e rëndësishme se kurrë të mblidhen historitë gojore të PZhBV-ve nga pjesët e ndryshme të vendit dhe të bëhen të dukshme përvojat e tyre (përmes publikimit të një libri ose përmes një mediumi tjetër) si mënyrë e luftimit të disa stigmave sociale ekzistuese dhe ruajtjes së njohurive nga viti 2001.

FAMILJET E TË RRËMBYERVE DHE TË ZHDUKURVE

Kur u nënshkrua MKO-ja në gusht të vitit 2001, 20 persona konsideroheshin të rrëmbyer dhe të zhdukur, duke përfshirë 12 meshkuj maqedonas dhe gjashtë meshkuj shqiptarë. Në periudhën korrik-gusht 2001, 12 meshkuj maqedonas pretendoheshin se ishin rrëmbyer nga anëtarët e UÇK-së në rajonin e Tetovës, ose nga shtëpitë e tyre në Tetovë dhe në fshatrat fqinje ose derisa po punonin në fusha.³⁶³ Në tetor të atij viti, policia lëshoi një deklaratë që 12 meshkuj ishin vrarë dhe trupat e tyre ishin varrosur në tri varre masive afër Tetovës.³⁶⁴ Megjithatë, kur ekipet që po bënin zhvarrosjen e trupave dhe po kryenin hetime në varre u sulmuan me armë zjarri dhe tre zyrtarë policorë u vranë, operacioni u pezullua përkohësisht pas gjetjes së mbetjeve të para mortore.³⁶⁵ Ato mbetje mortore u identifikua se iu takonin katër prej 12 meshkujve të rrëmbyer. Operacioni për zhvarrosjen e tetë trupave të tjerë nuk vazhdoi më kurrë siç duhet. Me vite të tëra familjet e katër meshkujve të identifikuar refuzuan t'i merrnin mbetjet mortore dhe t'i varrosnin ato pasi që disa nuk besonin në rezultatet e analizave ndërsa të tjerët refuzonin për shkak se ishin gjetur vetëm mbetjet e pjesërisht mortore. Dy prej tyre u varrosën më në fund në vitin 2018.³⁶⁶ Gjykata e Tetovës i shpalli zyrtarisht të gjithë 12 meshkujt të vdekur në vitin 2005, duke i dhënë secilës familje një kompensim në shumën mes €10,000 dhe €20,000.³⁶⁷

Familjet e atyre që u rrëmbyen kanë kërkuar përgjigje dhe që dikush të merrte përgjegjësi për dy dekada, por pa sukses. Dy raste gjyqësore janë zhvilluar për meshkujt e rrëmbyer maqedonas. Në rastin civil, shteti është urdhëruar të paguajë dëmshpërblime për rrezikimin e jetës përmes dështimit për ta parandaluar terrorizmin, që iu paguan të afërmve në vitin 2005.³⁶⁸ Procedura penale për krime lufte ndaj civilëve u ngritën edhe për rrëmbimin e 12 civilëve në periudhën korrik-gusht 2001 në rajonin e Tetovës (i njohur edhe si rasti i Nepreshtenit) dhe ndaj tërë udhëheqësisë së UÇK-së për kryerjen e dhjetëra krimeve të luftës në parimin e përgjegjësisë komanduese. Të dy rastet u mbyllën pasi Parlamenti e miratoi interpretimin autentik të nenit 1 të Ligjit për Amnisti në vitin 2011.³⁶⁹

Në vitin 2014, në Nepreshten, afër Tetovës u hap një park memorial me një monument në nderim të katër burrave të rrëmbyer nga fshati. Sipas ish-kryetarit të Shpresës (*Nadež*), shoqata e themeluar zyrtarisht në vitin 2003 për t'i përfaqësuar familjet e të rrëmbyerve në vitin 2001, monumenti është

³⁶³ Andonov, Zoran (2019a) "18 vite më pas," *Balkan Perspectives* 12, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

³⁶⁴ Dimovski, Sase (2012) "Familjet e maqedonasve të rrëmbyer kërkojnë një marrëveshje përfundimtare," *BIRN Skopje*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

³⁶⁵ Po aty..

³⁶⁶ Andonov, op cit.

³⁶⁷ Dimovski, op cit.

³⁶⁸ Andonov, op cit.

³⁶⁹ Po aty..

një vend ku familjet mund t'i kujtojnë të dashurit e tyre dhe të nderojnë qirinj pasi që nuk ka varre.³⁷⁰ Një ish-anëtar i *Shpresës* tha që familjet e të rrëmbyerve kanë vepruar gjithmonë së bashku por pasi që shumë familjeve iu ofruan punësime [me gjasë nga ata në pushtet], u distancuan nga shoqata.³⁷¹ Shoqata aktualisht figuron si joaktive në Regjistrin Qendror.³⁷²

Komisioni për Personat e Rrëmbyer dhe të Zhdukur, i themeluar nën kujdesin e Bashkimit Evropian në nëntor 2001, i shqyrtoi rastet e një numri personash të zhdukur, duke përfshirë gjashtë burra shqiptarë. Mes periudhës 17 prill dhe 20 gusht 2001, tre shqiptarë etnikë u zhdukën në pjesë të ndryshme të vendit pasi që policia i bastisi shtëpitë e tyre ose i ndaloj veturat e tyre në pika kontrolli. Sipas Amnesty International, "edhe pse faktet e rrethanave lidhur me mënyrën se si u zhdukën burrat mbetet të qartësohen, ka bazë për të dyshuar për bashkëfajësi të zyrtarëve".³⁷³ Mbetjet e tre burrave u gjetën në vitin 2004, dy në një varr masiv dhe një në një lokacion tjetër.³⁷⁴ Tre burra të tjerë shqiptarë u zhdukën në të njëjtën periudhë, por nuk ka informata të mjaftueshme lidhur me rrethanat e zhdukjes së tyre dhe mbesin të zhdukur edhe sot e kësaj dite.

Pas konfliktit të armatosur, familjet e burrave shqiptarë të zhdukur i bashkuan forcat me familjet e burrave maqedonas të zhdukur në kërkim të së vërtetës dhe drejtësisë, por së shpejti, "për arsye të paqarta, u tërhoqën plotësisht dhe e ndërprejnë bashkëpunimin e mëparshëm, nuk iu drejtuan më institucioneve dhe mbetën të paarritshëm për bisedë".³⁷⁵ Asnjë intervistë nuk është realizuar me asnjë familjar të meshkujve të rrëmbyer dhe/ose të zhdukur për këtë studim për shkak të mungesës së qasjes. Prandaj, nevojat e tyre mbesin të panjohura, por çdo përkrahim i njerëzve të prekur nga konflikti i armatosur do të ishte i gabuar pa i përmendur ata.

Publiku duket se e ka harruar në masë të madhe situatën e familjeve të të rrëmbyerve dhe të zhdukurve, edhe pse asnjëherë nuk kanë marrë drejtësi në asnjë formë dhe disa prej tyre ende nuk i kanë gjetur të dashurit e tyre. Rekomandimi sa i përket këtij grupi është të bëhen përpjekje për të krijuar kontakt me familjet e të gjithë të rrëmbyerve dhe të zhdukurve, si të maqedonasve etnikë dhe ashtu edhe të shqiptarëve etnikë, në përpjekje për t'i kuptuar nevojat e tyre dhe pastaj për të punuar mundësisht në aktivitete që mund t'i bashkojnë ata për të avokuar më mirë për plotësimin e nevojave të tyre.

FAMILJET E VIKTIMAVE CIVILE

Kjo pjesë e hulumtimit përqendrohet në mënyrë specifike në familjet e viktimave civile, që përkufizohen si jo-luftëtarë të vrarë ose të plagosur gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001. Numri i saktë i të vrarëve ose të plagosurve mbetet i panjohur. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, UÇK-ja thuhet t'i ketë vrarë dhjetë civilë, por numri i civilëve të vrarë ose të plagosur nga forcat shtetërore të sigurisë mbetet i panjohur.³⁷⁶ Dhjetë anëtarë të familjes Zymeri, duke përfshirë fëmijët, u vranë gjatë bombardimit të

370 Nova TV (2014) "Neprošteno afër Tetovës: Një park memorial është hapur në nderim të personave të rrëmbyerve në vitin 2001," 24 korrik, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

371 Dimovski, op cit.

372 Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2021), "Shoqata Shpresa Tetovë," në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

373 Amnesty International (2003) "Where are they now? Their families need to know! Alleged "disappearances" and abductions in 2001," në dispozicion [këtu](#).

374 Blazevska, Katerina (2015) "'Bomba' i hapi plagët për 12 maqedonasit e rrëmbyer," *DW*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

375 Andonov, op cit.

376 Marusic, Sinisa Jakov (2021) "Pasojat e konfliktit në Maqedoninë e Veriut ndihen edhe pas dymbëdhjetë vitesh", *BIRN Skopje*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

fshatit Sllupçan (Komuna e Likovës) nga ushtria në maj të vitit 2001.³⁷⁷ Human Rights Watch raportoi që dhjetë civilë të tjerë, duke përfshirë një fëmijë, u vranë gjatë operacionit policor nga 10-12 gusht 2001 në fshatin Luboten (afër Shkupit).³⁷⁸ Për këtë rast, Zyra e Prokurorit në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi (TPNJ) hapi një hetim kundër ish-Ministrit të Punëve të Brendshme, Ljube Boškoski, dhe kundër një zyrtari policor që vepronte si inspektor shoqërues në njësinë e sigurisë së presidentit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Johan Tarčulovski.³⁷⁹ Në vitin 2008, Gjykata e liri Boškoski-n dhe e dënoi Tarčulovski-n me 12 vite burgim, që u konfirmua nga Gjykata e Apelit, për “shkeljen e ligjeve ose rregullave të luftës për vrasje, shkatërrim të paarsyeshëm dhe trajtim mizor”.³⁸⁰ Pasi e kaloi dy të tretën e dënimit në burg, Tarčulovski u lirua nga burgu dhe u kthye në vend në vitin 2013.³⁸¹ Pas disa vitesh, në vitin 2016, ai u zgjodh deputet i Parlamentit për partinë VMRO-DPMNE.³⁸²

Sipas Verime Zymberit, e cila ishte e pranishme por i mbijetoi bombardimit që vrau dhjetë anëtarë të familjes së saj, me sa është e informuar nuk ka nisma ose shoqata të themeluara nga ose për familjet e viktimave civile.³⁸³ Ajo thotë që në Tetovë kanë qenë rreth dhjetë viktima civile, dhjetë në Luboten dhe dhjetë në Sllupçan, por ajo nuk i ka takuar kurrë familjet e viktimave të tjera civile.³⁸⁴ Verimja thekson se iu kanë ndihmuar ushtarët e UÇK-së gjatë konfliktit të armatosur, por që atëherë viktimat civile janë harruar dhe as që i kanë përmendur që nga viti 2002: “Vëmendja ka qenë në veteranët e luftës dhe në viktimat ushtarake, por askush nuk i kujton civilët”.³⁸⁵

Abedin Zymberi, një anëtar tjetër i familjes së njëjtë, ish-komandant i policisë ushtarake të UÇK-së për rajonin e Karadakut dhe ish-deputet, reflektoi për situatën aktuale të familjeve të viktimave civile shqiptare: “Nuk kam pasur kontakt të drejtpërdrejt me familjet e tjera shqiptare të viktimave civile, edhe pse në mënyrë indirekte njëherë e kam filluar një nismë për t’i regjistruar të gjitha familjet dhe nevojat e tyre dhe çfarë mund të bëj për ta. Janë përkujdesur për disa prej tyre, disa janë pjesë e një partie politike, prandaj nevojat e tyre janë plotësuar përmes asaj rruge. Por ata që nuk kanë lidhje mbetën të harruar dhe në një pozitë shumë të vështirë. Po flas për rajonin e Likovës. Në Tetovë, për shembull, komuna është kujdesur për ta – disa janë punësuar, disa kanë gjetur strehim, etj. Por këtu, mund të them që 60 përqind e tyre janë në gjendje të vështirë.”³⁸⁶

Në prill të vitit 2010, një grup i deputetëve i udhëhequr nga Abedin Zymberi dhe Daut Rexhepi e propozuan një Ligj për të Drejtat e veçanta të anëtarëve invalidë të UÇK-së, familjarëve të viktimave civile dhe familjarëve të luftëtarëve të UÇK-së të rënë gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001.³⁸⁷ Në mënyrë kritike, për dallim prej të ashtuquajturit Ligji për Veteranë, i përshkruar në një kapitull më

377 Filipovska, Slavica (2017) “Lufta nuk është kurrë opion,” *360 Stepni*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

378 Human Rights Watch (2001) “Crimes Against Civilians: Abuses by Macedonian Forces in Ljuboten, August 10–12, 2001,” në dispozicion [këtu](#).

379 Qendra Burimore e Drejtësisë Ndërkombëtare (2021) “Boškoski & Tarčulovski (IT-04-82),” në dispozicion [këtu](#).

380 Po aty..

381 MIA (2013) “Tarčulovski was released from prison,” *DW*, 10 April, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

382 Andonovska, Elena (2016) “Tarčulovski, i dënuar për krime lufte, bëhet deputet,” *BIRN Skopje*, 19 dhjetor, në dispozicion [here](#) [origjinali në maqedonishte].

383 Intervistë me Verime Zymberi, WhatsApp, 10 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

384 Po aty..

385 Po aty..

386 Intervistë me Abedin Zymberi, Viber, 14 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

387 Krzhalovski, Aleksandar (2012) “Ligji për veteranë: pasqyrë e shkurtër e politikave të riintegrit,” *Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte], 5.

poshtë, në propozim u përfshinë dispozita për civilët e vrarë. Megjithatë, pas një debati në qershor të vitit 2010, në të cilin nga 89 deputetë sa ishin të pranishëm (nga 120 sa janë gjithsej), 61 votuan – 11 pro dhe 50 kundër,³⁸⁸ Parlamenti nuk e miratoi propozimin.³⁸⁹ Përderisa të gjithë deputetët që ishin pro propozimit ishin shqiptarë, jo të gjithë deputetët shqiptarë e mbështetën propozimin apo ishin të pranishëm gjatë debatit.³⁹⁰ Edhe sot e kësaj dite, të drejtat e viktimave civile të konfliktit të armatosur të vitit 2001 mbesin të panjohura në sistemin ligjor maqedonas, edhe pse një anketë në vitin 2012 tregoi që 83 përqind e të gjitha grupeve etnike i përkrahnin dispozitat ligjore për të drejtat e viktimave civile, pavarësisht kombësisë.³⁹¹

Nevojat e familjeve të viktimave civile janë të shumta. Ato që u theksuan më së shumti gjatë intervistave përfshinë njohjen e humbjeve të përjetuara nga familjet, dukshmërinë e çështjes dhe mbështetjen ligjore, materiale dhe psikologjike. Siç shpjegon Verime Zymberi: “Familjet janë të zhgënjyera, pa marrë parasysh se sa anëtarë i kanë humbur. Për shembull, kushëriri im e ka humbur bashkëshorten, të birin dhe të bijën dhe nuk ka pasur kurrfarë ndihme për ta e as njohje të vdekjes së tyre. Disa kanë plagë të thella psikologjike, por asnjëherë nuk kanë marrë kurrfarë ndihme psikologjike. Halla ime e cila e humbi të bijën e saj izolohet nga të gjithë çdo vit në maj, gati një muaj. Merr ilaçe të rënda dhe është thellësisht në depresion. Askush nuk ka punuar me familjarët e mbetur [...] Edhe materialisht, jetojnë në varfëri sepse nuk e kanë as edhe një pagë në familje. Lufta e tyre është ose të gjejnë punë ose të largohen nga vendi. Atyre iu është dashur ta lënë prapa të kaluarën për t'i mbijetuar të tashmes. Paramendoni, pesë ose gjashtë persona jetojnë nga një pagë.”³⁹²

Në shumë mënyra, nevojat e familjarëve kanë të bëjnë me aspekte gjinore, që është një tjetër aspekt që nuk është marrë parasysh. Verimja u përpoq ta shpjegonte një pjesë të asaj dinamike: “Gratë në ato zona nuk janë shumë të arsimuara dhe qëndrojnë në shtëpi tërë ditën, për dallim nga burrat të cilëve iu kalon koha kur dalin nga shtëpia për të punuar. Përderisa gratë qëndrojnë në shtëpi, ato kanë kohë për të menduar vazhdimisht për atë që ka ndodhur dhe për t'u zhytur edhe më thellë në traumë. Është tejet e nevojshme që ato të punojnë me një psikolog, por edhe që fëmijët e tyre të gjejnë punë dhe të qëndrojnë në vendin e tyre në vend se të largohen për të kërkuar punë jashtë vendit. Kjo është edhe një mënyrë për t'i përkrahur anëtarët më të moshuar të familjes.”³⁹³

Abedin Zymberi, i cili ka qenë mbase më i dukshmi nëse jo avokuesi i vetëm për të drejtat e familjeve të viktimave civile, foli për mungesën e mbështetjes nga institucione të ndryshme shtetërore në kërkimin e drejtësisë ose reparacioneve të çfarëdo lloji: “I kam kërkuar Presidentit të vendit të na ndihmojë duke rënë në kontakt me familjet e viktimave civile dhe mbase duke iu gjetur punë, që të mos ndihen plotësisht të harruar nga shteti dhe institucionet. Për shembull, në rastin e familjes së vëllait tim, ata e kanë humbur bijën e tyre. Askush nuk punon në familje dhe madje djalit i është dashur ta ndërprejë shkollimin sepse nuk kishin të holla. Si mund të presim që fëmijët e tyre t'i qëndrojnë besnikë këtij shteti nëse shteti nuk e ka pranuar asnjëherë vuajtjen e tyre? Nuk kemi marrë

388 Parlamenti i Republikës së Maqedonisë (2010) “Projekt Ligji për të drejtat e veçanta të anëtarëve invalidë të UÇK-së, familjarëve të viktimave civile dhe familjarëve të luftëtarëve të UÇK-së të rënë gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001,” në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

389 Krzhalovski, op cit., 5.

390 Parlamenti i Republikës së Maqedonisë, op cit.

391 Po aty., 7.

392 Intervistë me Verime Zymberin.

393 Po aty..

përgjigje nga Presidenti dhe aty ka përfunduar. Përveç asaj, sa i përket ndonjë forme të mbështetjes nga shteti, kemi provuar ta padisim shtetin në vitin 2003 për vrasjet. Por në vend se të merrnim diçka, kushdo që ka ngritur padi është dashur të paguaj €1,500 sepse u janë mohuar paditë e tyre dhe kështu janë ndalur. Paramendo, të paguash €1,500 euro kur askush në familje nuk është i punësuar. Pra, në njëfarë mënyre, na kanë vrarë për së dyti me këtë. Por është qenësore për ne ta dimë kush i ka vrarë viktimat civile në të gjitha anët. Është e rëndësishme të merret përgjegjësi që të ketë drejtësi për ta. Ata që kanë kryer krime duhet të mbahen përgjegjës. Dhe është shumë e rëndësishme të mos heshtim kurrë së foluri për këtë dhe të sigurohemi që kjo çështje është e dukshme”.³⁹⁴ Sa i përket kërimit të drejtësisë, Verimja përmendi që familjet e viktimave civile mund ta dërgojnë këtë çështje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, por “nuk janë të arsimuar” dhe nuk dinë si ta ndjekin atë rrugë drejt njohjes dhe drejtësisë.³⁹⁵

Sa i përket përfaqësimit, ata nuk ndihen të përfaqësuar nga askush, gjë që e thekson edhe më shumë nevojën për një qasje të organizuar për avokim nga familjet e viktimave civile. Njëra nga të intervistuarat sugjeroi që ishte problem përzierja e viktimave civile dhe viktimave ushtarake, prandaj “e tërë ndihma që shteti mund ta ketë për viktimat shqiptare shkon përmes Bashkimit Demokratik për Integritim [BDI – partia politike e formuar nga anëtarët e UÇK-së së çarmatosur]. Ata vendosin se kush merr çka, është krejtësisht e partizuar dhe e politizuar, por ata që janë në pushtet, që janë bërë milionerë që nga viti 2001, nuk kanë përjetuar vdekje në familjet e tyre”.³⁹⁶ Abedini vazhdon se partive politike iu bie në mend për viktimat civile dhe familjet e tyre vetëm gjatë fushatave zgjedhore dhe pastaj i harrojnë përsëri gjatë katër viteve të ardhshme të mandatit.³⁹⁷

FAMILJET E VIKTIMAVE USHTARAKE

Sipas disa vlerësimeve, gjatë konfliktit të armatosur u vranë mbi 70 anëtarë të forcave shtetërore të sigurisë dhe u plagosën më shumë se 340. Poashtu, më shumë se 80 anëtarë të UÇK-së u vranë dhe një numër i panjohur u plagosën.³⁹⁸ Nga 80 viktimat e UÇK-së, rreth 20 ishin qytetarë të Kosovës dhe Shqipërisë.³⁹⁹

Ligji për të Drejta të veçanta të anëtarëve të Forcave të Sigurisë të Republikës së Maqedonisë dhe familjarëve të tyre u miratua në vitin 2002 dhe u ndryshua në vitin 2003, 2004 dhe 2007.⁴⁰⁰ Ai i përfshin pesë lloje të të drejtave: punësimi, strehimi, përfitime të njëhershme në para të gatshme, arsimimi dhe pensione familjare.⁴⁰¹ Kjo e fundit u rregullua me ndryshimet e vitit 2003. Në mënyrë kritike, shumica e benefiteve janë të disponueshme vetëm për familjarët e forcave së sigurisë shtetërore që janë vrarë ose janë invalidë, por jo edhe për familjarët e tjerë të mbijetuar të forcave të sigurisë.

Heronjtë e Maqedonisë 2001, shoqata e anëtarëve të plagosur të forcave së sigurisë dhe familjarëve të

394 Intervistë me Abedin Zymerin.

395 Intervistë me Verime Zymerin.

396 Intervistë me Verime Zymerin.

397 Intervistë me Abedin Zymerin.

398 Klekovski, Sasho (2012) “Mbrotjtësit, UÇK dhe viktimat civile”, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

399 Po aty..

400 Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë (2007) “Ligji për të drejta të veçanta të anëtarëve të forcës së sigurisë së Republikës së Maqedonisë dhe familjarëve të tyre”, në dispozicion [këtu](#).

401 Po aty..

anëtarëve të forcave së sigurisë që u vranë, u themelua në shtator të vitit 2001.⁴⁰² Në vitin 2012, shoqata kishte 1,200 anëtarë nga 68 familje.⁴⁰³ Edhe pse përfaqësuesit e shoqatës deklaruan në të kaluarën që 97 përqind e kërkesave të tyre janë plotësuar me Ligjin e vitit 2002 dhe ndryshimet e mëvonshme, ka vonesa në kompensimet që i marrin familjet për dëme jopasurore, qasje në shërbime shëndetësore falas ose në marrjen e mbështetjes së nevojshme.⁴⁰⁴ Një familjar i dhjetë rezervistëve të vranë në një pritë më 8 gusht 2001 foli për disa të drejta që shtrihen edhe tek familjet e rezervistëve. Ato përfshijnë punësimin e një numri të vogël të familjarëve, qasje në arsim, një pension familjar, strehim me qira me mundësinë për t'i blerë banesat eventualisht me çmime të përballeshme dhe akomodim për pushime në kampin ushtarak në Liqenin e Ohrit.⁴⁰⁵ Të intervistuarit e cekën poashtu aspektin gjinor të nevojës për t'i plotësuar nevojat themelore, duke pasur parasysh që shumica e familjarëve ishin nëna me fëmijë të vegjël të cilat papritur u desh vetë të siguronin jetesën për familjet e tyre.⁴⁰⁶ Gjatë diskutimit rreth çështjes së avokimit dhe të drejtave të këtyre familjeve, i intervistuari tha: "Është ndryshe kur të jepet diçka në krahasim me kur e kërkon. Nuk dua të kërkoj asgjë. Dhe në fund të fundit, kujt t'ia kërkoj? Shtetit ku ata që e vranë babanë tim tani janë në pushtet?"⁴⁰⁷ Në këtë aspekt, i intervistuari mendonte se nuk mund të ketë drejtësi për babin e tij dhe ushtarët e tjerë të rënë përderisa ish-anëtarët e UÇK-së janë në pushtet.⁴⁰⁸

Sa i përket dukshmërisë, përfaqësimit dhe përkujtimit të forcave të rëna të sigurisë, familjarët dhe shoqatat e veteranëve organizojnë ceremoni përkujtimore në pjesë të ndryshme të vendit çdo vit. Ndërsa në disa prej tyre, siç është ceremonia përkujtimore në Karpallak, marrin pjesë përfaqësues të qeverisë,⁴⁰⁹ ose ministrat dhe kryetarët e komunave,⁴¹⁰ në ceremoni të tjera iu mbetet vetëm familjarëve t'i kujtojnë të dashurit e tyre vetë.⁴¹¹ Në Karpallak, pllaka përkujtimore e cila e shënon vendin ku ndodhi prita shpesh shkatërrohet ose hiqet.⁴¹² Në vitin 2019, Koordinator i atëhershëm Kombëtar për Veteranët e Luftës dhe Policisë iu premtoi familjarëve që do të ndërtohej një monument pasi vendi të hynte në NATO, që ndodhi në mars 2020. Megjithatë, deri më sot, ky premtim nuk është realizuar.⁴¹³

Në të njëjtën kohë, familjarët e viktimave të UÇK-së, si dhe vetë veteranët e UÇK-së, mbesin jashtë mbrojtjes me ligj. Ata u përfshinë në ligjin e lartpërmendur të vitit 2010 të propozuar nga Zymeri dhe Rexhepi, i cili nuk u miratua nga Parlamenti. Siç e shpjegon Fuat Beqiri, i biri i luftëtarit të rënë

402 Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2021), "Shoqata e anëtarëve të plagosur të forcës së sigurisë shtetërore dhe familjarët e anëtarëve të forës së sigurisë shtetërore të Maqedonisë – Heronjtë e Maqedonisë Shkup," në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

403 Malenkova, Tatjana (2012) "Vizita e Heronjëve të Maqedonisë 2021 në Komunën e Ohrit", *TV M Ohrid*, 28 qershor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

404 Meta.mk (2017) "Qeveria do të kërkojë zgjidhje për problemet e familjeve të luftëtarëve të rënë", në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

405 Intervistë me një familjar të njërit prej rezervistëve të vranë në Karpallak, Facebook, 7 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

406 Po aty..

407 Po aty..

408 Po aty..

409 Andonov, Zoran (2019b) "Luftëtarët e vranë në Karpallak do ta kenë një monument përkujtues pas anëtarësimit në NATO dhe qetësimin të marrëdhënieve ndëretnike, thotë Stojanče Angelov", *Sakam Da Kažam*, 8 gusht, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

410 Shërbimi Mediatik Maqedonas (2021) "Kriva Palanka shënon 20 vite që nga konflikti i vitit 2001," 3 gusht, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte]; *Expres.MK* (2021) "20 vite nga vdekja e luftëtarit Atanas Janev në Haraçinë", 23 qershor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

411 Vučevska, Milena (2021) "E dha jetën për Maqedoninë por nuk mori respekt – 20 vite nga vdekja e policit Coki", *Alfa TV*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

412 Andonov, Zoran (2019c) "Pllaka përkujtimore për luftëtarët e vranë në Karpallak hiqet përsëri", *Sakam Da Kažam*, 14 maj, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

413 Andonov (2019b), op cit.

të UÇK-së dhe dëshmitar në rastin e Lubotenit, për familjet e luftëtarëve të rënë të UÇK-së është “përkujdesur” BDI-ja.⁴¹⁴ Kështu, ishte partia politike e jo shteti ajo që i plotësoi nevojat themelore të familjeve dhe iu siguroi të drejtën e tyre për arsimim dhe punësim.⁴¹⁵ Ajo që është bërë e qartë është vakumi i krijuar nga shteti duke mos ua plotësuar nevojat familjeve të të gjitha viktimave ushtarake. Si rrjedhojë, kjo është e lidhur me refuzimin e partive maqedonase në pushtet, pjesërisht të ndikuara nga strukturat e ndryshme të veteranëve, për t’i njohur luftëtarët e UÇK-së si veteran legjitim të konfliktit të armatosur, e jo si forcë që e ka kërcënuar rendin dhe integritetin e shtetit. Kjo shihet si garantim i të drejtave dhe legjitimitetit të njëjtë për forcat e sigurisë shtetërore dhe UÇK-së.

Fuat Beqiri, anëtar i shoqatës së familjeve të luftëtarëve të rënë të UÇK-së e përbërë pothuajse vetëm nga familjarët meshkuj, theksoi që aktiviteti kryesor i shoqatës është ceremonia komemorative vjetore e fillimit të konfliktit të armatosur.⁴¹⁶ Për këtë arsye ata kërkojnë dhe marrin mbështetje financiare përmes ministrave dhe kryetarëve të komunave të ndryshme të BDI-së si dhe nga bizneset private.⁴¹⁷ Familjet që janë pjesë e shoqatës kanë një lidhje të fuqishme mes vete për shkak të humbjeve që i kanë pësuar dhe, përkundër përpjekjeve nga parti të ndryshme politike për t’i ndarë, kanë mbetur të bashkuar.⁴¹⁸

Është e paqartë, megjithatë, nëse mbështetja nga BDI-ja shtrihet për të gjithë familjarët e luftëtarëve të rënë të UÇK-së apo vetëm për ata që janë pjesë e shoqatës ose që kanë lidhje të afërta me BDI-në. Për shembull, një i intervistuar tjetër nga Tearca rikujton që: “Një familje e një luftëtari të rënë të UÇK-së me tri vajza fillimisht mori pak mbështetje por, pastaj, pas disa vitesh, nëna e tyre u desh të kthehej tek prindërit e saj me to sepse qiraja nuk iu paguhej më. Ka shumë shembuj të tillë dhe gjithnjë e më pak momente të përkujtimit të viktimave. Tani mendoj se është vetëm 14 marsi, dita kur filloi konflikti i armatosur në Tetovë dhe dita kur u nënshkrua MKO-ja.”⁴¹⁹

Një e përbashkët specifike që paraqitet nga të dhënat e intervistave është që asnjëri prej familjeve të luftëtarëve të rënë, qoftë nga forcat e sigurisë apo nga UÇK-ja, nuk i është ofruar mbështetje psikologjike. Kjo mbetet një nevojë që pranohet qartë nga të intervistuarit, përkundër kohës së gjatë që ka kaluar nga humbjet që i kanë pësuar. Përveç kësaj, duket se janë plotësuar shumica e nevojave themelore të familjeve të disa viktimave ushtarake të të dy palëve, drejtpërdrejt nga shteti ose përmes BDI-së si parti politike. Ajo që mbetet ende e paqartë, pa hartëzimin e hollësishëm të viktimave, familjeve të tyre dhe nevojave të tyre, është se si shumë familje ekzistojnë përtej këtyre rrjeteve, pa kurrfarë mbështetjeje apo përfaqësimi.

Rekomandimi këtu është të punohet me familjet e viktimave ushtarake fillimisht për ndërtimin e besimit dhe mundësisht nisjen e dialogut, nëse identifikohet një nevojë e tillë.

GRUPET E VETERANËVE

Numrat ndryshojnë sa iu përket personave që morën pjesë në të dyja palët e konfliktit të armatosur të vitit 2001, prandaj është e vështirë të vlerësohet numri i saktë i veteranëve në vend. Pavarësisht

414 Intervistë me Fuat Beqirin, Viber, 6 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

415 Po aty..

416 Intervistë me Fuat Beqirin.

417 Po aty..

418 Po aty..

419 Intervistë me Metin Muaremin.

numrave, megjithatë, veteranët nga të dyja anët janë aktualisht të vetmit persona të prekur nga konflikti i vitit 2001 shoqatat e të cilëve (të gjitha të përbëra vetëm nga meshkuj) mbesin aktive dhe të dukshme në publik.

Edhe pse Ligji për të drejtat e veçanta të anëtarëve të forcave të sigurisë së Republikës së Maqedonisë dhe familjarëve të tyre u miratua në vitin 2002 dhe u ndryshua në vitin 2003, 2004 dhe 2007, në rend të parë ligji iu jep të drejta invalidëve dhe familjeve të të rënëve në mesin e forcave të sigurisë shtetërore.⁴²⁰ Anëtarëve të tjerë të forcave të sigurisë iu garantohen vetëm dy të drejta me këtë Ligj: e drejta për arsimim universitar falas, duke përfshirë një përparësi në qasjen në akomodimin për studentë dhe një përparësi kur aplikojnë për punë në organe shtetërore, njësi të vetë-qeverisjes lokale, ndërmarrje publike dhe institucione publike.⁴²¹ Përveç këtij Ligji, nuk ka asnjë masë apo program tjetër shtetëror që synon t'i riintegrojë veteranët dhe ish-pjesëmarrësit e konfliktit të armatosur.

Kërkimi i të drejtave të veteranëve të forcave të sigurisë dhe “ndreqja e padrejtësive që ua kanë bërë” ata që janë në pushtet ishin arsytet themelore të themelimit të *Dinjitetit (Dostoinstvo)* në vitin 2007, sipas Stojançe Angelov, një prej themeluesve të saj dhe ish-gjeneral major në njësitë speciale të policisë maqedonase.⁴²² Njëherë, shoqata kishte mbi 10,000 anëtarë, me mbi 1,000 anëtarë aktivë.⁴²³ Duke folur për Ligjin e vitit 2002 dhe arritjet kryesore të *Dinjitetit (Dostoinstvo)*, Stojançe Angelov tha: “Ligji i vitit 2002 ishte i mirë për invalidët e luftës, por ata që nuk ishin të plagosur nuk morën asgjë. Të tjerët i kishin dy të drejta: të vijonin universitetin falas dhe një përparësi kur aplikojnë për punë. Megjithatë, pak kush u punësua në atë mënyrë, ose të paktën askush që e njoh unë. [...] Me *Dostoinstvo*, arritëm t'i korrigjojmë disa padrejtësi. Së pari, në vitin 2009 e detyruam VMRO-në [VMRO-DPMNE, partia në pushtet atëbotë] t'i tërhiqte paditë kundër invalidëve [për kthimin e kompensimeve nga shteti]. E dyta, i detyruam edhe të pajtoheshin që ushtarët profesionistë të mbeteshin të punësuar në ushtri, qoftë edhe në kapacitete të tjera, deri në pensionim. E treta, në vitin 2009-2010, e detyruam ish-Presidentin Ivanov t'i dallonte ushtarët e rënë dhe familjet e tyre, dhe së fundi e kam dorëzuar një nismë për t'i dalluar tre gjeneralë të vdekur. E fundit, po të mos ishim ne, shumë njerëz do ta kishin harruar plotësisht luftën.”⁴²⁴ Në vitin 2008, *Dinjiteti (Dostoinstvo)* poashtu propozoi një ligj të ri për veteranët e forcave të sigurisë, të cilin Parlamenti nuk e miratoi.⁴²⁵ Në mars të vitit 2011, shoqata themeloi bazën për një parti të re politike, *Dinjiteti (Dostoinstvo)*, e udhëhequr nga Angelov. Qëllimi i saj ishte t'i zgjidhte problemet e veteranëve dhe t'i plotësonte kërkesat e tyre përmes arenës politike dhe të bëhej “brendi i tretë maqedonas” – “partizanët e formuan partinë komuniste, nga e cila u krijua SDSM, komitet formuan ose u ndërlidhën me VMRO-në, prandaj *Dostoinstvo* është brendi i tretë – luftëtarët mbrojtës të 2001-tës.”⁴²⁶

Ashtu si *Dostoinstvo*, ka pasur edhe shoqata të tjera të veteranëve, më pak të dukshme. Për shembull, *ZUVO 2001–2002 Prilep*, Shoqata e pjesëmarrësve në aksionet e armatosura në mbrojtje të sovranitetit të Republikës së Maqedonisë 2001-2002 në Prilep u formua në vitin 2002. Qëllimi i saj ishte t'i përfshinte të gjithë rekrutët rezervistë që ishin thirrur për të shërbyer dhe ishin dërguar në rajonet e

420 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, op cit.

421 Po aty., 3–4.

422 Intervistë me Stojançe Angelov, Skype, 26 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

423 Po aty..

424 Po aty..

425 Krzhalovski op cit., 5.

426 Intervista me Stojançe Angelov.

konfliktit të armatosur në atë kohë.⁴²⁷ Qëllimi parësor i *ZUVO 2001-2002* ishte të përfshihej në Ligjin e vitit 2002 dhe që anëtarëve të saj t'iu jepen të drejtat për shërbime shëndetësore falas, arsim dhe siguri sociale dhe benefite për kohëzgjatjen e shërbimit. Siç thotë kryetari i shoqatës Rubin Sekuloski: “Po t’i kishim këto gjëra, do të fitonim status në shoqëri, në vend se të quheshim pijanecë, hajdutë, e të tjera. Pastaj, edhe nëse vdes, do ta di që ajo që e kam bërë të paktën është njohur duke m’u dhënë ai status. Prandaj, për mua, kjo është drejtësi.”⁴²⁸ Përderisa *ZUVO 2001–2002* kishte shumë anëtarë dhe pak pushtet, me kalimin e viteve disa anëtarë kanë vdekur, të tjerët janë zhgënjyer ose ftohur nga pozita e tyre në shoqëri dhe të tjerët kanë emigruar, duke i lënë rreth 150-200 anëtarë që paguajnë anëtarësimin dhe rreth 50-60 anëtarë aktivë.⁴²⁹ Një shoqatë tjetër e veteranëve është *Karpalak*, e formuar në Prilep nga dhe për rezervistët që mbijetuan në pritën e Karpallakut.⁴³⁰

Veteranët e UÇK-së, në anën tjetër, nuk mbrohen në asnjë mënyrë me ligj. Në fakt, mund të argumentohet që Ligji i 2002-tës i përmendur më sipër shkon një hap më tutje duke i përkufizuar forcat e sigurisë si ata persona që “morën pjesë në një mbrojtje të organizuar të pavarësisë, integritetit territorial dhe sovranitetit të Republikës së Maqedonisë dhe në parandalimin e përmbysjes me dhunë të institucioneve demokratike të themeluara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë”, duke i përjashtuar kështu veteranët e UÇK-së.⁴³¹

UÇK-ja u demobilizua në pranverën e vitit 2002 pas nënshkrimit të MKO-së në gusht të vitit 2001 dhe përfundimit të luftimeve në nëntor të vitit 2001. Një parti e re politike, Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), u themelua më 5 qershor 2002, udhëheqësia e së cilës ishte praktikisht e njëjta si udhëheqësia e UÇK-së.⁴³² Shoqata e veteranëve të UÇK-së u formua në të njëjtin vit. Siç shpjegon Raim Limani, ish-komandant i UÇK-së dhe anëtar i BDI-së dhe i shoqatës: “Shoqata u formua në vitin 2002 dhe asambleja e themelimit u mbajt në Shkup. Themeluesit ishin komandantët e UÇK-së, ata e filluan këtë. Në mënyrë joformale, të gjithë pjesëmarrësit e UÇK-së ishin anëtarë, megjithëse edhe persona të tjerë u anëtarësuan [...] Sa i përket ndarjes mes partisë politike të BDI-së dhe shoqatës, formalisht ato janë subjekte të ndara por në praktikë nuk mund të them që shoqata është imune ndaj ndikimit të partisë, sidomos kur marrim parasysh që udhëheqësit e shoqatës janë ish-udhëheqësit e UÇK-së dhe që ish-udhëheqësit e UÇK-së janë edhe udhëheqësit e BDI-së. Prandaj, është pothuajse e pamundur të jetë imune ndaj ndikimeve politike, edhe pse unë kam qenë kundër kësaj që nga fillimi. BDI-ja ka bërë diçka për veteranët, por nuk është fare e mjaftueshme. Është dashur të bëjnë më shumë.”⁴³³

Raim Limani ishte konkret për qëllimet e shoqatës: “Shoqata është themeluar me qëllimin për t’i mbrojtur të drejtat e ish-pjesëtarëve të UÇK-së për t’u riintegruar në shoqëri dhe për t’u përfshirë si të gjitha grupet e tjera sociale. Ka edhe qëllime tjera, por ky është qëllimi kryesor. Por mendoj se nuk kemi pasur sukses, pasi që shumë anëtarë të UÇK-së mezi po ia dalin të mbijetojnë. Sigurisht, kjo ka ndodhur edhe me grupet e tjera, por këta njerëz meritojnë pak më shumë vëmendje pasi që kanë qenë të

427 Taleski, Goran (2020) *Historitë e luftës nga veteranët e Prilepit nga viti 2001*. Prilep: Aksioni Paqësor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte], 11.

428 Intervistë me Rubin Sekuloski, ish-rezervist dhe kryetar aktual i ZUVO 2001–2002, Viber, 7 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

429 Po aty..

430 Taleski (2020) op cit., 13.

431 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, op cit., 1.

432 Taleski, Dane (2011) “Nga plumbat në fletëvotime: transformimi nga guerila në parti në Maqedoni,” artikull i prezantuar në Seminarin e Departamentit të Shkencave Politike, Universiteti i Evropës Qendrore, në dispozicion [këtu](#).

433 Intervistë me Raim Limanin, Viber, 9 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

përfshirë drejtpërdrejt në konfliktin e armatosur [...] Në dokumentet themeluese të shoqatës përmendet që ne synojmë ta bëjmë një ligj që i mbron edhe anëtarët e UÇK-së. Nuk mund të flas për arsytet pse kjo nuk ka ndodhur, por mund ta shihni që ka rezistencë nga partitë politike maqedonase në këtë aspekt”.⁴³⁴

Të zhgënjyer nga zbatimi i MKO-së dhe adresimi joadekuat i arsyeve që çuan në konfliktin e armatosur, si dhe nga “përfaqësimi jo-dinjitoz i interesave të veteranëve të UÇK-së nga BDI-ja”⁴³⁵, u themelua Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Siç shpjegon kryetari i saj, Besim Hoda: “Organizatën e themeluan në prill të 2005-tës, menjëherë pas periudhës zyrtare të kërkuar për zbatimin e MKO-së [...] Organizata i ka 1,014 anëtarë [...] Deri më sot, ushtarët e UÇK-së janë trajtuar ligjërisht si terroristë të cilët e kërcënuan sovranitetin dhe integritetin e vendit në vitin 2001. Përfshirjet e vetme janë ata ushtarë të UÇK-së të cilët tani janë pjesë e përkohshme e qeverisë, që përfshin edhe shumicën e udhëheqësive të UÇK-së. Ata që u vranë, familjet e tyre, invalidët si dhe ushtarët e UÇK-së që pësuan lëndime fizike dhe psikologjike ende injorohen nga të gjithë. Përkundrazi, mjerisht ata shërbejnë vetëm si kartë politike për partitë gjatë fushatave zgjedhore. Dhe, fatkeqësisht, UÇK-ja vazhdon të shfrytëzohet si propagandë politike nga të dyja palët. Për këtë arsye e kemi formuar një organizatë të pavarur, Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, e cila u formua në rend të parë si kundërpeshë e OJQ-së tjetër të veteranëve të UÇK-së, e cila ekziston brenda BDI-së dhe krijon politika për të e jo për kauzën e shqiptarëve dhe arsyen ose qëllimin e UÇK-së. Organizata është formuar me ushtarët jopartiakë të UÇK-së të cilët besojnë se kërkesat, idealet, miqtë që vdiqën dhe familjet e tyre trajtohen si kartë politike dhe që po manipulohet në emrin e tyre. Kjo për shkak se vetë ligji nuk i trajton barabartë të gjitha anët e konfliktit të armatosur [...] Ne punojmë për të shfaqur rezistencë ndaj propagandës manipuluese nacionaliste të partive politike shqiptare gjatë kampanjave zgjedhore, për t'i mbrojtur ushtarët e UÇK-së nga një abuzim i tillë, si dhe për të reaguar kur anëtarët tanë pa të drejtë sulmohen dhe fajësohen nga institucionet e shtetit për pjesëmarrjen e tyre në luftë”.⁴³⁶

Pa u pyetur drejtpërdrejt për të, disa të intervistuar folën për të drejtat e tyre në lidhje me të drejtat e veteranëve nga ana tjetër e konfliktit të armatosur. Për shembull, Besim Hoda theksoi: “Në parim, nuk kemi asgjë kundër që pjesëtarët e forcave të sigurisë shtetërore të marrin benefite sepse, siç e kanë dëshmuar vetë ndryshimet e rendit kushtetues me Marrëveshjen e Ohrit, ishte shteti e jo populli ata që kishin faj. Ne nuk kemi luftuar kurrë që ata të mos mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre, së bashku me veteranët e luftës dhe invalidët. Ne gjithmonë kemi avokuar që të dyja palët t'i gëzojnë të drejtat e njëjta”.⁴³⁷ Gati ngjashëm, edhe pse duke theksuar që veteranët e UÇK-së mund të kenë “marrë më shumë” sesa rekrutët rezervistë, Rubin Sekuloski tha: “Madje jam i gatshëm të them që të gjithë duhet t'i marrim të drejtat tona. Ne të gjithë kemi marrë pjesë në luftë. Edhe ata kanë fëmijë, nëna, baballarë, motra... Ne të gjithë jemi viktimë të qeverisjes së asaj kohe, viktimë të sistemit”.

Kur pyeten për marrëdhëniet me shoqatat e tjera të veteranëve, qoftë nga ana e njëjtë ose e kundërt në konfliktin e armatosur, përshtypja në mesin e disave duket të jetë se ata “kanë kapacitete për të punuar së bashku jo vetëm për të siguruar plotësimin e të gjitha nevojave [të tyre] dhe bashkimin e veteranëve,

434 Intervistë me Raim Limanin.

435 Intervistë me Besim Hodën, ish-ushtar i UÇK-së dhe Kryetar i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Viber, 14 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena

Stavrevska

436 Po aty...

437 Po aty..

por edhe për pajtim më të gjerë shoqëror”.⁴³⁸ Në këtë drejtim, në vitin 2018 ishte një nismë, një hap fillestar drejt pajtimit, i udhëhequr nga Stojançe Angelov dhe Abedin Zymeri.⁴³⁹ Sipas Angelov, “Kanë kaluar njëzet vite, është koha që ne të pajtohemi më në fund. Në fakt, jemi vonuar. Numri i personave të vrarë gjatë konfliktit të armatosur, si nga ana e mbrojtësve dhe nga UÇK-ja, është relativisht i vogël, edhe pse sigurisht janë tragjedi. Por nuk duhet të presim edhe 100 vite për tu pajtuar. Dhe dua të punoj për këtë në të ardhmen [...] Sa i përket nismës me Abedinin, atë e njoh si armik lufte. Pse e respektoj dhe pse e kam zgjedhur? Në rajonin e Kumanovës-Likovës, nuk e kemi pasur asnjë mizori. Kemi luftuar, e kemi vrarë njëri-tjetrin, forcat e sigurisë i kanë vrarë dhjetë civilë të familjes Zymeri të cilët kanë qëlluar në vendin e gabuar në kohën e gabuar, pasi që nuk e kanë pritur se do të kishte civilë në fshat në mesin e luftimeve. Dhe është një humbje e madhe që e ka përjetuar Abedini; vajza e tij ishte në mesin e të vrarëve. Megjithatë, përkundër kësaj humbjeje, ai nuk e ka lejuar zemërimin ta mundë. Ne i kemi pasur dy ushtarë të kapur nga ta dhe më e shumta që kanë mundur të pësojnë kanë qenë disa shuplaka, por nuk janë rrahur as keqtrajtuar. Prandaj e respektoj sepse ka qenë ushtar. Ai personalisht i ka mbrojtur të zënë rob duke thënë që do ta vriste këdo që do t’i godiste. Edhe sa iu përket civilëve, po, shumë persona kanë ikur, por nuk është kryer asnjë mizori. Prandaj e kam zgjedhur Abedinin si dikë nga ana tjetër. Mendoj se nisma është pranuar më mirë nga ana jonë, por Abedini e ka pasur të vështirë me njerëzit në fshatin e tij”.⁴⁴⁰

Duke reflektuar mbi nismën e synuar për të treguar që “të gjithë duhet t’ia zgjasim dorën njëri-tjetrit dhe ta lëmë prapa konfliktin e armatosur”, Zymeri tha: “Ajo që ka ndodhur, ka ndodhur. Tani duhet të ecim përpara dhe të punojmë së bashku për ta krijuar një shtet të përbashkët. Njëzet vite pas konfliktit të armatosur e shohim që ende ka shumë gjuhë të urrejtjes, sidomos në mediat elektronike. Është edhe më keq se në vitin 2001 [...] Në lidhje me nismën, intelektualët vërtetë i kanë përkrahur përpjekjet e mia me Gjeneralin Angelov. Megjithatë, shumë të tjerëve në fshat, që nuk e kuptojnë esencën e punës, nuk iu pëlqen. [...] Por mendoj se eventualisht kanë filluar ta kuptojnë se cili ishte motivi i vërtetë. Por tani nuk mund të jem unë ai që i bën të gjithë hapat [...] Unë jam veteran, por nuk jam në listën e veteranëve dhe nuk ndihem i përfaqësuar nga askush. Partia që ka dalë nga konflikti i armatosur i përfaqëson vetëm interesat e atyre që janë afër partisë. Veteranët e tjerë kanë mbetur anash. Pra, shoqatat e veteranëve janë ato që duhet të bëjnë atë që e kam bërë unë me Stojançe-n. Por pasi që shoqata vetëm prodhon më shumë nacionalizëm, i shtojnë më shumë benzinë zjarrit dhe krijojnë më shumë urrejtje. Prandaj, e kanë sulmuar nismën tonë. Nuk duan që ta çojmë përpara”.⁴⁴¹

Situata e rëndë në të cilën ndodhen shumë veteranë u theksua nga pothuajse të gjithë kur u diskutua për nevojat e veteranëve. Njësoj, mungesa e ndihmës psikologjike u theksua nga pothuajse të gjithë të intervistuarit. Angelov, për shembull, theksoi: “Ne e kemi nënvlerësuar PTSD-në. Unë jam person me PTSD dhe edhe sot e kësaj dite nuk ndihem si person që ka PTSD [...] Shumica e anëtarëve të njësisë speciale janë kështu, gjë që ka çuar në vrasjen e disa personave dhe në disa raste lëndime të rënda trupore [...] PTSD është shprehur në të gjitha format e mundshme: disa kanë vdekur nga kanceri, disa kanë vdekur nga sulmi në zemër, disa janë bërë alkoolistë, disa kanë ushtruar dhunë në familje, disa janë shkurorëzuar, duke përfshirë edhe mua. Ka pasur shumë forma të tij brenda familjeve që nuk janë trajtuar asnjëherë”.⁴⁴²

438 Intervistë me Raim Limanin.

439 1TV.mk (2018) “Në anë të ndryshme në vitin 2001, tani luftojnë së bashku për paqe: Angelov dhe Zymeri në Studio 1,” 21 dhjetor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

440 Intervistë me Stojançe Angelov.

441 Intervistë me Abedin Zymerin.

442 Intervistë me Stojançe Angelov.

Disa prej të intervistuarve e lidhën mosplotësimin e nevojave elementare me pakënaqësinë e veteranëve dhe mungesën e drejtësisë së tyre. Limani, për shembull, tha: “Kur nuk plotësohen nevojat ekzistenciale të dikujt, nuk mund të presësh që ai person do të jetë i kënaqur. Për këtë arsye e donim ligjin dhe donim që anëtarët e UÇK-së të përfshiheshin në fusha të ndryshme të shoqërisë, që nga këndvështrimi ynë do të kishte kontribuar në pajtim. Tani për tani, ka mosbesim, mosbesim të madh, nga anëtarët e UÇK-së ndaj institucioneve shtetërore dhe madje edhe ndaj partive politike. Nuk kemi numra specifike ose një pasqyrë të nevojave të të gjithë ish-anëtarëve të UÇK-së, por nga provat anekdotale, prej atyre që kanë mbetur në fshatin tim, shumica janë larguar nga vendi për të mbijetuar. Prandaj, miratimi i një ligji të tillë do të ndihmonte në plotësimin e nevojave të caktuara, do t’i afronte njerëzit dhe, eventualisht, me pajtim”.⁴⁴³ Ai theksoi që aktualisht janë duke punuar në reformimin e shoqatës, për ta bërë atë më aktive dhe mundësisht për ta ndarë atë nga partia, duke siguruar që shoqata e ka qëndrimin e vet lidhur me zhvillimet e vazhdueshme.⁴⁴⁴

Pothuajse të gjithë të intervistuarit deklaruan që veteranët, në të dyja anët, përkujtohen vetëm gjatë fushatave zgjedhore. Disa të intervistuar theksuan që si veteranët ashtu edhe shoqatat duhet ta kujtojnë çfarë ndodhi në vitin 2001. Në atë aspekt, Angelov tha: “Nuk kemi asnjë kujtim institucional të 2001-tës [...] Të gjithë kemi kujtime personale, por nëse unë vdes sot, gjërat që i di unë që nuk janë dokumentuar askund do të humbin”.⁴⁴⁵

Me sa duket, shoqatat e veteranëve kanë shumë nevoja të ndryshme dhe ato nevoja mund të dallojnë nga shoqata në shoqatë, duke u varur pjesërisht nga afërsia që e kanë me ata në pushtet. Në disa raste, edhe nëse nuk është identifikuar me këto fjalë, ndihma me kapacitetet organizative mund të ishte e dobishme, si dhe zhvillimi i shkathëtisë që të mund t’i evidentojnë përvojat e tyre dhe për ta rritur dukshmërinë e tyre në publik. Gati në të gjitha rastet, do të ishte e dobishme asistencë me avokim dhe hapa të mëtejshëm në drejtësinë tranzicionale. Megjithatë, në përgjithësi, shoqatat e veteranëve, ose së paku të intervistuarit e përfshirë këtu, duket të jenë shumë më përpara sa i përket gatishmërisë dhe procesit të pajtimit sesa disa pjesë të tjera të shoqërisë.

Marrë parasysh mungesën e materialeve të arkivuara në mënyrë elektronike nga koha e konfliktit të armatosur, për shkak se shumë prej organizatave më të mëdha mediatike të asaj kohe janë mbyllur, historitë gojore dhe njohuritë e veteranëve për ngjarjet e vitit 2001 mund të jenë kritike për ta krijuar një kulturë të kujtesës së konfliktit të armatosur. Për këtë arsye, rekomandohet të punohet me veteranët lidhur me këtë. Një rekomandim tjetër është që të punohet me shoqatat për nisjen e një dialogu mes palëve të ndryshme. Disa prej veteranëve kanë potencial për të kontribuar, në mos edhe për ta udhëhequr, një diskutim kombëtar mbi konfliktin e armatosur dhe pajtimin.

NJERËZIT NGA RAJONET E PREKURA NGA KONFLIKTI I ARMATOSUR MË GJERËSISHT

Aktualisht nuk është asnjë shoqatë që i bashkon njerëzit në rajonet e prekura nga konflikti i armatosur në mënyrë specifike rreth përvojave të tyre ose nevojave të përbashkëta. Duke folur për arsyen e mundshme, Metin Muaremi tha: “Njerëzit nuk janë të organizuar në shoqata sepse shumë prej tyre janë të lidhur me partitë politike si një mënyrë për të gjetur punë. Duke pasur parasysh sa e lartë është

443 Intervistë me Raim Limanin.

444 Po aty..

445 Intervistë me Stojanče Angelov

shkalla e papunësisë, e shohin këtë si mënyrën e vetme. Ka shumë ndasi edhe mes grupeve etnike dhe pastaj e humbasin perspektivën që duhet të veprojnë”.⁴⁴⁶ Për këtë qëllim, hulumtimi dhe intervistat e kanë identifikuar situatën dhe nevojat e tri grupeve të gjera të prekura nga konflikti i armatosur, në mënyrë direkte ose indirekte, dhe të cilat do të mund të ishin grupet e mundshme për bashkëpunim.

Një grup i tillë është ai i komuniteteve më të vogla etnike, veçanërisht romët që jetojnë në rajonet e prekura nga konflikti i armatosur. Marrë parasysh diskriminim e vazhdueshëm sistemik dhe mungesën e mbrojtjes nga shteti me të cilën janë ballafaquar romët si në Jugosllavi ashtu edhe që nga shpallja e pavarësisë, anëtarët e komunitetit rom janë vënë në një pozitë ku është dashur ta bëjnë një zgjedhje të vështirë gjatë konfliktit të armatosur – t’i mbështesin luftëtarët e UÇK-së dhe luftën e tyre për të drejta më të mira për pakicat ose nganjëherë të rekrutohen nga forcat e sigurisë dhe ta mbështesin luftën për integritetin territorial të shtetit.⁴⁴⁷ Kjo rrallëherë është njohur. Siç shprehet me të drejtë Akif Kariman, njëri prej iniciatorëve të lëvizjes më të dukshme qytetare rrome Avaja: “Kur flasim për 2001-tën dhe për pajtimin, tërë kohën diskutimi përqendrohet në maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë e të tjerët janë harruar [...] Në fakt, shumë gjëra nuk i kam ditur [për përvojën e konfliktit të armatosur] derisa kam filluar të bëj intervista me anëtarët e komunitetit rom, duke përfshirë nënën time”.⁴⁴⁸ Në të njëjtën kohë, në nivel politik, Dehran Muratov, gazetar me origjinë rrome, thekson që “2001-ta i bëri ato komunitete më të vogla etnike më të dukshme me marrëveshjet politike, me Marrëveshjen e Ohrit. Para 2001-tës, ishin të padukshëm sepse ishin të shkrirë me njërin ose tjetrin komunitet [më të madh] etnik, varësisht se ku jetoni [...] Sot, falë MKO-së [disa njerëz nga komunitetet më të vogla] kanë pozita të garantuara, gjë që nuk ka ndodhur përpara”.⁴⁴⁹

Përfshirja e romëve në konfliktin e armatosur dhe ndikimi që e ka pasur në ta janë bërë të padukshme. Njëkohësisht, mbizotëron frika për të folur për këto përvoja, me shumë mosbesim për shkak të dekadave të diskriminimit, shtypjes dhe përjashtimit që e ka përjetuar ky komunitet. Është e nevojshme të ofrohen hapësira të sigurta ku romët mund t’i ndajnë përvojat e tyre të konfliktit të armatosur. Rekomandimi në punën me komunitetin rom është që t’i jepet përparësi mbledhjes së historive gojore të përvojave të gjalla dhe, përmes kësaj dhe aktiviteteve të tjera, të bëhen të dukshme ato përvoja dhe mundësisht të niset një diskutim për ta kujtuar 2001-tën përtej dy narrativave dominuese të diskutuara në kapitullin e fundit të këtij studimi.

Një grup tjetër janë mësimdhënësit e historisë në vend. Aktualisht, librat shkollorë të historisë ndalen me pavarësinë e vendit, prandaj konflikti i armatosur i vitit 2001 nuk përfshihet në asnjë mënyrë. Përveç kësaj, librat shkollorë të historisë i mbulojnë ngjarjet historike “që kanë të bëjnë” me popullin shqiptar dhe ato “që kanë të bëjnë” me popullin maqedonas në mënyrë të ndarë, ku e para mësohet kryesisht në klasat shqiptare dhe e fundit mësohet kryesisht në klasat maqedonase. Komunitetet e tjera as që përmenden në librat shkollorë.⁴⁵⁰ Edhe pse kanë qenë disa nisma nga mësimdhënësit dhe organizatat e shoqërisë civile për t’i përfshirë komunitetet më të vogla etnike në librat shkollorë, si

446 Intervistë me Metin Muaremin.

447 Taleski, Goran, Kols, Tomas, Jusufi Salju, Fllanza dhe Kitanoski, Boro (2014) *Извину, ама ти си од погрешна националност / Më fal, por ti je nga kombësia e gabuar*, Prilep: Aksioni Paqësor, në dispozicion **këtu** [në maqedonishte dhe shqipe].

448 Intervistë me Akif Karimanin, Zoom, 22 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

449 Intervistë me Dehran Muratov, Zoom, 13 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

450 Grup fokusi me mësimdhënësit e historisë: Merjem Emini (mësimdhënëse e historisë në shkollë fillore në Tetovë), Kenan Iseni (mësimdhënësi i historisë në shkollë të mesme në Shkup) dhe Harun Rexhepi (mësimdhënësi i historisë në shkollë fillore në Tetovë), Zoom, 23 prill 2001. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

dhe disa nisma për ta krijuar një narrativë të përbashkët historike rreth konfliktit të armatosur të vitit 2001, këto nisma në fund nuk janë pranuar nga organet arsimore të qeverisë dhe nga Ministria e Arsimit.⁴⁵¹ Disa prej mësimdhënësve të intervistuar të historisë deklaruan që përfshirja e tyre në sektorin e shoqërisë civile dhe nisma e projekte të ndryshme rrjedh nga nevoja e identifikuar për libra më të mirë shkollore të historisë dhe mësimdhënie më të mirë të historisë.⁴⁵²

Nevojat e identifikuara përfshijnë më shumë aktivitete që i bashkojnë mësimdhënësit e historisë, pasi që shumica nuk kanë kontakt me njëri-tjetrin, për t'iu ndihmuar t'i besojnë njëri-tjetrit dhe të punojnë së bashku për të siguruar që historia mësohet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të saktë që i nxit nxënësit të mësojnë për komunitetet e tjera në shoqërinë e tyre. Rekomandimi për punën me mësimdhënësit e historisë është të organizohen aktivitete jo vetëm me mësimdhënësit e historisë nga zonat e prekura nga konflikti i armatosur por edhe më gjerësisht, nëse është e mundur.

Grupi i tretë është ai i të rinjve nga rajonet më të prekura nga konflikti i armatosur. Pasi që viti 2001 nuk përfshihet në kurrikulën e shkollës dhe në masë të madhe mungon në diskursin kombëtar, të rinjtë e lindur rreth dhe pas vitit 2001 mësojnë për konfliktin e armatosur kryesisht nga familjet e tyre. Si rezultat, trauma ose "harrimi" i konfliktit të armatosur trashëgohet nga gjeneratat e vjetra. Përveç kësaj, pasi që nxënësit e kombësive të ndryshme në masë të madhe ndjekin shkolla ose së paku klasa të ndara, rastet kur të rinjtë duhet të bashkohen dhe të mësojnë nga njëri-tjetri janë të rralla. Në përpjekje për ta sfiduar këtë ndarje, disa aktivistë të rinj kanë organizuar ndërhyrje në hapësirën publike, përmes muraleve dhe posterëve.⁴⁵³

Në disa raste, të rinjtë nga kombësitë e ndryshme nuk e flasin të njëjtën gjuhë (lokale) ose refuzojnë ta flasin gjuhën e kombësisë tjetër dhe zgjedhin të komunikojnë në gjuhën angleze kur është e nevojshme. Në disa raste, kur është i nevojshëm përkthimi në maqedonisht ose shqip, anglishtja përdoret për arsye se është më e përshtatshme. Një shembull i tillë janë mbledhjet e ekipit drejtues të Unionit të Nxënësve të Shkollave të Mesme, edhe pse të gjitha dokumentet e Unionit janë në shqip dhe në maqedonisht.⁴⁵⁴

Nevojat e identifikuara të të rinjve, të atyre që ishin fëmijë gjatë konfliktit të armatosur dhe atyre të lindur pas vitit 2001, dhe rekomandimi për të punuar me ta është të inkurajohen aktivitete që krijojnë dialog për ndërtimin e besimit dhe të vazhdojnë të zhvillojnë një kulturë të kujtesës.

3.3 Nismat zyrtare për ballafaqim me të kaluarën në Maqedoninë e Veriut

Nismat për tu ballafaquar me të kaluarën e vendit, dhe konfliktin e armatosur të vitit 2001 në veçanti, janë të kufizuara në masë të madhe. Ky kapitull përshkruan disa prej nismave zyrtare dhe jozyrtare që janë relevante për ballafaqimin me të kaluarën.

451 Grupi fokus i mësimdhënësit e historisë; Intervistë me Mire Mladenovski, mësimdhënës i historisë në shkollën fillore në Novosellë, Zoom, 12 prill.

Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

452 Grupi fokus i mësimdhënësit e historisë; intervistë me Mire Mladenovski; intervistë me Irena Mladenovska, mësimdhënëse e historisë në shkollën fillore në Shkup, Zoom, 13 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

453 Intervistë me Jetmir Asani dhe Valon Kuçi, aktivistë për paqe nga Shkupi, Zoom, 14 prill 2021; intervistë me Elena Saveska, aktiviste për paqe nga Tetova, Zoom, 16 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

454 Intervistë me Blendi Hodai, Kryetar i Unionit të Nxënësve të Shkollave të Mesme, Zoom, 16 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

MARRËVESHJA KORNIZË E OHRIT DHE NDRYSHIMET LIGJORE

Marrëveshja Kornizë e nënshkruar në Ohër, e njohur edhe si Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO), shënoi zyrtarisht fundin e luftimeve mes UÇK-së dhe forcave të sigurisë shtetërore, edhe pse ende ndodhën disa përplasje më vonë atë vit dhe në vitin 2002. MKO-ja u nënshkrua më 13 gusht 2001 nga presidenti i atëhershëm i shtetit dhe përfaqësuesit e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), përfaqësuesit e Lidhjes Social-demokrate të Maqedonisë (SDSM), të Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) dhe të Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD).⁴⁵⁵ Sigurisht, MKO-ja nuk u nënshkrua nga përfaqësuesit e UÇK-së. Në vend të tyre, u konsiderua se komuniteti shqiptar ishte i përfaqësuar nga nënshkruesit e PDSH dhe PPD, në koordinim me UÇK-në. Marrëveshja u ratifikua nga Parlamenti më 16 nëntor 2001.⁴⁵⁶

MKO-ja e refuzon “plotësisht dhe pa kushte” “[përdorimin e dhunës për arritjen e qëllimeve politike” dhe e thekson natyrën multietnike të Maqedonisë dhe rëndësinë e plotësisht të nevojave të të gjithë qytetarëve përmes Kushtetutës”.⁴⁵⁷ Në mesin e parimeve themelore, poashtu theksohet që “zhvillimi i vetëqeverisjes lokale është esenciale për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për promovimin e respektit për identitetin e komuniteteve”.⁴⁵⁸ Zhvillimi i qeverisë së decentralizuar është njëra prej aspekteve kryesore të përfshira në MKO. Aty përfshihen edhe një numër dispozitash të tjera në lidhje me: ndërprerjen e luftimeve dhe çarmatosjen vullnetare dhe shpërbërjen e plotë të grupeve të armatosura etnike shqiptare; mosdiskriminimin sipas ligjit dhe përfaqësimin e barabartë të komuniteteve në të gjitha organet e administratës publike; procedurat e veçanta parlamentare që sigurojnë se nuk ka tirani të shumicës mbi një numër çështjesh kritike; të drejtën për arsimim dhe përdorimin e gjuhëve, si dhe emblemën si shprehje të identitetit. Poashtu, Marrëveshja i ka tri shtojca: Shtojca A përmban ndryshimet e dakorduara kushtetuese që garantojnë të drejta të caktuara politike dhe kulturore; Shtojca B përshkruan ndryshimet legjislative në të paku nëntë ligje të nevojshme për zbatimin e MKO-së; dhe Shtojca C përfshin dispozita për masat e zbatimit dhe ngritjes së besimit, duke përfshirë rolin e bashkësisë ndërkombëtare.

MKO-ja konsiderohet gjerësisht të jetë zbatuar në plotësi.⁴⁵⁹ Megjithatë, përderisa ekzistonte, Shoqata e PZHBV-ve nga Haraçina Zora shpesh ua përkujtonte atyre në pushtet që nuk ishte zbatuar dispozita për të gjitha partitë për të punuar për të “siguruar kthimin e refugjatëve që janë qytetarë ose banorë ligjorë të Maqedonisë së Veriut dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore”. Përkundër këtyre mangësive, edhe pse MKO-ja nuk përmban dispozita të drejtpërdrejta që e obligojnë ose e nxisin fuqishëm ballafaqimin me të kaluarën, zbatimi i përgjithshëm ka sjellur elemente të caktuara të drejtësisë tranzicionale në vend dhe paraqet një pike të mirë fillestare, sado e kufizuar që mund të jetë, për zhvillimin e një shoqërie paqësore. Si e kanë shfrytëzuar partitë në pushtet MKO-në dhe ndryshimet ligjore e institucionale që kanë lindur prej saj, në anën tjetër, është çështje tjetër, përtej fushës së këtij studimi.

RASTET NË TPNJ DHE AMNISTIA

Gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoni të Veriut janë kryer një numër krimesh të pretenduara të luftës. Katër procese gjyqësore për krime lufte kundër anëtarëve të UÇK-së filluan në vitin 2002,

455 Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001), op cit.

456 Canada: Immigration and Refugee Board of Canada (2003) *Macedonia: Implementation of the Framework (Ohrid) Agreement*, e disponueshme [këtu](#).

457 Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001), op cit., neni 1.1, 1.3 dhe 1.4.

458 Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001), op cit., neni 1.5.

459 Marusic, op cit.

të cilat pastaj iu bartën juridiksionit të Zyrës së Prokurorit në TPNJ më vonë atë vit. Katër rastet përfshinë: (1) Rastin e punëtorëve të rrugës në Mavrovë, që i referohet kidnapimit, torturimit dhe keqtrajtimit të pesë punëtorëve të Kompanisë Ndërtimore Mavrova në gusht të vitit 2001; (2) Rastin Neprošteno, që i referohet rrëmbimit të 12 civilëve nga ushtarët e UÇK-së në korrik-gusht 2001 në rajonin e Tetovës; (3) Rastin e Rezervuarit të Ujit në Likovë, që i referohet “ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm prej dyzet ditësh për qytetin e Kumanovës përmes mbylljes së gypave në sistemin e ujësjellësit të Kumanovës afër Liqenit të Likovës, që ishte nën kontrollin e UÇK-së në atë kohë”,⁴⁶⁰ dhe (4) Rasti i Udhëheqësisë së UÇK-së, që i referohet akuzimit të tërë lidershit të UÇK-së për kryerjen e dhjetëra krimeve të luftës në parimin e përgjegjësisë komanduese. Përveç kësaj, në vitin 2004, Zyra e Prokurorit të TPNJ-së po ashtu hapi një hetim për Rastin e Lubotenit, në të cilin ish-Ministri i Punëve të Brendshme, Ljube Boškoski, dhe një ish-zyrtar policor që vepronte si inspektor për përcjellje në njësinë e sigurisë së presidentit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Johan Tarčulovski, u akuzuan për krime lufte të kryera nga forcat e sigurisë shtetërore në fshatin Luboten në gusht 2001.

Përderisa Boškoski u lirua, Tarčulovski u shpall fajtor dhe u dënua me 12 vjet burgim.⁴⁶¹ Katër rastet e tjera, për shkak të kërkesës së Këshillit të Sigurisë të OKB-së që të gjitha hetimet e TPNJ-së duhet të përfundoheshin deri në fund të vitit 2007, u bartën përsëri në gjyqësorin maqedonas në shkurt të vitit 2002.⁴⁶² Në fund, të katër rastet u ndërprejnë me interpretimin autentik të vitit 2011 të Ligjit për Amnisti të vitit 2002.

Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi Ligjin për Amnisti në vitin 2002 në përpjekje për t'i mbrojtur ish-luftëtarët e të dyja palëve nga përndjekja për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001. Ligji në mënyrë të qartë i përjashtoi krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe shkeljet e tjera të së drejtës ndërkombëtare që ishin pjesë e juridiksionit të TPNJ-së.⁴⁶³ Megjithatë, në korrik të vitit 2011, ky kufizim u hoq kur Parlamenti e miratoi të ashtuquajturin Interpretim autentik të Ligjit për Amnisti, përmes të cilit lejohet që të aplikohet amnisti për të gjitha rastet e kthyera në gjyqësorin e vendit nga TPNJ.⁴⁶⁴ Rasti Jama, që i referohej katër trupave të tre shqiptarëve nga Maqedonia e Veriut (Hajredin Halimi, Islam Veliu dhe Ibrahim Veliu) dhe një qytetari bullgar (Radoslav Badev) që ishin gjetur në një varr masiv në zonën Jama dhe që kishte ngecur në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit me vite të tëra, u përmbyll po ashtu me interpretimin autentik.⁴⁶⁵

Xhevdet Hajredini i përshkruan mirë dinamikat politike të vendimmarrjes prapa këtij vendimi: “Tribunali i Hagës i ktheu rastet këtu për tu gjykuar. Por në vend të kësaj, partitë e atëhershme në pushtet vendosën që interpretimi autentik i ligjit duhet t'i përfshijë edhe këto raste. Dhe inçizimet e publikuara tregojnë që VMRO-DPMNE e mbështeti ligjin në këmbim për BDI-në, partneri i tyre në koalicion në atë kohë, të mos kërkuar asgjë tjetër. Në incizime mund të dëgjohet Gruevski duke kërkuar që deputetët e VMRO-së të hyjnë dhe të sigurojnë kuorum, duke shtuar që të jemi rehat deri në fund të mandatit”. Dhe është e vërtetë, në atë periudhë BDI nuk paraqitën asnjë kërkesë tjetër. Por po, mendoj se ato raste është dashur të shkojnë në gjykatë sepse kur të ofrohet amnisti, nuk do të

460 Stanoeski, Oliver (2013) *Post-conflict Macedonia Transitional Justice: Conceptual Issue and Definition*. Shkup: Instituti për Demokraci. 107.

461 Qendra Ndërkombëtare Burimore e Drejtësisë (2021) “Boškoski & Tarčulovski (IT-04-82),” në dispozicion [këtu](#).

462 Stanoeski, op cit., 107.

463 Kulašić, Emina (2012) *Drejtësia Tranzicionale në Maqedoni dhe marrëdhëniet e saj me Demokracinë*. Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Politikëbërje, 4.

464 Po aty..

465 Stanoeski, op cit., 108.

thotë se ajo për të cilën je akuzuar nuk ka ndodhur kurrë”.⁴⁶⁶ Në shumë mënyra, është pikërisht pika e fundit që ka qenë pengesë në ballafaqimin e shtetit me konfliktin e armatosur të vitit 2001 pasi që interpretimi autentik i Ligjit për Amnisti në mënyrë efektive e bëri të pamundur që viktimat të marrin drejtësi dhe që të dëshmohet çfarëdo përgjegjësie.

LIGJI PËR VETERANË DHE NISMAT E NGJASHME

Proceset e çarmatosjes, demobilizimit dhe riintegrit (ÇDR) zakonisht janë përbërës kyç në shoqëritë në rimëkëmbje nga konfliktet e armatosura. Përderisa dy të parat – çarmatosja dhe demobilizimi – ishin të përfshira në tekstin e MKO-së në lidhje me luftëtarët e UÇK-së, riintegrimi i atyre që morën pjesë në konfliktin e armatosur në cilëndo anë nuk u mor parasysh në kohën e nënshkrimit. Pas dy dekadash, i ashtuquajti Ligji për Mbrojtësit, sado i kufizuar që është, mbetet përpjekja e vetme në nivel shtetëror për riintegrimin e një numri të vogël të veteranëve të ish-forcave të sigurisë. Ndërkohë, disa veteranë të UÇK-së të afërt me BDI-në janë punësuar nga institucionet shtetërore. Megjithatë, mungesa e përpjekjeve shtetërore për riintegrim⁴⁶⁷ mbetet mangësi serioze dhe në qendër të kërkesave themelore të grupeve të ndryshme të veteranëve. Në shumë mënyra, për riintegrimin e veteranëve nevojitet një formë e ballafaqimit me të kaluarën lidhur me mënyrën se si trajtohen luftëtarët e UÇK-së nga ligji dhe shteti.

Siç u përmend në kapitujt e mëhershëm, Ligji për të Drejtat e veçanta të anëtarëve të forcave të sigurisë shtetërore dhe familjarëve të tyre u miratua në vitin 2002, me amendamente në vitin 2003, 2004 dhe 2007. Ligji përqendrohet në rend të parë në veteranët invalidë, familjet e tyre dhe familjet e anëtarëve të rënë të forcave të sigurisë. Ligji garanton të drejta të caktuara lidhur me punësimin, strehimin, benefitet e njëhershme me para të gatshme, arsimin dhe pensionet familjare.⁴⁶⁸ Të drejtat e atyre veteranëve që nuk janë invalidë kufizohen me trajtim preferencial në punësimin publik dhe qasje në arsimin e lartë falas. Veteranët e UÇK-së nuk përfshihen në Ligj, siç u shpjegua më sipër.

Janë ndërmarrë disa nisma të reja ligjore lidhur me veteranët. Këtu hyn nisma e vitit 2008 nga shoqata e veteranëve *Dinjiteti (Dostoinstvo)*,⁴⁶⁹ e cila propozoi një ligj që përfshin dispozita për shërbime shëndetësore falas dhe përjashtim nga pagesat e përbashkëta për të gjithë anëtarët e forcave të sigurisë që morën pjesë në konfliktin e armatosur të vitit 2001, mundësinë e pensionimit pesë vite më herët dhe njohjen e shërbimit të rezervistëve si kohë e dyfishtë. Në vitin 2010, një numër deputetësh, të udhëhequr nga Abedin Zymberi dhe Daut Rexhepi, e propozuan një ligj për ushtarët e UÇK-së të hartuar sipas Ligjit ekzistues të vitit 2002 për anëtarët e forcave të armatosura, por përfshinë edhe dispozita për familjet e viktimave civile.⁴⁷⁰ Një nismë tjetër në vitin 2012 propozoi një ligj që në masë të madhe përfshinte kërkesat e *Dinjitetit* të vitit 2008, shtoi të drejta të reja dhe i qartësoi më tutje kushtet për t'i kërkuar të drejtat e garantuara me Ligjin e 2002-tës.⁴⁷¹ Asnjëra prej këtyre nismave nuk është miratuar nga Parlamenti, as nuk kanë qenë të suksesshme në nxitjen e një diskutimi më të gjerë social që do të kërkonte ballafaqimin me të kaluarën.

466 Intervistë me Xhevdet Hajredinin.

467 Ka pasur disa përpjekje të kufizuara dhe me fokus të vogël nga organizatat e shoqërisë civile në këtë aspekt. Për shembull, projekti i vitit 2007 i Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar punoi me 600 veteranë nga të dyja palët për zhvillimin e gjuhës angleze dhe shkathtësive të tyre kompjuterike, përshkrimi mund të gjendet këtu [origjinali në maqedonisht].

468 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, op cit.

469 Krzhalovski, op cit. 5.

470 Po aty..

471 Po aty..., 6.

PËRKUJTIMI PËRMES MONUMENTEVE

Deri më sot, nuk ka monumente të financuara nga shteti posaçërisht për konfliktin e armatosur të vitit 2001, por ka pasur përpjekje të konsiderueshme – kryesisht nga individë, grupe njerëzish, organizata dhe shoqata të ndryshme dhe autoritetet lokale – për t'i përkujtuar të vrarët në vitin 2001 përmes monumenteve. Një monument me rëndësi i dedikuar pjesëtarëve të forcave të sigurisë të vitit 2001 u vendos përballë Parlamentit, në komunën Centar (Qendër) në kryeqytet, në vitin 2011. Përveç kësaj, në pjesë të ndryshme të vendit ka monumente të dedikuara për të vrarët në konfliktin e armatosur. Pozicionimi i monumenteve pothuajse gjithmonë duke ndjekur një formë të hapësirës etnike,⁴⁷² ku monumentet e pjesëtarëve të forcave të sigurisë gjenden në zonat me shumicë maqedonase dhe monumentet e pjesëtarëve të UÇK-së në zonat me shumicë shqiptare. Për shembull, në Nepreshten janë dy monumente – në pjesën e ashtuquajtur shqiptare të fshatit është një monument i ngritur në vitin 2002 për dy burra shqiptarë të vrarë në luftimin mes UÇK-së dhe policisë, përderisa në pjesën e ashtuquajtur maqedonase të fshatit u ngrit një monument në vitin 2014 për katër maqedonasit e kidnapuar, Krsto Gogovski, Stojan Mihajlovski, Vasko Mihajlovski dhe Cvetko Mihajlovski.⁴⁷³ Ka pasur raste të rralla kur janë kaluar këto dy vija të kufizimit simbolik. Për shembull, pllaka përkujtimore për rezervistët e vrarë në pritë në Karpallak i përkujton kryesisht viktimat maqedonase në një zonë me shumicë shqiptare. Megjithatë, kjo pllakë shpesh shkatërrohet ose hiqet dhe askush nuk jep përgjegjësi.

Përveç monumenteve për viktimat (ose siç i quajnë ushtarët e UÇK-së, martirët), kanë qenë disa përpjekje nga BDI-ja, veçanërisht, për ta përkujtuar konfliktin e armatosur të 2001-tës më gjerësisht. Për t'i përmendur vetëm dy shembuj, në vitin 2008 në komunën Çair të kryeqytetit, BDI-ja hapi Muzeun e Lirisë, i cili e vendos konfliktin e armatosur të vitit 2001 në luftën më të gjerë për të drejtat e popullit shqiptar.⁴⁷⁴ Dhe në vitin 2021, udhëheqësi i BDI-së, Ali Ahmeti, premtoi që një monument që është pritur gjatë për gratë, nënat dhe motrat shqiptare të komunës së Likovës do të përfundonte në nëntor të vitit 2021.⁴⁷⁵

Kohët e fundit, ka qenë një tendencë që institucionet fetare të bëhen aktive në përkujtime, me ç'rast disa kanë kushtuar një pllakatë përkujtimore apo madje kanë ndërtuar vende lutjeje për t'i nderuar viktimat e vitit 2001. Një shembull i tillë është xhamia që po ndërtohet aktualisht në Mateç, kushtuar dëshmorëve të vitit 2001.⁴⁷⁶

Nuk ekziston një regjistër zyrtar i monumenteve përkujtimore kushtuar konfliktit të vitit 2001, prandaj nuk dihet numri i saktë, por provat anekdotale sugjerojnë që është një numër i konsiderueshëm. Aksioni Paqësor është duke hartëzuar jo vetëm monumentet përfundon në vend por edhe mbishkrimet në to dhe pritet të përfundojnë diku në vitin 2022.

PUNA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

Një nismë që ka tërhequr vëmendjen më të madhe të publikut sa i përket ballafaqimit me të kaluarën

472 Shih Stavrevska, Elena (2016) 'Space, Class and Peace: Spatial Governmentality in Postwar Bosnia and Herzegovina'. In *Spatialising Peace and Conflict: Mapping the Production of Places, Sites and Scales of Violence*, eds. Annika Björkdahl dhe Susanne Buckley-Zistel, 141–158. London: Palgrave Macmillan.

473 Toevski, Sveto (2013) "Monumentet e ndarjes së re", *DW*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

474 Vreme (2008) "Hapet muzeu i UÇK-së", 29 nëntor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

475 Kanal 5 TV (2021) "Ahmeti në Sllupçan: Sot është ditë e veçantë, duhet t'i nderojmë të gjithë luftëtarët e rënë", 2 maj, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

476 Bfi.mk (2021) "Themelimi i Xhamisë "Martirët e vitit 2001" vendoet në Mateç, Kumanovë", 6 qershor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në shqipe].

është që një komision rajonal t'i përcaktojë faktet rreth krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në ish-Jugosllavi nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001, e njohur si Nisma për RECOM.⁴⁷⁷ Koalicioni për Komisionin Rajonal (RECOM), një rrjet i organizatave të shoqërisë civile nga zonat pas Jugosllavisë, u lansua në vitin 2008 dhe u shtri edhe në Maqedoni në vitin 2009, ku Aksioni Paqësor ishte koordinator i punës së Koalicionit në vend dhe Boro Kitanoski u bë koordinatori i parë kombëtar.⁴⁷⁸ Në qershor të vitit 2011, kur Koalicioni për Asamblenë e RECOM-it e miratoi statutin e Komisionit të ardhshëm të RECOM-it, Aksioni Paqësor kishte themeluar një rrjet të fuqishëm partnerësh në vend – duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e personave të prekur nga konflikti i armatosur dhe individët, organizuan një konsultim kombëtar dhe dy konsultime rajonale mbi statutin e RECOM-it dhe koordinuan pjesëmarrjen e delegacioneve në konsultimet jashtë vendit.⁴⁷⁹

Nisma për RECOM-in i dha paksa dukshmëri nevojës për tu ballafaquar me të kaluarën e vendit. Siç thotë Kitanoski, “Edhe pse Maqedonia ishte mjaft e parëndësishme në kornizën rajonale, RECOM-i dukej si një mundësi për të bërë një punë të nevojshme këtu në shtëpi”.⁴⁸⁰ Në fakt, disa prej të intervistuarve të kontaktuar për këtë studim, duke përfshirë disa veteranë, e lavdëruan nismën për të krijuar hapësirë për të diskutuar rreth temave të vështira. Në vitin 2011, Nisma e ndryshoi qasjen, duke i përzgjedhur të ashtuquajturit avokues publik, një për çdo shtet, të cilët supozohet të llojnë tek kryetarët e shteteve për ta mbështetur themelimin e RECOM-it. Kjo e ka ndryshuar natyrën e aktiviteteve në Maqedoninë e Veriut dhe, në disa mënyra, e ka kufizuar fushëveprimin. Në shtator të vitit 2021, i financuar përmes instrumenteve të BE-së për politika të huaja, Rrjeti RECOM e hapi thirrjen për organizatat e shoqërisë civile për të paraqitur propozime për projekte të vogla që kontribuojnë në drejtësinë tranzicionale, ndërtimin e besimit dhe pajtimin rajonal.⁴⁸¹

Përveç RECOM-it, një numër i vogël i organizatave të shoqërisë civile kanë punuar në fushën e arsimit mbi paqen dhe zgjidhjen e konflikteve. Këtu hynë Aksioni Paqësor (Prilep/Tetovë), Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhje të Konflikteve (Shkup), Qendra për Aksion Jo të dhunshëm (Beograd/Sarajevë), Qendra për Bashkëpunim Ballkanik LOJA (Tetovë), Qendra Maqedonase për Arsim Civil (Shkup) dhe Ambasada e Parë e Fëmijëve Megjashi (Shkup). Për më shumë se një dekadë, KURVE Wustrow, Qendra për Trajnim dhe Rrjetëzim në Aksione Jo të Dhunshme, ka ofruar mbështetje për projektet që përqendrohen në ndërtimin e paqes dhe ballafaqimin me të kaluarën në Republikën e Maqedonisë së Veriut si pjesë e programit të Shërbimit Civil të Paqes të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Vëmendja e shumicës prej tyre ka qenë në punën me mësimmëdhënësit, nxënësit dhe shkollat për zhvillimin e ndjeshmërive të nevojshme për zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes.⁴⁸² Megjithatë, Aksioni Paqësor dallohet si organizata e vetme që përqendrohet më së shumti në ballafaqimin me të kaluarën dhe konfliktin e armatosur të vitit 2001.

Ashtu si trajnimet e tyre, të cilat sipas çdo të intervistuarit që ka marrë pjesë në to, kanë qenë jashtëzakonisht efektive, Aksioni Paqësor është poashtu organizata e parë në vend që ka filluar të

477 Rrjeti i Pajtitimit RECOM (2021), “Rreth RECOM,” në dispozicion [këtu](#).

478 Intervistë me Boro Kitanoskin, Zoom, 22 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

479 Stojcevski, Predrag (2013) “Nisma për RECOM mes dy çështjeve të ‘Otvoreno’”, në dispozicion [këtu](#) [origjinal i në maqedonishte].

480 Intervistë me Boro Kitanoskin.

481 Rrjeti i Pajtitimit RECOM (2021) “Thirrje për Hapje të Vogla,” 1 shtator, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonisht].

482 Intervistë me Safet Balazhin, Skype, 12 prill 2021; Intervistë me Ana Bitoljanun, Zoom, 21 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

krijohë regjistër të historive gojore të konfliktit të armatosur, që filloi në vitin 2008. Në shumë raste, si në fshatrat e Maleve të Sharrit në veriperëndim të vendit, intervistuesit e Aksionit Paqësor ishin të parët që i dëgjuan historitë dhe përvojat e të prekurve nga konflikti i armatosur.⁴⁸³ Si pjesë e procesit, intervistuesit e trajnuar mbledhin përvoja për të cilat asnjëherë nuk u janë bërë pyetje dhe që theksojnë aspekte të konfliktit të armatosur të cilat përndryshe do të kishin mbetur të padukshme në sferën publike. Këto përvoja përfshijnë ato të personave që jetojnë në fshatrat ku ndodhën luftimet, të grave të prekura nga konflikti i armatosur, të personave të zhvendosur brenda vendit, veteranëve, anëtarëve të pakicave më të vogla etnike e të tjera. Në këtë kuptim, librat e historisë gojore dhe promovimet e tyre ofrojnë një mundësi që njerëzit të paktën të fillojnë të mendojnë për atë që ndodhi në vitin 2001. Deri më tani, ndikimi i regjistrimit ka qenë së paku i dyfishtë. Në njërin anë, në një kontekst ku konflikti i armatosur i vitit 2001 nuk mësohet në shkolla ose nuk diskutohet në publik, publikimet elektronike të historisë gojore kanë ofruar materiale të veçanta për ata që janë të interesuar të mësojnë për këtë pjesë të historisë së vendit. Në këtë drejtim, regjistri ka qenë i paçmueshëm edhe për hulumtuesit. Njëkohësisht, historitë gojore kanë pasur një ndikim përmes organizimeve të promovimeve të publikimeve, ku është krijuar një hapësirë ku fqinjët mund t'i dëgjojnë përvojat e 'të tjerëve', ku veteranët nga palët e ndryshme mund të takohen me njëri-tjetrin dhe ku ngjashmëritë në përjetime mund të njihen përtej ndasive etnike.

Së fundmi, ekipi i Aksionit Paqësor ka bashkëpunuar me Shoqatën e Mësimdhënësve të Historisë të Maqedonisë duke punuar me mësimdhënësit e historisë për projektin e historisë së përbashkët Interpretimi i Historisë Bashkëkohore.⁴⁸⁴ Si pjesë e projektit, mësimdhënësit e historisë dhe ekipi i Aksionit Paqësor kanë mbajtur pilot-orë të historisë me grupe të përziera nxënësish, një udhëzues për aktivitete jashtëkurrikulare të historisë për nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme dhe një analizë të përdorur për modernizimin e librave shkollorë të historisë.⁴⁸⁵ Këto përpjekje vijnë në kontekstin kur konflikti i armatosur i vitit 2001 nuk përmendet fare në librat shkollorë dhe nxënësit e kombësive të ndryshme mësojnë histori të ndryshme. Në këtë kuptim, puna me mësimdhënësit e historisë, dhe mësimdhënësit më gjerësisht, është një kontribut i rëndësishëm në ballafaqimin me të kaluarën.

3.4 Diskursi i përgjithshëm rreth konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut

Viti 2021 shënon 20 vjetorin e konfliktit të armatosur të vitit 2001. Megjithatë, edhe pse kanë kaluar dy dekada, ka fare pak diskurs kombëtarë të dukshëm lidhur me atë që ka ndodhur, rrethanat që çuan në të, ose pasojat e tij. Konflikti i armatosur i vitit 2001 mungon plotësisht në kurrikulën shkollorë dhe nuk përmendet as në librat shkollorë të edukatës qytetare as të historisë. Mungesa e diskursit kombëtar rreth konfliktit të armatosur reflektohet dhe në njëfarë mase është rezultat i dhjetëra dinamikave të ndërlidhura.

Dinamika e parë është diskursi i elitave politike ose liderëve politikë rreth konfliktit të armatosur. Në disa mënyra, në nivel kombëtar ajo pjesë e historisë gjerësisht konsiderohet të ketë përfunduar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Elitat politike supozojnë se nuk nevojitet më shumë diskutim rreth asaj që i parapriu Marrëveshjes ose çfarë e bëri të nevojshme. Për shembull, në festimet e Ditës

483 Intervistë me Fllanza Jusufi Salju, Zoom, 23 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

484 Intervistë me Goran Taleskin, Zoom, 23 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

485 Po aty..

së Pavarësisë në vitin 2020, Kryeministri i atëhershëm Zaev theksoi që konflikti i armatosur i vitit 2001 “ka përfunduar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit [përmes së cilës] të gjithë akterët e përfshirë [...] morën përgjegjësi në emër të së ardhmes së përbashkët”.⁴⁸⁶ Ngjashëm, para disa vitesh në vitin 2018, në përvjetorin e 17-të të nënshkrimit të MKO-së, Ali Ahmeti, lider i BDI-së që ishte pjesë e koalicionit qeverisës, e quajti vendin dhe MKO-në “shembull të zgjidhjes së konfliktit të armatosur” dhe të transformimit të situatave të konfliktit të armatosur në dialog”.⁴⁸⁷

Është e vështirë të gjenden deklarata nga liderët politikë që janë sot në pushtet të cilat përqendrohen vetëm në konfliktin e armatosur ose që e shpëtojnë konfliktin e armatosur nga MKO-ja. Në fakt, shumica e deklaratave e trajtojnë konfliktin e armatosur si një ngjarje që çoi në MKO-në, e cila pastaj ka ofruar një bazë që shteti të ndërtonte “demokracinë e tij funksionale multietnike dhe multikulturore”, sipas Ministrit Osmani.⁴⁸⁸ Megjithatë, një formësim i tillë lejon që konflikti i armatosur të shikohet pa vazhdimësi historike dhe pa njohje të ngjarjeve, dinamikave dhe shtypjeve që kontribuon drejt tij. Është po aq i rëndësishëm fakti që ai lejon që konflikti i armatosur dhe arsyet prapa tij të portretizohen si diçka e trajtuar dhe e përmbyllur me nënshkrimin e MKO-së, përderisa ata që u prekën drejtpërdrejt nga ai ende vuajnë nga ndikimi i tij. Kjo pastaj e fsheh nevojën për nismat ku diskutohet konflikti i armatosur, pasojat e tij dhe madje lidhja mes zbatimit të MKO-së dhe zgjidhjes së konfliktit të armatosur.

Dinamika e dytë dhe e ndërlidhur me të është ekzistenca e dy narrativave të ndara dhe kundërtë në nivelin e grupeve etnike, në radhë të parë shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë, edhe pse vetë grupet nuk janë aspak homogjene ose të bashkuara rreth këtyre narrativave. Narrativat janë po ashtu të ndryshme në kohë. Ndërkohë që narrativa në mesin e shqiptarëve etnikë fillon në ditët e Jugosllavisë, zakonisht në vitet e 1960-1970-ta dhe me shtypjen, diskriminimin dhe format e ndryshme të dhunës së asaj kohe, narrativa në mesin e maqedonasve etnikë zakonisht fillon në vitin 2001. Në këtë kontekst, narrativa mes maqedonasve etnikë që konflikti i armatosur eskaloi nga Kosova dhe kishte të bënte me kontrollin e territorit, ku grupet guerile synuan ta kërcënonin integritetin e vendit, madje edhe ta krijonin një “Shqipëri të madhe”, mbetet dukshëm e pranishme.⁴⁸⁹ Komunikatat fillestare të UÇK-së, duke filluar me një në fund të janarit në vitin 2001, ku ata pretendojnë se qëllimi i tyre është çlirimi i shqiptarëve etnikë në Maqedoni, shpesh përdoren si dëshmi për ta mbështetur këtë tregim. Megjithatë, diskursi i UÇK-së ka ndryshuar nga marsi i vitit 2001, kur ata deklaruan se qëllimi i tyre ishte të siguronin të drejta kushtetuese dhe barazi për shqiptarët etnikë brenda kufijve ekzistues të Maqedonisë.⁴⁹⁰ Në kontekstin e narrativës së mësipërme në mesin e maqedonasve etnikë, dhe duke e ndjekur një logjikë që konflikti i armatosur kishte të bënte me kontroll territorial,

486 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2020) “Kryeministri Zaev në festën me rastin e Ditës së Pavarësisë: Është realizuar ëndrra e të gjitha gjeneratave të mëparshme për shtet të pavarur dhe të lirë, sot 29 vjet nga shpallja e Pavarësisë, atdheu ynë ka më shumë miq”, 8 shtator, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

487 Fazlagic, Admir (2018) “Marrëveshja e Ohrit vendosi besimin ndërmjet bashkësive etnike në Maqedoni”, *Anadolu Agency*, 13 gusht, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonishte].

488 Po aty..

489 Asani Memishi, Shpresa (2021) *Zgjidhja e konfliktit të armatosur të vitit 2001 në mesin e bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare*, Tema e magjistraturës e pabotuar, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, Shkup [origjinali në maqedonisht], 80–93; Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve (2005), *Kuptimi i historisë aktuale: Konflikti i armatosur në territorin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2001*, Shkup [origjinali në maqedonisht], 2.

490 Ackermann, Alice (2002) “On the Razor’s Edge: Macedonia Ten Years after Independence.” In IFSH (eds.), *OSCE Yearbook 2001*, Baden-Baden, 117–135, 119.

UÇK-ja ende referohet si terroriste dhe forcat e sigurisë si mbrojtës (*braniteli*, në maqedonisht).⁴⁹¹ Nënshkrimi i MKO-së brenda kësaj narrative, edhe mes atyre që e pranojnë se ajo që nxiti konfliktin e armatosur ishte një luftë për disa të drejta, shihet më pas si një formë «kapitullimi»,⁴⁹² si e padrejtë për maqedonasit etnikë, e shkaktuar përmes forcës dhe presionit nga bashkësia ndërkombëtare dhe dhënies së shqiptarëve etnikë statusin e “popullit të dytë konstituiv në vend dhe një mundësi për federalizim në të ardhmen”.⁴⁹³

Në anën tjetër, narrativa dominuese në mesin e popullsisë etnike shqiptare të vendit është që konflikti i armatosur, ose “lufta” siç e quajnë shumica prej tyre, u luftua për të drejtat elementare të njeriut. Kjo narrative e lidhë konfliktin e armatosur të vitit 2001 me një histori më të gjatë të diskriminimit dhe shtypjes së shqiptarëve etnikë, që u intensifikua pas shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë. Këtu përfshihet shtypja nga policia; përjashtimi nga shoqëria; përpjekjet për asimilimin e shqiptarëve, duke përfshirë mungesën e mundësisë për tu arsimuar në gjuhën shqipe; pjesëmarrjen e vogël të shqiptarëve në institucionet shtetërore, kryesisht në punë që paguhen pak; dhe privatizimi i kapitalit në periudhën e tranzicionit.⁴⁹⁴ Në mënyrë kritike, në këtë narrative, “armiku” nuk janë maqedonasit etnikë, por institucionet. Ose, siç e thotë Abedin Zymeri, veteran i UÇK-së: “konflikti i armatosur nuk u luftua kundër popullit, por kundër institucioneve sepse ndiheshim të diskriminuar”.⁴⁹⁵ Në kontekstin e kësaj narrative, MKO-ja paraqet realizimin e dëshirës së shqiptarëve etnikë për ta fituar statusin e barabartë në vend dhe një bazë të mirë për paqe dhe stabilitet.⁴⁹⁶

Çështja e dy narrativave të ndara dhe përkujtimi i ndarë, madje edhe kundërthënës, i konfliktit të armatosur të vitit 2001 përshkruhet në mënyrë prekëse nga Lura Pollozhani, hulumtuese e cila ishte fëmijë që jetonte në Strugë gjatë konfliktit të armatosur: “Kur flas me miqtë e mi shqiptarë, të gjithë mund të pajtohem që 2001 ishte një konflikt i armatosur dhe i tmerrshëm por, në fund, çoi në emancipim më të madh. Nuk flasim shumë për viktimat por për lavditë. Pastaj, një ditë kur isha në Kumanovë me disa prej shoqeve të mia maqedonase, duke përfshirë një shoqe babai i së cilës kishte qenë në ushtri në atë kohë, ato folën për 2001-tën [...] nga një këndvështrim krejt tjetër, një që nuk e kisha dëgjuar kurrë deri në moshën 27-28 vjeçare. Dhe unë isha fëmijë gjatë konfliktit të armatosur. Kjo më tregoi se sa të ndara i kemi ndërtuar kujtimet tona. Mezi e kuptova për çfarë e kishin fjalën. Mendoj se nga ana maqedonase nuk e kuptojnë se çfarë çoi në 2001-tën, për pabarazitë që çuan në atë lloj frustrimi. Kuptimi i atyre gjërave nuk ka të bëjë me fituesit apo humbësit. 2001-ta krijoi lloje të ndryshme të traumave për njerëz të ndryshme, prandaj është kaq e rëndësishme t’i bëjmë këto biseda”.⁴⁹⁷

Dinamika e tretë dhe e fundit që kontribuon dhe njëkohësisht e ilustron mungesën e diskursit kombëtar për konfliktin e armatosur të vitit 2001 është padukshmëria e kësaj teme në hapësirën më të gjerë publike, duke përfshirë edhe mediat. Diskutimet publike rreth konfliktit të armatosur, të organizuara zakonisht nga një numër i vogël i organizatave të shoqërisë civile, nismave dhe fondacioneve – duke përfshirë Aksionin Paqësor, Nismën për RECOM dhe Fondacionin Shoqëria e Hapur – ishin sporadike

491 Komiteti i Helsinkit dhe Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhje të Konfliktit, op cit., 2.

492 Asani Memishi, op cit. 91.

493 Komiteti i Helsinkit dhe Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhje të Konfliktit, op cit., 7.

494 Komiteti i Helsinkit dhe Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhje të Konfliktit, op cit., 2.

495 Intervistë me Abedin Zymerin, Viber, 14 prill 2021. Intervista dhe përkthimi: Elena Stavrevska.

496 Komiteti i Helsinkit dhe Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhje të Konfliktit, op cit., 7; Asani Memishi, op cit., 93-106.

497 Intervistë me Lura Pollozhanin, Google Meet, 20 prill 2021. Intervista: Elena Stavrevska.

edhe pas konfliktit të armatosur, e lëre më më vonë.⁴⁹⁸ Njëzet vite më vonë, një kërkim i thjeshtë në lajmet (përmbledhësit) më të mëdhenj të vendit⁴⁹⁹ zbulon se konflikti i armatosur përmendet në hapësirën publike në rend të parë gjatë shënimit të ngjarjeve të caktuara, siç është fillimi i konfliktit të armatosur, disa aksione ushtarake, disa masakra dhe vrasje dhe nënshkrimi i MKO-së. Edhe atëherë, konflikti i armatosur raportohet si lajm për përkujtim, me fragmente nga deklaratat e përfaqësuesve politikë ose familjet e viktimave, por pa një kontekst ose shpjegim më të gjerë për vetë konfliktin e armatosur.⁵⁰⁰ Lajmet e tilla jepen zakonisht në media mes janarit dhe gushtit, muajt gjatë të cilëve u zhvillua konflikti i armatosur i vitit 2001.

Kohë pas kohe, paraqiten disa përjashtime të dukshme në formën e storjeve më të gjata të raportimit për konfliktin e armatosur që japin kontekst, përfshijnë pjesë të përvojave të gjalla të të prekurve dhe reflektojnë mbi situatën aktuale. Këto storje në njëfarë mase kontribuojnë në plotësimin e zbrazëtisë në hapësirën publike sa i përket diskursit për konfliktin e armatosur të vitit 2001, por ato janë të pakta dhe të rralla.⁵⁰¹ Përveç tyre, siç u tha më sipër, publikimet dhe promovimet që i bëjnë organizatat e shoqërisë civile – siç është Aksioni Paqësor,⁵⁰² Forumi i Shërbimit Civil për Paqe⁵⁰³ dhe CIVIL – Qendra për Liri,⁵⁰⁴ për historitë gojore të personave të prekur nga konflikti i armatosur i vitit 2001 ose për tema që kanë të bëjnë me ballafaqimin me të kaluarën përbëjnë raste të rralla kur konflikti i armatosur diskutohet në sferën publike.

Duke i marrë parasysh së bashku, këto tri dinamika tregojnë një mungesë të diskursit të përgjithshëm kombëtar dhe nevojës së ndërlidhur për diskutim publik në nivel kombëtar për konfliktin e armatosur të vitit 2001, i cili pastaj mund të përkthehet në politika specifike dhe politikë që kontribuon në krijimin e një shoqërie të drejtë dhe paqësore.

498 Shih, për shembull: Fondacioni i Institutit Shoqëria e Hapur (2010) *Historia dhe Apokrifja – Demitologjizimi i 2001-tës: Debat*, Shkup, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonisht].

499 Si paralajmërues kritik, www.time.mk mbledh vetëm lajme të publikuara në maqedonisht.

500 Për t'i përmendur vetëm disa shembuj nga viti 2021: Kanal 5 TV, op cit.; Shërbimi Mediatik Maqedonas, op cit.; Vučevska, op cit., Trajkoski, Dejan (2021) "20 vite nga beteja për çlirimin e Haračinës", Kanal 5 TV, 23 qershor, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonisht].

501 Për shembull, shih Marusic, Sinisa Jakov (2021) "Pasojat e konfliktit të armatosur në Maqedoninë e Veriut ndihen edhe njëzet vite më pas", *BIRN Skopje*, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonisht]; Ber, Andrea (2020) "Maqedonia e Veriut – emër i ri, konflikte të vjetra të armatosura", *DW*, në dispozicion [këtu](#) [përkthimi në maqedonisht].

502 Aksioni Paqësor (2021), Publikimet e historive gojore, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonisht dhe shqip].

503 Stojanov, Darko, Kocevka, Jana, Reçica, Vlorë, Bernhardt, Daniel, Ashtalkovska Gajtanoska, Ana dhe Jakimovska, Ilina (2019) *Revisiting 2001*, Shkup: Forumi Civil për shërbimin e paqes (forumi ZFD), në dispozicion [këtu](#).

504 Deralla, Xhabir dhe Schoenefeld, Kirsten (2016) *Ballafaqimi me realitetin: Kujtimi i të kaluarës – formësimi i të ardhmes*, Shkup: CIVIL Qendra për Liri, në dispozicion [këtu](#) [origjinali në maqedonisht].





Mos HARO TA

Gushishish
Kollëp

Leta të sjiell befas

"MOUTANA II"

Një burrë rom duke ecur nëpër një rrugë në Tetovë, tregon historinë e tij të zhvendosjes nga lufta e vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut. Foto nga: Arbnora Memeti, 2022

Përfundimet

Studimet e të trija vendeve kanë treguar se edhe pas më shumë se 20 viteve që nga luftërat e shpërbërjes së Jugosllavisë, luftës së Kosovës të vitit 1998-1999 dhe konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut, shumë viktime dhe grupe të tjera të prekura nga konflikti ende orvaten me trashëgiminë e lënë nga e kaluara e dhunshme dhe mënyrat se si shoqëria e trajton ose nuk e trajton atë. Ka dallime të mëdha midis këtyre tri vendeve për sa i përket mënyrave specifike në të cilat u zhvilluan konfliktet, si përfunduan ato dhe si është trajtuar historia e tyre e dhunshme. Megjithatë, mënyrat në të cilat viktimat dhe të mbijetuarit janë trajtuar nga qeveritë e tyre përkatëse ose nga shoqëria më e gjerë ndërlidhen fort me mënyrën se si e kaluara e dhunshme njihet, kujtohet dhe tregohet nga politikanët dhe rregullohet nga institucionet zyrtare. Si rezultat, shumica e viktimave në të tre vendet janë ende duke kërkuar kompensime, të vërtetën, drejtësinë dhe njohjen sociale. Shumica përjetojnë vështirësi serioze socio-ekonomike, përballen me pengesa në përbushjen e të drejtave të tyre dhe përballen me traumat e pasluftës.

Në Serbi, të gjitha viktimat civile të luftës dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut në lidhje me luftën mbeten të neglizhuara politikisht, socialisht dhe ekonomikisht. Narrativa zyrtare, veçanërisht gjatë dekadës së fundit, është se Serbia nuk mori pjesë në luftërat e viteve 1990, roli i saj i vetëm ishte mbrojtja e popullit serb, por se ajo vuajti më së shumti dhe u ndëshkua më së rëndi nga bashkësia ndërkombëtare. Të gjitha veprimet e shtetit në lidhje me të kaluarën e kohës së luftës së vendit ruajnë narrativën e viktimizimit serb. Përkujtimet zyrtare ndjekin këtë linjë duke përkujtuar vetëm sulmet ndaj serbëve, duke neglizhuar viktimat joserbe dhe duke krijuar një version të njëanshëm etnocentrik të luftës. Ka një ngecje të madhe në trajtimin e krimeve të luftës në familje, ndërsa kriminelët e luftës të liruar rehabilitohen dhe paraqiten si heronj kombëtarë. Ky proces i falsifikimit të historisë udhëhiqet nga partia politike në pushtet dhe mbështetet nga media (shtetërore) dhe sistemi i arsimit formal.

Ligji serb njih si viktime veteranët dhe invalidët e luftës, viktimat civile (të vrarë ose të zhdukur) dhe invalidët civilë dhe familjet e tyre si viktime, së bashku me refugjatët dhe personat e zhvendosur. Megjithatë, vetëm serbët etnikë kanë të drejtë sipas këtyre kritereve. Ligji diskriminon kategoritë e tjera të viktimave. Dhuna seksuale e lidhur me luftën nuk njihet fare dhe kjo çështje ka marrë pak vëmendje në rastet e krimeve të luftës. Viktimat e krimeve të kryera pas 20 qershorit 1999, përfshirë serbët, nuk njihen as nga Serbia dhe as nga Kosova. Ata janë shembulli më i qartë se shumë viktime mbeten ende peng i interesave politike.

Në përgjithësi, diskursi kombëtar i Serbisë për të kaluarën e luftës është kryesisht ushtarak dhe mashkullor, duke i lartësuar fitoret ushtarake mbi viktimat civile dhe heroizmin e burrave mbi vuajtjet e grave – pavarësisht se gratë përbëjnë një përqindje të lartë të viktimave. Çdo dëshmi e përgjegjesisë së Serbisë për krimet e kryera fshihet sistematikisht nga institucionet. Viktimave serbe pothuajse nuk u jepet fare hapësirë pasi kujtesa publike dominohet nga politikanët dhe institucionet. Përvojat e grave nga lufta dhe vuajtjet e joserbëve mungojnë plotësisht në këtë diskurs zyrtar. Brenda këtij ligjërimi të politizuar, përjashtues dhe militarist, viktimat e kanë të vështirë ta ndjekin misionin e tyre dhe t'i adresojnë nevojat e tyre.

Në Maqedoninë e Veriut, konflikti i armatosur i vitit 2001 përfundoi zyrtarisht me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO), e cila solli ndryshime në kornizën kushtetuese, ligjore dhe

institucionale të vendit dhe adresoi disa ankesa thelbësore të pakicave shqiptare dhe të pakicave të tjera etnike. Ndonëse kjo ka qenë e rëndësishme, nuk ka pasur asnjë përpjekje zyrtare shtetërore për ta përcaktuar origjinën dhe faktet e konfliktit të armatosur apo për t'u marrë në shoqëri me të kaluarën. Dështimi për të vendosur dhe diskutuar publikisht faktet historike për origjinën e konfliktit përforcon të kuptuarit e përgjithshëm në mesin e maqedonasve se ai ishte nxitur nga terroristët shqiptarë për kontroll territorial, ndërsa për popullatën shqiptare ishte një luftë për të drejtat themelore njerëzore, politike dhe kulturore. Përkujtimi bëhet nga qytetarët, organizatat e veteranëve dhe disa komuna dhe pasqyron të kuptuarit përjashtues, monoetnik të asaj që ndodhi.

TPNJ ndoqi penalisht një rast të krimeve të luftës. Krimet e tjera të supozuara të luftës u transferuan përsëri në gjykatat vendore dhe u amnistuan në vitin 2011, gjë që pengoi në mënyrë efektive vendosjen e përgjegjësisë ose gjetjen e drejtësisë nga viktimat. Elementet në ODA që duhet të kishin garantuar kthimin e sigurt të refugjatëve dhe PZHBV-ve nuk kanë qenë efektive për shkak të mungesës (së perceptuar) të sigurisë dhe numrit të shtëpive të shkatërruara ose të dëmtuara. Përveç veteranëve të forcave të sigurisë shtetërore dhe familjeve të tyre, viktimat dhe grupet e tjera të prekura nga konflikti nuk njihen me ligj dhe nuk kanë ku të drejtohen për mbështetje. Elitat politike e trajtojnë konfliktin e armatosur si një ngjarje që përfundoi me MKO, duke injoruar kontekstin e tij historik dhe ndikimin në grupet e prekura në shoqëri.

Mungesa e ndonjë gjetjeje dhe diskutimi kombëtar mbi konfliktin dhe mungesa e ligjeve apo iniciativave zyrtare që njohin viktimat dhe grupet e tjera të prekura nga konflikti, e kombinuar me faktin se krimet e supozuara të luftës janë amnistuar, e kanë bërë historinë e konfliktit të padukshme. Si rezultat, viktimat janë të padukshme dhe shoqëria në përgjithësi nuk ka mësuar për konfliktin dhe nuk është marrë me trashëgiminë e tij. Ka ekzistuar vetëm një pjesë të vogël të grupeve jozyrtare të viktimave, por edhe këto kanë pushuar së ekzistuari. Shoqatat e veteranëve, nga të dyja palët, mbeten aktive dhe relativisht të pranishme në domenin publik. Është interesante se janë pikërisht këto shoqata të veteranëve që poashtu duket se kanë njëfarë gatishmërie për një proces pajtimi.

Krahasuar me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, Kosova zhvilloi një kornizë të gjerë ligjore në lidhje me trajtimin e trashëgimive të luftës së viteve 1998–99, e cila preku pjesën më të madhe të popullsisë. Pas përfundimit të luftës, Kosova ishte nën administrimin e OKB-së, e cila u fokusua në ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe zhvillimin dhe reformën institucionale. Ka ende shumë punë për t'u bërë në ndjekjen penale të krimeve të luftës, dhe shumë familje të viktimave dhe personave të zhdukur kanë humbur besimin se do ta gjejnë ndonjëherë të vërtetën ose drejtësinë. Qeveritë e Kosovës dhe Serbisë janë ende në proces të normalizimit të marrëdhënieve, me ngecje të progresit në gjetjen e të zhdukurve dhe pa bashkëpunim për rastet e krimeve të luftës.

Kategoritë e gjera të viktimave të luftës njihen në ligjet që janë miratuar që nga viti 2010, por shumica i përjashtojnë viktimat joshqiptare. Sipas përfaqësimit zyrtar të periudhës së luftës, shqiptarët ishin luftëtarë të lirisë dhe forcat serbe autorët e vetëm të krimeve të rënda, duke mohuar vuajtjet e viktimave të krimeve të kryera nga UÇK-ja. Ashtu si në Serbi, dhe në vijë me normat patriarkale, periudha e luftës portretizohet përmes tregimeve dhe simboleve të luftëtarëve të fortë dhe heroizmit mashkullor, përmes memorialeve që janë kryesisht monoetnike dhe të ndërthurura me diskursin nacionalist. Mediat shpesh kontribuojnë në këtë tregim.

Në fillim, nuk u mor parasysh abuzimi seksual gjatë luftës pasi ishte temë tabu. Vetëm pas presionit nga shoqëria civile, viktimat e abuzimit seksual gjatë luftës u përfshinë si kategori zyrtare në ligj. Megjithatë, ende pak vëmendje i kushtohet përvojave më të gjera të grave gjatë dhe pas luftës.

Janë zhvilluar disa nisma qeveritare për t'u marrë me të kaluarën, por mungesa e vullnetit politik, kapacitetet dhe burimet e kufizuara institucionale, dhe politizimi i atyre nismave ka bërë që ato të kenë pak efekt në avancimin e së vërtetës, drejtësisë dhe pajtimit në Kosovë. Agjenda politike përçarëse dhe nacionaliste e elitës politike po e dëmton përkujtimin gjithëpërfshirës, ndërkohë që po i përforcon ndjenjat etnonacionaliste.

Në Serbi dhe Kosovë, shumë viktima kanë krijuar grupe joformale dhe formale. Shumica e tyre organizohen rreth një çështjeje të përbashkët dhe fokusohen në zgjidhjen e problemeve personale të anëtarëve, si gjetja e anëtarëve të humbur të familjes, ndjekja penale e atyre që janë përgjegjës për vdekjen e një anëtar të familjes, marrja e dëmshpërblimit, përmbushja e të drejtave pronësore, mbledhja e informacionit për viktimat dhe krimet, dhe përkujtimi i viktimave dhe përvjetorët. Disa ndajnë publikisht raporte dhe histori të viktimave, informojnë publikun për zhvillime të caktuara dhe avokojnë për masa të caktuara. Në Maqedoninë e Veriut kjo ka ndodhur deri në një masë, por meqenëse diskursi i përgjithshëm është se konflikti i armatosur është zgjidhur dhe MKO u zbatua në masë të madhe, dhe duke qenë se nuk kanë marrë asnjë njohje zyrtare, viktimat kryesisht vuajnë në heshtje.

Anëtarët e grupeve të viktimave zakonisht përpiqen ta mbështesin dhe të kujdesen për njëri-tjetrin, për shembull duke ofruar ndihmë humanitare për familjet më të cenueshme ose duke aranzhuar mbështetje ligjore. Grupi ose shoqata më e gjerë e viktimave zakonisht përfaqësohet nga disa individë të cilët janë vetë të prekur. Kjo do të thotë se ata shpesh shpenzojnë shumë energji dhe përkushtim, por puna e tyre mund të mos jetë gjithmonë e menduar mirë strategjikisht.

Disa shoqata (ombrellë) mbështeten financiarisht nga shteti ose donatorët, por shumica janë vullnetare. Duke qenë se janë të fokusuar në shqetësimet e tyre të drejtpërdrejta, ato nuk kanë hapësirë për të avokuar për drejtësinë tranzicionale në një kuptim më të gjerë shoqëror.

Edhe pse ka dallime specifike, viktimat e luftës dhe grupet e tjera të prekura në të tri vendet kanë nevoja të përbashkëta. Prioritetet përfshijnë:

- Zbulimi i së vërtetës për atë që ka ndodhur me të dashurit e vdekur ose të pagjetur
- Mbështetje ligjore për të kërkuar drejtësi për krimet e kryera kundër tyre ose familjeve të tyre
- Njohja e statusit të tyre si viktima, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike
- Mbështetja ekonomike për familjet e tyre, duke përfshirë qasjen në kujdesin shëndetësor
- Mbështetja psikologjike për adresimin e përvojave të tyre të kohës së luftës dhe "pikëllimin e vazhdueshëm"
- përkujtimi i së kaluarës, përfshirë këtu nëpërmjet historive gojore, për t'i ruajtur njohuritë dhe për ta luftuar stigmën dhe diskriminimin shoqëror.

Në mënyrë që të jenë në gjendje t'i arrijnë prioritetet e tyre dhe ta përmbushin misionin e tyre, viktimat e luftës dhe grupet e tjera të prekura gjithashtu kanë nevojë për mbështetje teknike në fushat e mëposhtme:

- identifikimi dhe grupimi i viktimave të tjera me nevoja dhe përvoja të ngjashme, duke përfshirë gjeneratën e dytë, në mënyrë që grupet e ndryshme të mund të

- organizohen, përfaqësojnë veten dhe të avokojnë për të drejtat e tyre
- mbështetje financiare për ta mbajtur grupin e tyre (jo)formal të viktimave dhe për t'i përfshirë brezat e rinj në misionin e tyre
- ngritja e kapaciteteve në fushata avokimi, lobimi dhe zhvillimi
- të kuptuarit e parimeve të drejtësisë tranzicionale për t'i vendosur përvojat e tyre në një kontekst më të gjerë shoqëror, duke kontribuar gjithashtu në një të ardhme më paqësore
- ndërgjegjësimi dhe kuptimi i aspekteve gjinore të vuajtjeve dhe nevojave specifike të grave
- krijimi i partneriteteve, si me grupet e tjera të viktimave, ashtu edhe me OJQ-të, për të ndihmuar në zgjerimin e fokusit të tyre në aspektin gjinor, për të forcuar pozicionin e tyre avokues dhe për të rritur aftësitë në menaxhim të projektit
- asistencë teknike për t'i ndihmuar shoqatat ta forcojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare, aftësitë menaxhuese dhe burimet njerëzore.

Megjithëse nuk përmendet drejtpërdrejt nga vetë të intervistuarit, hulumtimi gjithashtu vë në dukje çështjet e mëposhtme që duhet trajtuar më gjerësisht:

- reagimet me në qendër viktimat për t'u përballur me të kaluarën, duke përfshirë depolitizimin e përvojave dhe misionit të viktimave gjatë kohës së luftës, dhe mësimdhënien gjithëpërfshirëse dhe të saktë të historisë
- njohja e aspekteve gjinore të vuajtjeve dhe nevojave specifike të grave viktimave dhe të mbijetuarave
- krijimi i një kulture të kujtimit të së kaluarës së dhunshme bazuar në multiperspektivë për ta inkurajuar dialogun për ndërtim të besimit dhe për të krijuar dialog potencial midis palëve të ndryshme.

